# Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit

# 2020-2028

## Lista e kontribueseve

**Ekipi i ngushtë përgjegjës për përgaditjen e PZHK-së dhe HZK-së:**

1. Flutura Avdiu Drejtor, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
2. Shaban Dobra Kryesues, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes sëMjedisit
3. Besart Bajrami Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
4. Flora Krasniqi Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

**Ekipi Komunal i planifikimit:**

1. Idriz Hysenaj, Drejtor, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
2. Flutura Avdiu Drejtor, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
3. Shaban Dobra Kryesues, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes sëMjedisit
4. Besart Bajrami Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
5. Flora Krasniqi Anëtare, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
6. Vlora Gjinofci Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
7. Fadil Tahiraj, Anëtar, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
8. Haki Bekolli Anëtar, Drejtoria e Inspektimit Komunal
9. Agim Kastrati, Anëtar, Drejtoria për Arsim
10. Lumturie Kiqina, Anëtar, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
11. Shehrije Mustafa, Anëtar, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik
12. Nexhmije Kurrumeli, Anëtar, Drejtoria për Buxhet dhe Financa
13. Afrim Prokshi Anëtar, Drejtoria për Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
14. Blerim Nika, Anëtar, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
15. Kajtaz Kastrati, Anëtar, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
16. Florim Hajdari, Anëtar, KEDS
17. Ismet Baliu, Anëtar, K.U.R. ''Prishtina'' sh.a.
18. Muhamer Qelaj, Anëtar, K.R.M. ''Pastrimi'' sh.a.
19. Ndriqim Bujupi Anëtar, K.R.M. ''Pastrimi'' sh.a.

Gjithashtu, për të siguruar gjithpërfshirje dhe transparencë, komuna ka themeluar edhe ekipin këshillues të komunitetit, që të kontribuojnë aktivisht në debate, si dhe të përcjellin informata rreth zhvillimeve të PZHK-së dhe HZK-së tek banorët.

**Ekipi këshillues i komunitetit:**

1. Administratorët e bashkësive lokale në qytet dhe fshatra: Gllogoc I, Gllogoc II, Gllogoc III, Komoran I, Gllanasellë, Arllat, Korroticë e Lartë, Tërstenik I, Nekoc, Abri,
2. Kadire Tahiraj Anëtare, Shoqata e grave
3. Arben Nika Anëtar," CEAE"
4. Remzi Krasniqi Anëtar, "Tabja"
5. Haxhi Lladrovci Anëtar, "Durimi"
6. Faton Shala Anëtar, "M-Shala"
7. Mehdi Gjoka Anëtar, "Fer Petrol"
8. Bashkësia Islame Anëtar, Përfaqësues
9. Kisha Katolike Anëtar, Përfaqësues

DRAFT

## TABELA E PËRMBAJTJES


**1. HYRJE ....... 19**
1.1. PROCESI I HARTIMIT TË PZHK-SË ....... 19

**2. PROFILI KOMUNAL DHE VLERËSIMI I GJENDJES** ....... 38
2.1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME ....... 38
2.1.1. HISTORIA E ZHVILLIMIT ....... 38
2.1.2. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE KLIMA ....... 38
2.2. DEMOGRAFIA ....... 43
2.2.1. ZHVILLIMI DEMOGRAFIK ....... 43
2.3. EKONOMIA ....... 47
2.3.1. SHKALLA E PAPUNËSISË ....... 47
2.3.2. SHKALLA E PUNËSIMIT ....... 48
2.3.3. NIVELI I VARFËRISË ....... 49
2.3.4. AMBIENTI I BIZNESIT ....... 49
2.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE ....... 59
2.4.1. UJËSJELLËSI ....... 59
2.4.2. KANALIZIMI ....... 60
2.4.3. RRJETI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK ....... 60
2.4.4. UJITJA ....... 60
2.4.5. ENERGJETIKA ....... 63
2.4.6. TELEKOMUNIKACIONI ....... 63
2.4.7. NGROHJA ....... 63
2.4.8. GRUMBULLIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE ....... 65
2.5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI ....... 69
2.5.1. GJENDJA EKZISTUESE DHE PROBLEMET ....... 69
2.5.2. TRANSPORTI NDËRURBAN ....... 71
2.5.3. VENDPARKINGJET ....... 71
2.5.4. INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE ....... 72
2.5.5. URAT ....... 72
2.5.6. SIGURIA NË TRAFIK ....... 72
2.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE ....... 75
2.6.1. SHËNDETËSIA ....... 75
2.6.2. INSTITUCIONET ARSIMORE ....... 75
2.6.3. ADMINISTRATA PUBLIKE ....... 79
2.6.4. KULTURA ....... 79
2.6.5. OBJEKTET E RINISË, SPORTIT DHE REKREACIONIT ....... 79
2.6.6. HAPËSIRAT PUBLIKE DHE TË GJELBËRA ....... 80
2.6.7. OBJEKTET E RELIGJIONIT ....... 80
2.6.8. VARREZAT ....... 80
2.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI ....... 86
2.7.1. MJEDISI ....... 86
2.7.2. FATKEQËSITË NATYRORE ....... 92
2.7.3. VËRSHIMET ....... 92
2.7.4. TËRMETET ....... 92
2.7.5. THATËSIRA ....... 92
2.7.6. FATKEQËSITË TEKNIKO-TEKNOLOGJIKE ....... 92
2.7.7. SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LARTË (HOT SPOTET) ....... 94
2.7.8. SIPËRFAQET E RREZIKUARA NGA ZJARRI ....... 94
2.7.9. EROZIONI ....... 94
2.7.10. RRËSHQITJA E TOKËS, NGRICAT, STUHITË DHE ORTEQET E BORËS ....... 94
2.8. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE ....... 97
2.8.1. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE ....... 97
2.8.2. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE ....... 99
2.8.3. TURIZMI ....... 100
2.9. VENDBANIMET ....... 103
2.9.1. KARAKTERI URBAN RURAL DHE FUNKSIONALITETI NDËRLIDHËS ....... 103
2.9.2. ZONA URBANE ....... 103


DRAFT

2.9.3. ZONA RURALE ... 103
2.9.4. TRENDI I ZHVILLIMEVE ... 104
2.9.5. MADHËSIA DHE NUMRI I BANORËVE ... 106
2.9.6. LLOJI DHE LARTËSIA MBIDETARE ... 107
2.9.7. SIPËRFAQET E NDËRTUARA NË KUADËR TË VENDBANIMEVE ... 107
2.9.8. VENDBANIMET JO FORMALE DHE NDËRTIMET PA LEJE ... 109
2.10. BANIMI ... 118
2.10.1. BANIMI NË TERITORIN URBAN DHE RURAL ... 118
2.10.2. TRENDET E NDËRTIMIT, ÇMIMET MESATARE TË NDËRTESAVE PËR BANIM, PRONËSIA DHE SHFRYTËZIMI ... 119
2.11. VLERËSIMI I KAPACITETEVE KOMUNALE ... 121
2.11.1. KAPACITET ADMINISTRATIVE - ... 121
2.11.2. KAPACITETET FINANCIARE ... 122
2.12. VLERËSIMI I KAPACITETET INVESTUESE ... 126

**3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR** ... 127
3.1. VIZIONI ... 127
3.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE ... 127
3.2.1. ZHVILLIMI EKONOMIK ... 127
3.2.2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE ... 127
3.2.3. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE ... 128
3.2.4. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIK ... 128
3.2.5. VENDBANIMET ... 129
3.2.6. BANIMI ... 129
3.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR ... 130
3.3.1. SKENARËT E PROPOZUAR ... 130
3.3.2. KONCEPTI I ZHVILLIMIT ... 134
3.3.3. TËRESITË HAPËSINORE ... 136
3.3.4. ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE ... 137
3.3.5. SHFRYTËZIMI I PLANIFIKUAR I TOKËS ... 140
3.3.6. BANIMI ... 142
3.3.7. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT ... 146
3.3.8. INFRASTRUKTURA TEKNIKE ... 151
3.3.9. EKONOMIA ... 152
3.3.10. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE ... 159
3.3.11. MJEDISI DHE FATKEQËSITË NATYRORE ... 164
3.3.12. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE DHE TURIZMI ... 167

**4. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PLANI I VEPRIMIT** ... 169
4.1. PRIORITETET STRATEGJIKE ... 169

**5. ZBATIMI DHE MONITORIMI** ... 180
5.1. DISPOZITAT PËR ZBATIM ... 180
5.1.1. KORNIZA E ZBATIMIT TË PZHK ... 180
5.1.2. KORNIZA E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT ... 180
5.2. SISTEMI I MONITORIMIT ... 182
5.2.1. PËRGJEGJËSIT E MONITORIMIT ... 182

## LISTA E KUTIVE

Kutia 1. Vizioni i Portit të Kosovës ... 33
Kutia 3. Vizioni i Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë SHP UÇK Kleçkë-Divjakë ... 37
Kutia 4. Synimet, objektivat dhe prioritetet strategjike të Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë SHP UÇK Kleçkë-Divjakë ... 37

DRAFT

## LISTA E HARTAVE


Harta 1. Strategjia e zhvillimit hapësinor – Porti i Kosovës ........ 34
Harta 2. Strategjia e zhvillimit hapësinor – ZIV ”Kleçkë-Divjakë” ........ 36
Harta 3. Pozita e komunës së Gllogocit në Kosovë ........ 38
Harta 4. Rrjeti hidrografik ........ 40
Harta 5. Pjerrtësia e terenit ........ 41
Harta 6. Llojet e tokave ........ 42
Harta 7. Dendësia e popullsisë sipas rrjetit/Grid-it për km², në komunën e Gllogocit ........ 45
Harta 8. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve ........ 46
Harta 9. Shpërndarja e bizneseve sipas vendbanimeve ........ 52
Harta 10. Shpërndarja e tokave bujqësore ........ 53
Harta 11. Kategoritë e tokave bujqësore ........ 54
Harta 12 Shtrirja e rrjetës se ujësjellësit ne Gllogoc dhe disa fshatra si dhe paraqitja e vendbanimeve të cilat kanë ujësjellës dhe ato qe nuk posedojnë Ujësjellës ........ 61
Harta 13 Paraqitja e vendbanimeve të cilat kanë rrjetë të kanalizimit dhe ato qe nuk posedojnë rrjetë të kanalizimit. ........ 62
Harta 14 Rrjeti energjetik dhe telekomunikacionit ........ 64
Harta 15 Shpërndarja e rrjetit të rrugëve në komunën e Gllogocit ........ 73
Harta 16 Shtrirja e objekteve shëndetësore në Komunën e Gllogocit ........ 77
Harta 17 Shtrirja e objekteve arsimore në komunën e Gllogocit ........ 78
Harta 18 Shtrirja hapësinore e objekteve të kulturës, rinisë dhe sportit në territorin e komunës së Gllogocit ........ 82
Harta 19 Shpërndarja e hapësirave të gjelbra në zonën urbane të Gllogocit ........ 83
Harta 20. Shpërndarja e objekteve fetare dhe varrezave ........ 90
Harta 21 Gjendja e Mjedisit në komunën e Gllogocit ........ 91
Harta 22 Zonat Sizmologjike ........ 93
Harta 23 Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera ........ 95
Harta 24 Shtrirja e Aseteve të trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë natyrore ........ 101
Harta 25. Bashkësitë territoriale ........ 105
Harta 26 Krahasimi në mes të hapësirave të ndërtuara dhe të pandërtuara brenda zonës urbane ........ 106
Harta 27 Trendi i zhvillimeve para viti 1970 deri ne 2018 ........ 111
Harta 28. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas vendbanimeve ........ 112
Harta 29 Hipsometria e terrenit ........ 113
Harta 30 Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve dhe vendbanimet joformale ........ 114
Harta 31. Shtrirja e ndërtimeve pa leje ........ 115
Harta 32 Shfrytëzimi aktual i tokës ........ 116
Harta 33. Zhvillimi hapësinor i planifikuar ........ 135
Harta 34. Tërësitë hapësinore ........ 138
Harta 35. Plani i vendbanimeve dhe banimit (Gjendja e planifikuar) ........ 141
Harta 36. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës ........ 143
Harta 37. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës në zonën urbane ........ 144
Harta 38. Toka e propozuar ndërtimore ........ 145
Harta 39. Zhvillimi i transportit dhe infrastrukturës së transportit ........ 149
Harta 40. Transporti urban dhe rural ........ 150
Harta 41. Sistemi i ujitjes dhe drenazhimit (gjendja e planifikuar) ........ 153
Harta 42. Energjia elektrike dhe termike (gjendja e planifikuar) ........ 154
Harta 43. Telekomunikacioni dhe instalimet e ngjashme (gjendja e planifikuar) ........ 155
Harta 44. Shtritja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ........ 156
Harta 45. Menaxhimi i mbeturinave dhe riciklimi ........ 157
Harta 46. Masat për zhvillimin ekonomik (Gjendja e planifikuar) ........ 158
Harta 47. Hapësirat publike dhe sociale (Gjendja e planifikuar) ........ 160
Harta 48. Hapësirat sportive (Gjendja e planifikuar) ........ 161
Harta 49. Hapësirat publike dhe të gjelbra (Gjendja e planifikuar) ........ 162
Harta 50. Menaxhimi i varrezave ........ 163
Harta 51. Mbrojtja e mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet tjera (Gjendja e planifikuar) ........ 166
Harta 52. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Gjendja e planifikuar) ........ 168


## LISTA E TABELAVE


Tabela 1. Gjatësia kufitare e Gllogocit me komunat fqinje ........ 39
Tabela 2. Sipërfaqja e llojeve të tokave sipas përbërjes pedologjike në ha dhe % (Burimi: Harta pedologjike, Baza e hidroekonomisë e KSA të Kosovës) ........ 39


DRAFT

Tabela 3 Të dhënat nga Regjistrimet e popullsisë në periudhat prej vitit 1948 – 2011 ........ 43
Tabela 4 Numri i punëkërkueseve të regjistruar në zyrat e punësimit, shtator 2017 ........ 48
Tabela 5 Numri i ndërmarrjeve sipas llojit të pronësisë, në % (Burimi: ATK, 2018) ........ 50
Tabela 6 Ndermarrjet ekonomike, sipas sektoreve ekonomik, 2011- 2018 ........ 51
Tabela 7 Prodhimtaria e Perimeve, në sipërfaqe (ha) ........ 55
Tabela 8 Prodhimtaria e Pemëve, në sipërfaqe (ha) dhe nr. të trupave ........ 56
Tabela 9 Fondi Blegtoral, Komuna e Gllogocit 2014 ........ 57
Tabela 10 Qasja e popullsisë ne Internet, PC dhe telefon ........ 63
Tabela 11 Mbulimi i territorit komunës me shërbime te grumbullimit te mbeturinave ........ 65
Tabela 12. Linja e autobusëve si dhe frekuenca e shërbimeve në bazë të ditëve të punës dhe fundjave ........ 70
Tabela 13. Linja e autobusëve si dhe frekuenca e shërbimeve në bazë të ditëve të punës dhe fundjave ........ 71
Tabela 14. Numri i institucioneve, edukatorëve, nxënësve dhe punëtorëve arsimor ........ 76
Tabela 15 Zonën gravituese, numrin e banorëve dhe vitin e themelimit. ........ 79
Tabela 16. Sipërfaqja dhe kosto e mirëmbajtjes së varrezave që mbulohet nga komuna e Gllogocit ........ 81
Tabela 17 Ndotësit kolektiv në komunën e Gllogocit ........ 88
Tabela 18 Trashëgimia kulturore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore ........ 97
Tabela 19. Trashëgimia arkeologjike/Lokalitet arkeologjik ........ 98
Tabela 20. Trashëgimia arkitekturale; Burimi: Komuna e Gllogocit ........ 99
Tabela 21 Trashegimia natyrore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapesinore, 2018. ........ 99
Tabela 22 Klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit ........ 106
Tabela 24 Kategoritë e shfrytëzimit të tokës ........ 107
Tabela 25 Dendësia neto e paraqitur për vendbanim ........ 108
Tabela 23 Vendbanimet Joformale ........ 109
Tabela 26. Fondi i banimit në raport me njësitë e banimit dhe tipologjinë e ndërtesave të banimit ........ 118
Tabela 27. Numri i njësive të banimit- shtëpive dhe banesave kolektive sipas vendbanimeve ........ 119
Tabela 28. Pasqyra dhe trendet e planifikimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2011- 2018 ........ 122
Tabela 29. Pasqyra dhe trendet e shpenzimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2011- 2017 ........ 124
Tabela 30. Pasqyra dhe trendet e shpenzimeve kapitale sipas sektorëve, 2011- 2017 ........ 124
Tabela 31. Projeksioni i Buxhetit Total të Komunës në vite sipas kategorisë së shpenzimeve, shprehur në € ........ 125
Tabela 32. Buxheti Total i Komunës në vite sipas sektorëve, shprehur në € ........ 125
Tabela 33. Ndarja e shpenzimeve kapitale, 2019-2021 ........ 126
Tabela 34 Llogaritja e dendësisë dhe sipërfaqës së planifikuar për zhvillim ........ 139
Tabela 35. Vendbanimet (funksioni dhe klasifikimi) sipas rritjes së projektuar në 2028 ........ 140
Tabela 36. Rangimi i prioriteteve strategjike ........ 169
Tabela 37. Plani i veprimit - Zhvillimi ekonomik ........ 170
Tabela 38. Plani i veprimit - Infrastruktura teknike ........ 172
Tabela 39. Plani i veprimit - Infrastruktura publike dhe sociale ........ 175
Tabela 40. Plani i veprimit - Mjedisi, sipërfaqet me rrezikshmëri, trashëgimia natyrore dhe kulturore ........ 176
Tabela 41. Plani i veprimit - Vendbanimet ........ 178
Tabela 42. Plani i veprimit - Banimi ........ 179
Tabela 43. Matrica e monitorimit dhe vlerësimit ........ 182

## LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1 Popullsia e komunës së Gllogocit sipas regjistrimeve 1948-2011 ........ 44
Grafiku 2 Popullsia e paraqitur në tri grup-mosha, nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 ........ 44
Grafiku 3. Shtimi natyror në vitin 2017 në komunën e Gllogocit (ne promil) ........ 44
Grafiku 4 Numri i te punësuarve neper vite, 2011-2018 ........ 49
Grafiku 5 Prodhimi i dritherave, t/ha ........ 55
Grafiku 6 Prodhimi i perimeve, t/ha ........ 55
Grafiku 7 Prodhimi i pemëve, t/ha ........ 56
Grafiku 8. Viti i ndërtimit të ndërtesave në bashkëpronësi ........ 119
Grafiku 9. Të hyrat vetanake komunale, 2011-2017, Burimi: Komuna e Gllogocit ........ 122
Grafiku 10. Trendet e të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore, 2011-2017, Burimi: Komuna e Gllogocit, 2018 ........ 123
Grafiku 11. Struktura e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik 2018 ........ 123
Grafiku 12 Trendi i parashikimit të hyrave vetanake komunale ........ 125

DRAFT

## LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1. PAMJE DHE ORTOFOTO TË DEPONIVE ILEGALE NË QYTETIN E GLLOGOCIT ........ 66
FIGURA 2. PAMJA NGA AJRI E DEPONISË SË RAJONIT TË PRISHTINËS (GOOGLE MAPS, 2017) ........ 66
FIGURA 3 LOKACIONI DHE VENDNDODHJA E METALEVE TË RËNDA ........ 89
FIGURA 4 HARTA E ZONËS SË PROPOZUAR PËR MBROJTJE LIQENET E VASILEVËS ........ 100
FIGURA 5 BASHKËSITË TERRITORIALE NË ZONËN URBANE ........ 104
FIGURA 6. SKEMA E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË VEPRIMEVE ........ 181

## LISTA E FOTOGRAFIVE

FOTO 1. TAKIMET DHE PREZENTIMET PUBLIKE ME QYTETARË SI DHE PUNËTORITË GJATË PROCESIT TË HARTIMIT TË PZHK-SË ........ 21
FOTO 2. LIQENI I VASILEVES ........ 99
FOTO 3. LAGJA FERONIKELI ........ 109
FOTO 4. LAGJJA ROGA ........ 109
FOTO 5. LAGJJA E RE, KOMORAN ........ 110

### LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| PZHK | Plani Zhvillimor Komunal |
| PZHU | Plani Zhvillimor Urban |
| PRrU | Plani Rregullues Urban |
| PRrH | Plani Rregullues i Hollësishëm |
| KK | Kuvendi Komunal |
| DZHE | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik |
| DGJKP | Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| MIA | Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit |
| MZhE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| MBPZHR | Ministria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural |
| MEM | Ministria e Energjisë dhe Minierave |
| MAPL | Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal |
| MTI | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë |
| ASK | Agjensioni i Statistikave të Kosovës |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| HEC | Hidrocentralet |
| PTK | Posta dhe telekomi i Kosovës |
| TIK | Teknologjia Informative dhe e Komunikimit |

DRAFT

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit(Gllogocit)**
Kuvendi i Komunës

12 Nr.350-6540 dt 31.01. 2018

Në bazë të nenit 12,17 si dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008), nenit 5. paragrafi 1.2., nenparagrafi 1.2.1. dhe nenet 10. Paragrafi 2. nenparagrafi 2.1.,neni 11., 15. dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor 04/L-174, datës 23.08.2013 si dhe Udhëzimi Administrativ MMPH –Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin,Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, si dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.01.2018 miratoi këtë:

VENDIMI

Për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Gllogocit.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me ketë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si Plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal nga neni 1. i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Gllogocit, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Plani strategjik multi-sektorial, i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

## Neni 4

## Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në teritorin e Komunës së Gllogocit janë :

| ZONA KADAS TRALE | KADASTRAL 1 | Sipërfaqja m² | SIP_HEKTAR |
|---|---|---|---|
| 70310042 | LLAPUSHNIK | 15243217 | 1524 |
| 70310053 | NEGROC | 10075967 | 1008 |
| 70310058 | ARLLAT | 13125209 | 1313 |
| 70314016 | KORROTICA EPERME | 8495059 | 850 |
| 70314017 | FUSHTICA E EPERME | 4559921 | 456 |
| 70314018 | ZABELI I EPERME | 3121292 | 312 |
| 70314025 | KORROTICA E ULET | 4126284 | 413 |
| 70314026 | FUSHTICA ULET | 6135453 | 614 |
| 70314029 | ZABEL I ULET | 4517792 | 452 |
| 70314033 | KISHNAREKA | 6604842 | 660 |
| 70314035 | KAMARAN | 11291927 | 1129 |
| 70314053 | NEKOC | 10363430 | 1036 |
| 70314067 | SANKOC | 13980670 | 1398 |
| 70315003 | BAICA | 11512181 | 1151 |
| 70315008 | VASILEVA | 9663154 | 966 |
| 70315011 | VERBOC | 7998982 | 800 |
| 70315012 | VUQAK | 4589835 | 459 |
| 70315014 | GLLANASELLA | 10591245 | 1059 |
| 70315015 | GLLOBAR | 5088305 | 509 |
| 70315016 | GLLOGOC | 3722403 | 372 |
| 70315017 | GRADICA | 12261467 | 1226 |
| 70315019 | ABRI E EPERME | 12100424 | 1210 |
| 70315022 | GODANC | 3718586 | 372 |
| 70315023 | DOBRASHEC | 13033184 | 1303 |
| 70315024 | DAMANEK | 3141428 | 314 |
| 70315035 | KRAJKOVA | 7486398 | 749 |
| 70315044 | LIKOSHAN | 4564363 | 456 |
| 70315052 | QIKATOVA E RE | 5588535 | 559 |
| 70315056 | PAKLEK | 6978123 | 698 |
| 70315057 | POLLUZHA | 4183326 | 418 |
| 70315066 | QIKATOVA E VJETER | 6670048 | 667 |
| 70315069 | TERDEVC | 8402369 | 840 |
| 70315071 | TERSTENIK | 15625072 | 1563 |
| 70315077 | SHTRUBULLOVA | 2793464 | 279 |
| 70315078 | SHTUTICA | 4634736 | 463 |

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Gllogocit Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1. të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultime Publike

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jete në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programi

Pjese e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11. pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr. 04/L-174

Neni 12

Hyrja ne fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja 15 dite pas regjistrimit në zyren e protokolit të ministrisë përgjegjse për veteqëverisje Lokale si dhe publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
01-M Nr.Prot. 5918-2/19
-03- Data 16.10.19
Prishtinë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Kabineti i Ministritit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Ministër*

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 11.10. 2019 |
| REFERENC-Ë: | 19/5918/1-792/DMMU |
| PËR/ZA/TO: | "Komunës së Gllogocit" Gllogoc, Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Fatmir Matoshi, Minister i MMPH-së |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim |

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka pranuar Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit të dërguar nga ana e Juaj sipas kërkesës së protokolluar me nr.: 19/5918/1-792/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit

Me respekt,



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Vendimi Nr. 48
Data: 15.10.2019

Në bazë të nenit 28.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230 , si dhe nenit 42 dhe 44 të LPPA-së (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerr këtë:

## VENDIM

**APROVOHET** kërkesa nga "Komuna e Gllogocit" Gllogoc, Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit

## Arsyetim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, kërkesën, dokumentacionin, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit , Proces verbalin i Debatit Publik për Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit, listen e pjesmarrësve në debat publik të dorëzuar nga Komuna e Gllogocit, Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson që:

"Komunës sëe Gllogocit" Gllogoc, Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor **i jep Pëlqimi Mjedisor** për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit.
Në qoftë se, vie deri te ndryshimi i Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit.



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

, duhet të hartoj Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe të aplikoj në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit

**Këshilla Juridike**: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/5018/1 -792/48/19 datë:11.10.2019

Prishtinë

T'i dërgohet:
1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VSM*
3. *Inspektoratit të MMPH-së*
4. ***Zyrës të Sekretarit të*** Përgjithshëm
5. *Kabinetit të Ministrit*
6. *Arkivi i MMPHsë*
7. *Kuvendit të Kosovës*

Fatmir Matoshi

Ministër i MMPH



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
DPHNB 6225-3/19
02 14.01.20
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor***
***Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja***
***Ministry of Environment and Spatial Planning***

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary*

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 16.01.2020 |
| REFERENC-Ë: | ZSP - 23/2020 |
| PËR/ZA/TO: | Flutura Avdiu, Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Gllogocit |
| CC: | Ramiz Lladrovci, Kryetarit të Komunës së Gllogocit |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Njoftim për marrjen e Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt- "Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2019-2027" |

E nderuara znj.Avdiu,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11 paragrafi 1.9 dhe nënparagrafi 1.9.1, Komuna e Gllogocit ka dorëzuar Projekt "Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2019-2027" në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 16.12.2019 me numër të protokollit 6225-2/19 për të verifikuar përputhshmërinë me "Planin Hapësinor të Kosovës –Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" **para shqyrtimit publik**, si dhe me nenin 9 paragrafit 2 nen paragrafit 2.3, me te cilën Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërish së Projekt Planin Zhvillimor të Komunës. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas shqyrtimit dhe verifikimit së Planit Zhvillimor të Komunës që është në përputhje me "Planin Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" dhe duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ



Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245
http://mmph-ks.org E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

MMPH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor nxjerr Vendim për pëlqim që Kuvendi i Komunës së Gllogocit sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit dhe Menaxhimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, **Mund të bëjë Hapjen e Shqyrtimit Publik.**

Me respekt,



Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245
http://mmph-ks.org E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

**Nr.12-400/01-5916 dt 31.01. 2020**

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 dhe nenit 2 të Ligjit Nr.04/l-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 4 paragrafi 3 pika 3.1, neni 7 paragrafi 2 dhe 3, nenit 8, 10, 12 dhe 14, sipas Vendimit Nr.6225-2/19 të datës 16.01.2020 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Bazuar në nenit 11,12 dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Gllogocit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën, 31.01.2020, miratoj këtë:

**V E N D I M**
**PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË PROJEKT-PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË GLLOGOCIT PËR PERIUDHËN 2020-2028**

**Neni 1**

Kuvendi i Komunës së Gllogocit të miratoj propozim vendimin për shpalljen në shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit për periudhën 2020-2028.

**Neni 2**

2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028 bëhet në sallen e Kuvendit Komunal.
2.2 Shqyrtimi publik i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Gllogocit 2020-2028 zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj.
2.3 Shpallja e shqyrtimit publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028 bëhet tetë ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht ueb faqës së Komunës.

**Neni 3**

3.1 Në shqyrtimin publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028.

3.2 Në shqyrtimin publik prezantohen fazat e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028: Korniza Strategjike, Profili i Komunës, vlerësimi i gjendjes, vizioni, qëllimet dhe objektivat, koncepti i zhvillimit hapësinor dhe Plani i veprimit.

3.3 Projekt- Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028 është i qasshëm, për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

**Neni 4**

4.1 Projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028 u nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2 Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku gjatë diskutimeve, me shkrim, në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

**Neni 5**

Shqyrtimi publik i Projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028 organizohet nga Komuna në kuadër të kompetencave ligjore.

**Neni 6**

6.1 Me këtë propozim vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028.

6.2 Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi do të jetë edhe plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik (prezantimi i PZHK-së, njoftimi i qytetarëve, sigurimi i materialit elektronik dhe fizik i PZHK-së dhe veprimet tjera për të siguruar një qasje normale të qytetarëve në Planin Zhvillimor Komunal).

**Neni 7**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset:Kryetari i Komunës në bashkpunim me Drejtorin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**Neni 8**

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Tahiriot Halilaj**

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .

# 1. HYRJE

Në mënyrë që të orientojë zhvillimet në gjithë territorin e komunës, administrata komunale e Gllogocit, në janar të vitit 2018, ka marrë vendim që të hartojë Planin Zhvillimor Komunal, për 8 vitet e ardhshme. Ky plan është hartuar në përputhje me Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, ku sipas të cilit “Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare”[1]. Nevoja për hartimin e një plani të ri është shfaqur jo vetëm si obligim i përmbushjes së kërkesave të ligjit të ri 04 / L-174 dhe akteve nënligjore të tij, por edhe për shkak të ndryshimeve evidente të kontekstit të cilat kanë ndodhur që nga aprovimi i PZHK/U –së në vitin 2009.

Komuna e Gllogocit ishte një ndër komunat, që në Kosovën e pasluftës kanë hartuar dhe miratuar gjeneratën e parë të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban (PZHK/U). Procesi i hartimit dhe miratimit të PZHK/U është bërë në harmoni me kërkesat e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14 të vitit 2003 dhe Udhëzimeve Administrative përkatëse mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor dhe Urban të Komunës, ku në të njëjtën kohë ishte hera e parë që aplikohet qasja strategjike në planifikim hapësinor në Kosovë. Po ashtu, sipas Ligjit në fjalë, komunat ishin të obliguara të hartojnë një hierarki të planeve hapësinore strategjike bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm: PZHK-të për tërë territorin e komunës, PZHU-të për hapësirat urbane dhe PRrU-të për vendbanimet urbane dhe rurale dhe për hapësirat tjera me interes për komunën. Sfidat e zbatimit të sistemit të kaluar të planifikimit hapësinor kanë qenë se komunave u është nevojitur shumë kohë për të hartuar së pari PZHK/U-të, për të vazhduar me PRrU-të për të gjitha hapësirat/vendbanimet në qytet dhe komunë. Më qëllim të përmirësimit të gjendjes së planifikimit në komunat e Kosovës, Ligji i ri Nr.04 / L-174 ka përcaktuar një sistem të ri të planifikimit hapësinor, duke e prezantuar një instrument të ri të kontrollit të zhvillimit në të dy nivelet e planifikimit - Hartën Zonale. Harta Zonale e Komunës, e cila derivon nga PZHK-ja, përcakton rregullat për kontroll të zhvillimit për tërë territorin e komunës, ku mundësohet që PRrH-të të mos jenë të obligueshme për t’u hartuar nga komunat, përveç në rastet kur ato vlerësojnë që ka nevojë për rregulla shtesë për ndonjë vendbanim apo zonë të qytetit.

Në vitin 2017, në kuadër të proceve të planifikimit, me mbështetjen teknike të GIZ-it në Kosovë, pas 10 vitesh të implementimit të PZHK-së dhe PZHU-së së Gllogocit, është bërë vlerësimi i kualitetit të tyre në bazë të kritereve standarde të vlerësimit, si dhe është vlerësuar deri në çfarë masë janë zbatuar këto plane gjatë këtyre 10 viteve të zbatimit. I gjithë ky proces ka shërbyer për të dhënë një pasqyrë të qartë se cilat nga strategjitë e planit janë ende relevante për t’u marrë parasysh edhe në dokumentet e reja të planifikimit për komunën e Gllogocit. Për të siguruar që Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Gllogocit të jetë i një kualiteti të lartë, administrata komunale është përkushtuar që ky plan të hartohet përmes një procesi pjesëmarrës, në përputhje me politikat kombëtare, dhe të mundësojë drejtim të qartë për zhvillimin hapësinor të komunës. Kjo ka bërë që bartësit e procesit të planifikimit, gjegjësisht drejtoria për planifikim të jetë pranë qytetarëve përmes takimeve të ndryshme publike, fokus grupeve, por edhe përmes formave tjera teknologjike të pjesëmarrjes, duke vënë në dispozicion të qytetarëve të gjitha informatat, strategjitë dhe veprimet e këtij plani.

## 1.1. PROCESI I HARTIMIT TË PZHK-SË

Nisur nga obligimet ligjore të dalura nga ligji i planifikimit, Komuna e Gllogocit ka inicuar procesin e hartimit të PZHK-së . Procesi i hartimit ka filluar me vendimin për hartim të PZHK-së të marrë nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit më 31.01.2018. Bartëse e procesit të hartimit të PZHK-së është përcaktuar Drejtoria për Planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit, respektivisht grupi i ngushtë punues së bashku me kompaninë

[1] LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

DRAFT

përfituese për mbështetje teknike Plan-A Consulting. Për të udhëhequr procesin e planifikimit në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, komuna ka themeluar dy mekanizma:

- Ekipin Komunal për Planifikim (EKP) - të përbërë nga të gjitha drejtoritë e komunës së Gllogocit. EKP ka shërbyer si platformë për të mbledhë informata nga të gjitha drejtoritë dhe kompanitë publike në komunë, si dhe për të dhënë kontribut në përmbajtjen e PZHK në të gjitha fazat e hartimit të tijë. Për më shumë EKP ka shërbyer për të harmonizuar kërkesat dhe projektet të të gjithë sektorëve në komunë.
- Ekipin Këshillues të Komunitetit (EKK) – të përbërë nga të gjitha komunitetet në komunën e Gllogocit. Anëtarët e EKK-së janë përfaqësues të shoqërisë civile, të rinjëve, grave, të moshuarve, personave më aftësi të veçanta, bizneseve, komuniteteve fetare dhe kryetarë të bashkësive lokale. EKK ka shërbyer si urë lidhëse në mes të komunës dhe qytetarëve të komunës. Detyrë primare e EKK-së ka qenë komunikimi me qytetarë rreth përmbajtjes së PZHK-së në faza të ndryshme të hartimit.

I gjithë procesi i hartimit të PZHK-së ka kaluar në katër faza kryesore: profili, vlerësimi i gjendjes, koncepti i zhvillimit hapësinor, dhe prioritetet strategjike me planin e veprimit. Të gjitha fazat janë përcjellë me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe akterëve tjerë relevant dhe punëtori respektive. Punëtoritë janë organizuar për çdo fazë në bashkëpunim me EKP-në dhe EKK-në, dhe kanë shërbyer si mjet për të diskutuar përmbajtjet e çdo kaptine të PZHK-së.

Në nëntor të viti 2018 është organizuar punëtoria e analizës SWOT, dhe rezultatet e saja janë prezantuar ne prezentim publik në fillim të muajit shkurt të 2019-ës. Definimi i kahjes së zhvillimit të komunës së Gllogocit, brenda kornizës së politikave kombëtare, programeve e strategjive rajonale në përputhje me resurset e disponueshme në vend, është iniciuar me punëtorinë 3 ditore të vizionimit, e cila është mbajtur në dhjetor të 2018. Kjo punëtori si hap shumë i rëndësishëm brenda PZHK-së përpos EKP-së dhe EKK-së është përcjellë nga kryetari dhe bordi i drejtorëve të komunës. Po ashtu, për përcaktimin e skenarëve të zhvillimit janë mbajtur takime pune me planerët komunal dhe përfaqësues tjerë në muajin janar të 2019-ës, ku është diskutuar e vlerësuar se cili skenar i zhvillimit do të ishte më i përshtatshëm për të udhëhequr zhvillimin e Gllogocit. Korniza më tej është detajuar në punëtorinë 2 ditore të planit të veprimit në fillim të majit 2019, me ç'rast janë përcaktuar edhe prioritetet strategjike. Korniza e zhvillimit bashkë me prioritetet zhvillimore dhe planin e veprimit janë prezantuar me 22 maj të 2019.

Procesi i pjesëmarrjes së publikut është organizuar duke marrë për bazë dy qasje: e para nëpërmes takimeve publike – kontakt direkt me qytetarë, dhe e dyta, qasje me inovative ka qenë platforma online për pjesëmarrje.  Takimet publike me qytetarë janë organizuar në vendbanimet e tyre. Nga totali i 10 takimeve publike, 2 takime janë organizuar në zonën urbane, dhe 8 takime në zonën rurale. Pjesëmarrja e qytetarëve në këto takime ka qenë relativisht e kënaqshme. Përafërsisht 190 persona kanë marrë pjesë në të gjitha takimet publike në zonën urbane dhe rurale, duke mos numëruar personat që kanë marrë pjesë në prezentimet publike në sallën e Kuvendit Komunal.





DRAFT



Foto 1. Takimet dhe prezentimet publike me qytetarë si dhe punëtoritë gjatë procesit të hartimit të PZHK-së

Platforma online për pjesëmarrje të publikut “Maptionnaire” është lansuar në dhjetor 2018. Qëllimi i platformës ka qënë që të përfshijë të gjithë ata qytetarë të cilët nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në takimet publike si dhe gjeneratat e reja të cilët janë të aftësuar mirë në përdorimin e teknologjisë informative. Platforma online ka qenë e strukturuar në dy kaptina kryesore, të cilat nëpërmes pyetjeve për problemet në lagjet e tyre dhe si qytetarët e shohin zhvillimin e ardhshëm të lagjes/komunës së tyre u është dhënë mundësia që të kontribojnë aktivisht në përmbajtje të planit. Platforma online ka qenë e hapur për 11 ditë, dhe gjatë kësaj kohë janë përgjigjur 778 qytetarë. Prej 778 qytetarëve të cilët janë përgjigjur pyetësorit online, 34.06% kanë qenë gra/vajza. Grupmoshat 17-25 vjeç dhe 26-40 vjeç janë përgjigjur në përqindje më të madhe, me nga 40% secila moshë.

Të gjitha komentet relevante të qytetarëve nga takimet publike dhe nga pyetësori online janë marrë parasysh dhe inkorporuar në PZHK. Komentet e qytetarëve kanë mundësuar që përmbajtja e planit të jetë më reale, dhe në të ardhmen do mundësojë gjithashtu zbatim më të lehtë të planit.

I gjithë procesi i hartimit të PZHK-së është përcjellë me përkushtim të plotë dhe mbështetje teknike nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjegjësisht Departamentit të Planifikimit, Banimit dhe Ndërtimit (DPBN), dhe Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH).

## 1.2. PËRMBLEDHJE E SHKURTË E PZHK-SË

**VIZIONI**

*“Të gjitha rrugët kalojnë nëpër Gllogoc”.*
*Në zemër të Kosovës, Gllogoci me ekonomi të bazuar në zhvillim të qëndrueshëm rural, përkrahje të bizneseve, industrisë dhe infrastrukturës funksionale.*
*Banim e shërbime cilësore, ku qytetari është në qendër të vëmendjes e rinia e aftësuar profesionalisht;*
*Mjedis të qëndrueshëm e shfrytëzim racional të resurseve natyrore, promovim të trashëgimisë kulturore, turizmit e sportit.*

DRAFT

## QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

## ZHVILLIMI EKONOMIK

**Qëllimi 1: Nxitja e zhvillimit të bujqësisë**

Objektiva 1.1. Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore

Objektiva 1.2. Krijimi i kuadrit profesional në fushën e bujqësisë

Objektiva 1.3. Rritja e fondit blegtoral për 30% për 8 vite

Objektiva 1.4. Rritja e sipërfaqeve të Pemishteve, Perimeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, 50% për 8 vite

**Qëllimi 2: Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM)**

Objektiva 2.1. Rritja e bizneseve prodhuesve për 6% në çdo vit

**Qëllimi 3: Ngritja e kualitetit te veprimtarive shërbyese**

Objektiva 3.1. Aftësimi i fuqisë punëtore në sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese

**Qëllimi 4: Nxitja e zhvillimit të turizmit rural**

Objektiva 4.1. Zhvillimi i kapaciteteve pritëse/akomoduese në fshatra, së paku 10 pika akomodimi në 5 vitet e para të zbatimit të planit

Objektiva 4.2. Përgatitja e pakove turistike (së paku 3 pako për 5 vite)

## INFRASTRUKTURA TEKNIKE: ENERGJETIKA

**Qëllimi 1: Rritja e kapaciteteve për furnizim të qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtritshme.**

Objektiva 1.1. Ndërrimi i rrjetit shpërndarës (0.4 KË) nga përçuesit ajror në atë kabllore, në të gjitha vendbanimet e komunës në 5 vitet e ardhshme

Objektiva 1.2. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme deri në 5%, ne 8 vitet e ardhshme

Objektiva 1.3. Sigurimi i sistemit të ngrohjes qendrore

## INFRASTRUKTURA TEKNIKE: UJËSJELLËSI, KANALIZIMI DHE UJITJA

**Qëllimi 2: Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) si dhe ujitjes**

Objektiva 2.1. Rritja e kapaciteteve të ujit në 50 l/s (33% e ekonomive familjare) në 10 vitet e ardhshme

Objektiva 2.2. Hulumtimi i burimeve alternative nëntokësore dhe funksionalizimi i burimeve ekzistuese (Krajkovë, Koreticë e Epërme dhe Vërbovc)

Objektiva 2.3. Trajtimi i ujërave të zeza për 50% të territorit në 5 vitet e ardhshme

Objektiva 2.4. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në të gjitha lagjet në të cilat konfiguracioni i terrenit e lejon

Objektiva 2.5. Futja nën menaxhim të tërë sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit funksional

## INFRASTRUKTURA TEKNIKE: MBETURINAT

**Qëllimi 3: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës**

Objektiva 3.1. Ngritja e kapaciteteve teknike të kompanisë operuese publike në 3 vitet e ardhshme

## INFRASTRUKTURA TEKNIKE: TRANSPORT

**Qëllimi 4: Sigurimi i transportit të integruar për komunën e Gllogocit**

Objektiva 4.1. Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në transport publik urban dhe periferik brenda vitit

Objektiva 4.2. Rritja e sigurisë në trafikun rrugor dhe hekurudhor, 10% ulje të aksidenteve në komunikacion brenda vitit

Objektiva 4.3. Minimizimi i ndikimeve negative nga transporti i ngarkesave të Feronikëlit brenda 3 viteve

## INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE: ARSIMI

**Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë**

Objektiva 1.1. i infrastrukturës edukative/trajnuese dhe plotësimi shkollave me pajisje të TI, hapësira sportive (deri në vitin 2025)

## INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE: SHËNDETËSIA

**Qëllimi 2: Ofrimi I shërbimeve cilësore të shëndetësisë me zhvillim të vazhdueshëm profesional**

Objektiva 2.1. Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi përmes ofrimit të infrastrukturës së objekteve shëndetësore deri në 2022

Objektiva 2.2. Rregullimi i infrastrukturës për mirëqenia sociale

## INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE: KULTURA, SPORTI, HAPËSIRAT PUBLIKE DHE HAPËSIRAT E GJELBRA

**Qëllimi 3: Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit, dhe rritja e hapësirave publike dhe të gjelbra**

Objektiva 3.1. Ofrimi i qendrave kulturore multifunksionale ne 5 nën qendrat e komunës (deri ne 2025)

Objektiva 3.2. Shtimi i hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra, duke përfshirë shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë

Objektiva 3.3. Fuqizimi i sportit dhe rekreacionit përmes ofrimit të hapësirave sportive (të mbyllura dhe të hapura) deri ne vitin 2030

## MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIK

**Qëllimi 1: Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë**

Objektiva 1.1. Krijimi i mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm të kualitetit të ajrit për gjithë territorin e komunës (mekanizmat matës të jenë aktivë më së largu nga fillimi i vitit 2021)

Objektiva 1.2. Monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të resurseve natyrore deri në vitin 2025

Objektiva 1.3 Pyllëzimi si masë anti-ndotëse deri në vitin 2027

**Qëllimi 2. Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv**

Objektiva 2.1. Përmirësimi i kualitetit të ujërave të rrjedhshëm, për 40% deri në vitin 2022

Objektiva 2.2. Pastrimi dhe rigjenerimi i të gjitha deponive ilegale deri në vitin 2021

Objektiva 2.3 Pyllëzimi dhe ripyllëzimi si masë antierozive deri në vitin 2027

Objektiva 2.4 Pastrimi dhe rikultivimi i zonave të degraduara nga veprimtaritë eksploatuese të drurit dhe gurëve apo nxjerrja e zhavorrit

**Qëllimi 3. Sigurimi i një mjedisi më të sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë**

Objektiva 3.1. Zvogëlimi i ndikimeve nga vërshimet e lumit Drenica, deri në vitin 2025

**Qëllimi 4: Krijimi i qasjes së integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore**

Objektiva 4.1. Konzervimi dhe mbrojtja e vlerave të TK dhe TN (asetet që kanë status të mbrojtur dhe ato të propozuara) në funksion të zhvillimit të turizmit, deri në vitin 2024

Objektiva 4.2. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve përmes programeve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, deri në vitin 2023

## VENDBANIMET

**Qëllimi 1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës**

Objektiva 1.1. Përmirësimi i performansës së Drejtorisë së Inspeksionit

Objektiva 1.2. Parandalimi i ndërtimeve pa leje

**Qëllimi 2: Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime**

Objektiva 2.1. Ofrimi I shërbimeve dite në javë (administratë, kulturë etj.) në të gjitha nën-qendrat, aktive nga viti 2022

Objektiva 2.2. Rregullimi infrastrukturës në 3 VBJ , brenda 5 viteve

Objektiva 2.3. Rregullimi i çështjeve pronësore

## BANIMI

**Qëllimi 1: Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues të banimit**

Objektiva 1.1. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale për menaxhim në fushën e banimit, së paku 5 profesionist komunal të trajnuar

Objektiva 1.2. Evidentimi dhe futja ne shfrytëzim e 80% të kapaciteteve të pashfrytëzuara të banimit deri në 2025

Objektiva 1.3. Rritja e efiçiencës energjetike 50% në objektet e banimit në të gjithë komunën, kompletimi deri në vitin 2030

DRAFT

**Qëllimi 2: Plotësimi i nevojave për banim**

Objektiva 2.1. Sigurimi i banimit adekuat për 10% të familjeve në nevojë deri në vitin 2022

Objektiva 2.2. Rritja e fondit të banimit të përballueshëm për 50% deri ne vitin 2022

## KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

### SKENARI 1 – GLLOGOCI KOPSHT I PRISHTINËS

Ky është skenari i preferuar i cili përfshin rastin kur Feronikeli vazhdon të jetë aset kryesor ekonomik në Gllogoc dhe me ndikim në mjedis. Në këtë rast ndikimi në mjedis vazhdon të monitorohet dhe të mbahet nën kontroll duke aplikuar masa të nevojshme mbrojtëse.

Për më tepër agrikultura vazhdon të jetë e subvencionuar por me përqendrim dhe specializim në cilësi, bio-produkte dhe target tregjet lokale. Me qëllim të shmangies të transportit të mallrave në distanca do të krijohen pikat grumbulluese për prodhime lokale dhe themelohen kooperativat ku mund të shiten e produktet e agrikulturës. Parashihen katër pika grumbulluese ku njëkohësisht mund të shfrytëzohen edhe për tharjen e pemëve: njëra është vendos në segmentin ndërlidhës në mes të Gllogocit dhe Komoranit, e dyta në Arllat, e treta në Gllanasellë dhe e fundit në Tërstenik.

Sa i përket vendbanimeve ato parashihen të jenë kompakte me 2 qendra kryesore Komoranin dhe Gllogocin, nën-qendrat Baicë, Gllanasellë, Tërstenik, Arllat dhe të shmanget shtrirja e pakontrolluar e të gjitha vendbanimeve brenda territorit të komunës.

Për të zvogëluar shpenzimet e mobilitetit është propozuar që të përmirësohet lidhja e trenit mes Prishtinës dhe Gllogocit si dhe të bëhet lidhje e re me hekurudhore në mes Gllogocit, Komoranit, stadiumit nacional të ri, zonës ekonomike, pastaj aeroport ndërkombëtar dhe qytet të Prishtinës.

Për me tepër për adhurues të ecjes në mal ky skenar parasheh turizmin malor në Qyqavicë. Ky skenar përfshin valorizimin e aseteve të kulturës dhe të natyrës duke pasur në konsideratë Zonën e Veçantë të Kleqkës dhe Divjakës dhe trajtimit të saj në harmoni me planin e hartuar. Hapësira rreth stadiumit nacional kompletohet me gjithë infrastrukturën e nevojshme që do të përballojë fluksin e shikuesve.

<u>Mangësia</u> e vetme e këtij skenari është që Feronikeli vazhdon të funksionojë por <u>përparësi</u> është që skenari propozon masa të vazhdueshme për mbrojtjen e mjedisit.




Skenari i aprovuar




DRAFT

**TËRESITË HAPËSINORE**

Karakteristikë identifikuese e komunës se Gllogocit janë tri tërësi hapësinore te cilat dallojnë nga natyra e tyre e zhvillimit mjedisor, morfologjike si dhe shfrytëzimi i tokës.




- **Tërësia Qendrore-dinamike** përbëhet nga vendbanimet qendrore, pra polet Gllogoc dhe Komoran te cilat ofrojnë kushte për zhvillim te shërbimeve kyçe dhe biznesit. Polet kyçe Gllogoc dhe Komoran duhet te ofrojnë hapësirë për zhvillimin e shërbimeve në shërbim të tërë banorëve të komunës. Përderisa, decentralizimi i shërbimeve përmes nën qendrave Arllati, Baica, Gllanasella dhe Tërstenik nuk duhet ta zvogëlojë rëndësinë që kanë polet kyçe, por vetëm te shërbejë për ofrim të shërbimeve te përzgjedhura në afërsi te banoreve në vendbanime të ndryshme.
- **Tërësia e Maleve dhe Pejzazheve** që formojnë një unazë mbrojtjeje përgjatë kufirit te komunës dhe paraqet një kompleks kryesisht malor. Shquhet me resurset natyrore të pyjeve, me kullosa dhe motive peizazhi dhe asete turistike të cilën duhet te zhvillohen veprimtaritë ekonomike: pylltari, turizëm, bujqësi dhe blegtori. Veprimtaritë ekonomike të cilat mund të zhvillohen këtu, duhet të jenë në pajtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, që mundëson atë lloj të veprimtarive që është e përkushtuar të ketë ndikim minimal negative në mjedis dhe kulturën lokale, përderisa rritet ndikimi pozitive ne elemente te caktuara dhe njëherit mundëson krijimin e të hyrave dhe vende të punës për komunitetin lokal.
- **Tërësia e Fushës-Bujqësisë** me situacion të ulët dhe kryesisht e pasur me toke bujqësore kualitative dhe potenciale ujore qe paraqet aset kyç për zhvillim te bujqësisë. Sfidat kyçe ne këtë tërësi hapësinore është mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore pasi qe tërësia e Fushës-Bujqësisë është pjesa më e populluar, me veprimtari ekonomike të bazuara kryesisht në agrikulturë. Kjo pjesë identifikohet me lidhje te mira infrastrukturore me kryeqytetin, me rrugë rajonale, me polet kryesore Gllogoc dhe Komoran si dhe nën-qendrat dhe vendbanimet tjera.

Funksionet kyçe për zhvillim në këtë tërësi hapësinore janë bujqësia, industria dhe veprimtari të lehta ekonomike.

**ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE:**

**VENDBANIMET -** Qyteti i Gllogocit do te vazhdojë te jetë qendër kyçe komunale për banim, biznes, aktivitete komerciale dhe industriale. Infrastruktura me e rëndësishme edukative, kulturore, sportive dhe shëndetësore do te përqendrohet ne qytetin e Gllogocit. Fshatrat përreth, fshatrat Çikatovë e Re, Poklek i Ri, Shtrubullovë, duhet te krijojnë lidhje te qëndrueshme me qytetin e Gllogocit dhe furnizim reciprok te infrastrukturës sociale. Kjo ndërlidhje ndërmjet qytetit te Gllogocit dhe fshatrave te afërt duhet te trajtohet me kujdes qe te mos krijohen gryka te ngushta komunikimi, sidomos trajtimi i hapësirës ndërlidhëse me Komoran.

Në këtë kuptim, Komorani do të formohet si qendër e re komunale me status të përafërt me qytetin e Gllogocit, duke u plotësuar me infrastrukturë të nevojshme edukative, kulturore, sportive dhe shëndetësore. Paralelisht, do te vazhdojë zhvillimi dhe përforcimi i 4 nënqendrave ne vendbanimet Arllati, Baicë, Gllanasellë dhe Tërstenik. Këto nën-qendra do te jene te pavarura ne ofrim te shërbimeve, si dhe te kenë mundësinë e akomodimit te aktiviteteve komerciale dhe industri.




**SHFRYTËZIMI I PLANIFIKUAR I TOKËS -** Me qëllim qe te sigurohet zhvillimi i ardhshëm i komunës, plani duhet te siguroje toke te mjaftueshme ndërtimore për banim, biznese dhe industri. Deri ne vitin 2028, parashihet nevoja për furnizim me 186 ha tokë ndërtimore. Me tutje përcaktohet qe qyteti i Gllogocit te dendësohet, te plotësohen hapësirat e pa zhvilluara brenda kufirit ndërtimor, për derisa zgjerimi ekzistues i ndërtimeve ne toka nen komasacion nuk do te lejohet. Projeksioni i sipërfaqes se nevojshme te tokës për zhvillim te banimit është bazuar ne projeksionin e rritjes demografike duke u ndërlidhur me parametrat e dendësisë ekzistuese ne pole, nën-qendra dhe fshatrat tjera. Duhet te theksohet qe plani rekomandon rritjen e dendësisë përgjatë gjithë hapësirave te banuara, duke i respektuar kufijtë ndërtimor te vendbanimeve përmes plotësimit dhe dendësimit brenda kufijve.




Shfrytëzimi i tokës




Toka ndërtimore

**BANIMI -** Në mënyrë që të zhvillohet banimi i qëndrueshëm në mënyrë të mirëfilltë, plani propozon Hartimin e strategjisë së banimit me qasje të integruar (jo vetëm atij social). Për të arritur këtë, nevojitet urgjent të ndërtohen kapacitetet profesionale për menaxhim në fushën e banimit.

**Menaxhimi dhe cilësia së fondit të banimit:** Në përgjithësi, nevojitet të balancohet nevoja e madhe për banim të rëndomtë edhe të atij të përballueshëm me njësitë e zbrazëta të banimit, sidomos në viset e largëta rurale. 80% te kapaciteteve te pashfrytëzuara te banimit duhet të futen në shfrytëzim.

Lagjet e banimit që janë ndërtuar pa leje në tokë të parcelizuar te klasit të I-IV pa infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit duhet të rregullohen dhe trajtohen sipas ligjit të legalizimit edhe për shkak të kushteve sanitare.

**INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT**

**INFRASTRUKTURA RRUGORE -** Duhet të bëhet zgjerimi i rrugëve dhe trotuareve, ku prioritet ka zgjerimi i rreth-rrotullimit në hyrje të Gllogocit si dhe zgjerimi i trotuarit dhe ndërtimi i atij në anën tjetër të rrugës Gllogoc-Poklek, në mënyrë që të evitohet tollovia e përditshme e makinave që hyjnë në Gllogoc dhe atyre që vazhdojnë për Skenderaj, si dhe tollovia dhe rreshti i gjatë i nxënësve që bëhet për të shkuar në shkollë të mesme dhe anasjelltas. Të gjitha rrugët në hapësirat urbane duhet të pajisen me trotuare në të dy anët, dhe në hapësirat rurale ato duhet të plotësohen me trotuare së paku në një anë të rrugës.

Qasja në Çikatovë të Vjetër-Ferronikeli: Duhet të bëhet rregullimi i qasjes së lagjes Morina në Çikatovë të Vjetër si dhe përmirësimi i qasjes së fëmijëve të Çikatovës deri në shkollë.

Infrastruktura hekurudhore: Në një kornizë kohore afatgjate planifikohet të projektohet dhe ndërtohet tramvaji i cili do të vazhdojë nga segmenti i planifikuar Prishtinë - Aeroporti i Prishtinës në drejtim të Stadiumit Kombëtar-Parkut të Biznesit, dhe i cili do të vazhdojë me ndalesë në Komoran dhe deri tek terminali në qytet të Gllogocit.

Zvogëlimi i ndotjes akustike: Në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i zhurmës së trenit, duhet që në bashkëpunim me Hekurudhat e Kosovës të vendosen barriera zanore në segmentet e trasesë që kalojnë afër vendbanimeve. Kjo vlen edhe për segmentet e rrugës nacionale dhe segmetin e autoudhës që kalojnë nëpër vendbanime.




**Transporti publik:** Të gjitha vendbanimet duhet të përfshihen me transport publik dhe të ofrohet transporti peri-urban pas orës 19:00 dhe gjatë pushimit veror të nxënësve. Edhe pse Gllogoci është qytet i vogël, duke marrë parasysh formën e tij të shpërndarë, dhe për të lehtësuar lëvizjen e të gjitha moshave prej njërës lagje në tjetrën nevojitet ofrimi i transportit urban. Vendet e ndalesave të autobusëve duhet të ndërtohen ashtu që të ofrojnë strehim nga kushtet atmosferike, vend për ulje dhe për vendosjen e orarit të operimit.

**Terminali multi-modal:** Duke marrë parasysh pozicionimin e stacionit të autobusëve në afërsi të hekurudhës, dhe me qëllim të lehtësimit të lëvizjes, propozohet që të ndërtohet një terminal i përbashkët i autobusëve dhe hekurudhor në vendin e tanishëm të stacionit të autobusëve. Ky terminal

DRAFT

do të shërbejë si ndalesë edhe për linjën e tramvajit e cila do të sjellë udhëtarët deri-nga stadiumi dhe aeroporti.

**ZHVILLIMI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT**

**INFRASTRUKTURA TEKNIKE**

**Ujësjellësi:** Rrjeti i ujësjellësi duhet te shpërndahet ne vendbanimet tek te gjitha vendbanimet e mbetura jashtë rrjetit, pra shtrirja ne Abri e Epërme, Arllat, Baicë, Domanek, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ulët, Godanc, Gradicë, Kishnarekë, Korroticë e Epërme, Likoshan, Negroc, Nekoc, Polluzhë, Sankoc, Shtuticë, Tërdec, Vasilevë, Vërboc dhe Vuçak. Ndërsa, ne Gllanasellë, Dobroshec dhe Llapushnik duhet te plotësohet dhe kompletohet rrjeti ekzistues i ujësjellësit.

**Kanalizimi:** Rrjeti i kanalizimit duhet te shpërndahet ne vendbanimet te cilat nuk kane rrjet te kanalizimit, pra në Gllanasellë, Gllobar, Terstenik, Verboc, Gradicë, Likoshan dhe Shtuticë. Të gjitha vendbanimet duhet të pajisen me rrjet kanalizimi qe bën trajtimin mekanik dhe fizik.

**Rrjeti i kanalizimit atmosferik:** Menaxhimi i ujërave atmosferikë do të bëhet përmes sanimit të sistemeve ekzistuese si dhe ndërtimit të sistemeve të hapura përgjatë rrugëve ku ato mungojnë. Duhet te ndahet plotësisht nga rrjeti i kanalizimit, si dhe trajtimi u tij duhet te përfshijë filtrim dhe ruajtje ne mënyrë qe te zvogëlohet ngarkimi i zonave te banimit, biznesi dhe industriale gjate sezonës se reshjeve. Këtu ka prioritet në aspekt kohor qendra e Gllogocit dhe Komoranit.

**Ujitja:** Në hapësirat ku nuk përfshihen nga sistemi i ujitjes "Ibër Lepenci", rrjeti i ujitjes për toka bujqësore dhe hapësira te gjelbra duhet te bëhet përmes akumulacioneve ekzistuese ujore ne lokacione të përshtatshme dhe ndërtimi i akumulacionit në fshatin Vërboc. Shpërndarja e ujit deri në toka bujqësore dhe do të bëhet përmes sistemeve të ujitjes me rënie të lirë dhe me sistem pompimi në raste tjera.

**Energjetika**: Duhet te vazhdohet me rikonstruimin e rrjetit nga ai 10kV ne 20kV, e me këtë edhe transformimin e trafo-stacioneve 10kV ne ato TS 20kV me qellim te përmirësimit te furnizimit kualitativ dhe kuantitativ me energji elektrike.

**Telekomunikacioni:** zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit te telekomunikacionit duhet te vendos ne shfrytëzim kabllo me fije optike dhe me mundësi të bartjes edhe të Internetit dhe televizionit kabllovik.

**Ngrohja:** Komuna e Gllogocit nuk ka sistem të ngrohjes qendrore. Për qellim te sistemimit te ngrohjes qendrore, duhet te bëhen përpjekje për të gjetur zgjidhje përmes mbështetjes nga niveli qendror qeverisës apo donatorë potencial.

**Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave**: ndër prioritet që paraqiten ne këtë fushë është zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për tërë territorin e komunës si dhe eliminimi i vazhdueshëm i deponive ilegale.

DRAFT







Energjia elektrike dhe termike (gjendja e planifikuar)







Plani i telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashme

Ujësjellësi dhe kanalizimi

**EKONOMIA -** Politikat zhvillimore lokale në komunën e Gllogocit luajnë rol thelbësor në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. Bashkëpunimi i pushtetit lokal me bizneset e vogla dhe të mesme vlerësohet si çelës i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. Zhvillimi ekonomik është planifikuar të zhvillohet duke u bazuar në resurset, kapacitetet dhe pozitën qendrore që ka komuna e Gllogocit në Kosovë. Potencialet kryesore mbi të cilat mbështetet zhvillimi ekonomik dhe gjenerimi i punësimit janë industria, toka bujqësore dhe bizneset (NVM-të). Duhet te stimulohen rritja e madhësisë së njësive bujqësore si arat, kopshtet dhe fermat, si dhe prodhimet bujqësore lokale do te kenë në shfrytëzim pikat grumbulluese ne lokacionet  Abri e Epërme, Tërstenik, Gllanasellë dhe Zabel i Ulët, potencialisht te organizuara ne forma te strukturave kooperative.

DRAFT






Zhvillimi ekonomik

**INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE -** Cilësia e shërbimeve shëndetësore (diagnostikimi, trajtimi dhe parandalimi i sëmundjeve, lëndimet dhe dëmtimet të tjera fizike dhe mendore, etj.) që u ofrohen pacientëve është e rëndësishme. Prandaj në mënyrë që të gjithë banorët në komunë të Gllogocit të kenë qasje dhe trajtim shëndetësor korniza e zhvillimit hapësinor planifikon ndërtimin e dy Ambulancave në Baicë dhe Abri dhe renovimin e objekteve ekzistuese në Tërstenik dhe Gllanasellë. Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) kontribuon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe rritjen e kënaqshmërisë së pacientëve. Duhet të theksohet se korniza parasheh çerdhe në Gllogoc dhe nën-qendra, trajnimet në të gjitha shkollat me vizion të ri për zhvillim.

Përmirësimi i mirëqenies sociale në tërë territorin e komunës së Gllogocit është i rëndësisë së veçante prandaj është vlerësuar se QMF mund të ofrojë qëndrime ditore për pleq. Për më tepër në Gllogoc propozohet ndërtimi i shtëpisë së pleqve dhe strehimores duke përfshirë edhe banimin social të integruar/përgjithshëm.

Në mënyrë që të shfrytëzohet maksimalisht prona publike do të ofrohen lokacione për vendosjen e varrezave të reja duke përfshirë edhe hapësirat për shërbime të varrimit.

Si elemente të rëndësishme të qytetit, objektet e kulturës duhet të ngrisin vetëdijen e njerëzve, besimin e tyre, ndërtojnë dhe forcojnë komunikimin mes njerëzve. Në mënyrë që të promovohet sa më shumë arti dhe kultura koncepti i zhvillimit planifikon ndërtimin e qendrës multi funksionale në Gllogoc (kinema, sallën koncertale, teatrin, muzeun, ofrimin e shërbimit të trajnimeve) dhe ndërtimi i shtëpive të kulturës në 4 nën-qendrat tjera.

Duke pasur parasysh që hapësirat e gjelbra janë tejet të rëndësishme për banorët ngase janë vende ku mund të zhvillohen aktivitete të ndryshme nga ana e të rriturve dhe fëmijëve duhet që të gjitha hapësirat e lira sidomos ato para ndërtesave shumëkatëshe të shndërrohen në hapësira për gjelbërim ndërsa lokacioni tek pishat në Gllobar të shndërrohet në park.




Hapësiat publike dhe sociale




Hapësirat sportive

**MJEDISI DHE FATKEQËSITË NATYRORE -** Pasi që Feronikeli është një ndër ndotësit kryesor të ajrit, rekomandohet që ndikimi në mjedis të monitorohet përmes matjeve të vazhdueshme të përqendrimit SO2, CO, NO2, O3 dhe përqendrimit të pluhurit në qendër të qytetit dhe vendbanimet afër Feronikelit.
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Dobroshec është zgjidhje e qëndrueshme dhe afatgjate që parasheh ky plan për adresimin e ndotjes së ujit respektivisht të lumenjve Drenica dhe Vërboc ku monitorimi i rregullt të lumenjve është i domosdoshëm.

Duke konsideruar faktin që territori i Gllogocit e posaçërisht hapësira rreth lumit Drenica rrezikohet nga vërshimet atëherë propozohet mbrojtje me përdorim të materialeve "miqësore" në formë të barrierave në pjesët ku mund të vërshojë uji (jo tërësisht) ndërsa përdorimi i materialeve masive ndalohet ngase pengon drenazhimin natyral të ujit.

Pasi që skorja nga Feronikeli e mbulon një hapësirë prej 24 ha dhe zona e ndikimit është 45 ha atëherë parashihet që rreth skorjes të ketë tampon zonë nga gjelbërimi që do të pengonte shpërndarjen e pluhurit në pjesë tjera të territorit dhe njëkohësisht do të pasuronte ajrin me sasi të oksigjenit.

**ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE DHE TURIZMI -** Trashëgimia kulturore si një ndër elementet më të rëndësishme dhe pjesë përbërëse e mjedisit jetësor konsiderohet faktor i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit prandaj është më se e domosdoshme të mbrohet dhe promovohet. Duke konsideruar këtë fakt kaq të rëndësishëm korniza e zhvillimit parasheh konservimin dhe promovimin e vazhdueshëm të aseteve: Qyteza e vogël dhe e madhe në Vuçak, Kalaja e Llapushnikut, Tuma e vetmuar në Llapushnik, Fortifikata parahistorike "Gradina" në Çikatovë të Vjetër, Kalaja - Çuka e Godancit, Kalaja Antikë dhe Mesjetare në Vërboc.
Sa i përket trashëgimisë arkitekturale propozohet konservimi i aseteve tani më të mbrojtura: Polluzhë/Kulla Shaban Poluzha, Dobroshec/Kulla e Habib Xhemajlit. Është vlerësuar që brenda territorit të Gllogocit janë të pranishme edhe vlera si në vijim: Qikatovë e Vjetër/Kullë Ibish Morina, Kompleks Banimi/Familja Dervisholli, Gradicë, Shtëpi banimi i Smajl Haxhiu/Poklek i Vjetër, Mulliri Gani Syla, Kishnarekë Shtëpi Banimi Rexhep

DRAFT

Zariqi, Shtëpi Banimi Muharrem Veseli Korroticë e Ulët, Stacioni i Trenit – Baicë, Stacioni i Trenit Gllogoc, Stacioni i Trenit - Dritan (Dobroshec). Duhet theksuar se një pjesë e Zonës së Veçantë të "SHTABI I PËRGJITHSHËM I UÇK-ËS KLEÇKË DHE DIVJAKË" i takon territorit të komunës së Gllogocit dhe si zonë do të vazhdojë të jetë e mbrojtur.




Mbrojtja nga rreziqet natyrore




Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

## PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PLANI I VEPRIMIT

| Qëllimi | Poentimi |
| --- | --- |
| **Vendbanimet -** Qëllimi 1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës | **61** |
| **Zhvillimi ekonomik** | **59** |
| Qëllimi 2: Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM) | |
| **Ujësjellësi, kanalizimi dhe ujitja** | **54** |
| Qëllimi 2: Zhvillimi I infrastrukturës se ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) si dhe ujitjes | |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi)** | **39** |
| Qëllimi 1: Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë | |
| **Infrastruktura publike dhe sociale (Arsimi)** | **24** |
| Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë | |
| **Zhvillimi ekonomik -** Qëllimi 1: Nxitja e zhvillimit te bujqësisë | **23** |
| **Mirëqenia sociale -** Qëllimi 3: Përmirësimi i mirëqenies sociale | **11** |
| **Mbeturinat -** Qëllimi 3: Përmirësimi I sistemit te menaxhimit te mbeturinave te tere territorin e komunës | **11** |
| **Infrastruktura teknike (Energjetika)** | **10** |
| Qëllimi 1: Rritja e kapaciteteve për furnizim te qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtritshme. | |

| | |
|---|---|
| **Trashëgimia kulturore dhe natyrore -** Qëllimi 4: Krijimi i qasjes se integruar në mbrojtje te trashëgimisë kulturore dhe natyrore | **10** |
| **Infrastruktura publike dhe sociale (Shëinndetësia) -** Qëllimi 2: Ofrimi i shërbimeve cilësore te shëndetësisë me zhvillim te vazhdueshëm profesional | **9** |
| **Infrastruktura sociale – Kultura, sporti, hapesirat publike dhe hapesirat e gjelbra** Qellimi 4: Ngritja e infrastruktures per objektet e kultures, sportit dhe rritja e hapesirave publike dhe te gjelbra | **6** |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi) -** Qëllimi 3: Sigurimi i një mjedisi me te sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë natyrore dhe tjera | **6** |
| **Transporti -** Qellimi 4: Sigurimi I transportit të integruar për komunën e Gllogocit | **5** |
| **Zhvillimi ekonomik -** Qëllimi 3: Zhvillimi i resurseve njerëzore ne përputhje me kërkesat e tregut | **5** |
| **Banimi -** Qëllimi 2: Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues te banimit | **4** |
| **Banimi -** Qëllimi 3: Plotësimi i nevojave për banim | **4** |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi) -** Qëllimi 2: Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv | **3** |
| **Vendbanimet -** Qëllimi 1: Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime | **1** |

## KORNIZA STRATEGJIKE

Gjatë hartimit të PZHK-së janë marrë parasysh të gjitha dokumentet relevante të cilat kanë ndikim në orientimin strategjik të komunës së Gllogocit. Rëndësi e veçantë në këtë aspekt i është kushtuar prioriteteve strategjike të "Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+", i cili në të njëjtën kohë ka shërbyer si bazë për orientimin strategjik të PZHK-së paraprake të Gllogocit, por edhe të planeve tjera hapësinore për zona të veçanta siç është Plani hapësinor i Zonës së Interesit të Veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë". Duhet të ceket që janë marrë për bazë të gjitha strategjitë sektoriale, lokale, rajonale dhe qendrore, varësisht prej sektorit dhe implikimeve të tyre në hapësirë. Shumica prej tyre janë listuar më poshtë.

**Strategjitë sektoriale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal dhe qendror**

- Strategjia për zhvillimin ekonomik në Komunën e Gllogocit - 2015 – 2019
- Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2021 (SKZH)
- Plani i menaxhimit të mbeturinave 2015-2020;
- Strategjia për gratë ndërmarrëse në komunën e Gllogoc (Gllogoc)it për periudhën 2017-2022
- Identifikimi i produktit turistik në rajonin e Prishtinës, MTI, 2017
- Strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2013-2022

**Strategjitë që përfshihen ne Planin Hapësinor të Kosovës, strategjia e zhvillimit hapësinor 2010-2020**

Në kuadër të "Planit Hapësinor të Kosovës", në bazë të strukturave hapësinore të zhvillimit që i përcakton ky plan, Komuna e Gllogocit bën pjesë në "Hapësirën e kaltër" apo Portin e Kosovës, së bashku me komunat Prishtinë, Obiliq, Podujevë, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Shtime.

| |
|---|
| *Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të planifikuar urban, konkurrente me njëra tjetrën e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Të lidhura në rrjet, qytetet në këtë zonë krijojnë kushte të volitshme për veprimtari ekonomike, industriale, komerciale dhe shërbyese* |

Kutia 1. Vizioni i Portit të Kosovës

DRAFT




Harta 1. Strategjia e zhvillimit hapësinor – Porti i Kosovës

Në qendër të zonës së kaltër, parashihet TZHEK - Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, si kurriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare si dhe zonë e mundshme për investitorët e kompanive ndërkombëtare.

<u>Qëllimet e përgjithshme në kuadër të "Hapësirës së Kaltër" janë si në vijim:</u>

- Zhvillimi i rrjetit e atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetës së qytetarëve, punësimit dhe barazi sociale;
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda urbane, ndër urbane me hapësirat tjera dhe më gjerë lidhjet e fuqishme rajonale përmes zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore, TI-së);
- Promovim i TZHEK, lokacion për grupim aktivitetesh në aspekt hapësinor, investime të huaja, kompani multinacionale;
- Mbështetje aktiviteteve hulumtuese dhe zhvillimore, për një ekonomi të njohurive, mbështetur nga kapacitetet organizative;
- Promovimi i Prishtinës si qendër e diturisë të rajonit më të gjerë të Evropës Juglindore;
- Zhvillim i aktiviteteve administrative, arsimore, shërbyese tregtare, energjetike, agro-industriale e turistike.

Obligimet që dalin nga Korniza e zhvillimit hapësinor të PHK për PZHK-në e Gllogocit janë:

Qendrat e vogla si Drenasi, Lipjani, Podujeva dhe Novobërda (Zona e Kaltër); ..... përfaqësojnë grupin e qendrave të cilat në zhvillimet e ardhshme hapësinore duhet të luajnë rol aktiv në:

- përmirësimin e ofertës së shërbimeve dhe ato të jenë më efikase, në forcimin e lidhjeve me fshatrat përreth dhe në përpjekjen që zona si tërësi të funksionojë në bazë të programeve të përcaktuara zhvillimore.

Vendbanimet me zhvillim të pamjaftueshëm

Zhvillimi i pamjaftueshëm konsiston kryesisht në mungesat sa u përket infrastrukturës sociale dhe teknike në këto vendbanime. Aktivitetet që duhet të ndërmerren për ngritjen e nivelit të zhvillimit të këtyre infrastrukturave janë në funksion të arritjes së synimit për një zhvillim të balancuar të trevave të Kosovës. Aktivitetet janë:

- Përpjekjet më të mëdha për zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara. Komunat e ...., Drenasit, .... duhet të kenë përparësi në investimet qeveritare për ngritjen e kapaciteteve të reja të infrastrukturës sociale dhe teknike dhe riaktivizimin e kapaciteteve ekzistuese ekonomike;
- Të stimulohet bujqësia dhe blegtoria në mënyrë që të ulet edhe shkalla e migrimit prej fshatrave në qytete;
- Në aspektin e zhvillimit të infrastrukturës sociale duhet të ndërtohen shkolla dhe punkte shëndetësore të reja, shpërndarja e tyre të jetë adekuate dhe të përmirësohet infrastruktura shkollore dhe shëndetësore, kurse shërbimet të zgjerohen edhe në ato specialistike të mundshme për këto komuna;
- Në aspektin e infrastrukturës teknike, në këto zona do të duhej të investohet në asfaltimin e rrugëve, në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së rrymës elektrike, vendosjen e trafostacioneve të reja për përmirësimin e tensionit të rrymës elektrike, në zhvillimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve, në zhvillimin e sistemeve të ujitjes, në rrjetin e telefoninë fikse dhe të Internetit;

Stimulimi i zhvillimit rural me qëllim të zvogëlimit të migrimit të qytetareve ne hapësirat urbane

- 4.1.2.9.1. Mbrojtja me ligj e tokës kualitative bujqësore të kategorisë 1-4
- Aktivitetet: Me rastin e zgjerimit të qyteteve dhe vendbanimeve (me planet urbanistike), të mbrohet toka sidomos kategoria e I,II,III,IV, në harmoni mbi Ligjin për tokat bujqësore si dhe kategoritë tjera të tokës të cilat janë nën sistem të ujitjes.

DRAFT

Zhvillimi dhe integrimi i infrastrukturës dhe komunikimit

- Zhvillimi i stacioneve hekurudhore e posaçërisht e stacioneve Prishtinë, F.Kosovë, Podujevë, Livadhi, Mitrovicë, Leshak, Drenas, Klinë, Pejë, Ferizaj, Kaçanik, H.Elezit, Prizren dhe ndërtimi i stacioneve të reja në Gjilan dhe Gjakovë
- Ndërtimi i akumulacioneve ujore të Dobroshevcit, komuna e Drenasit

**Strategjitë prej planeve të mëparshme komunale**

Plani Zhvillimor Komunal – Gllogoc 2008-2020+: Në PZHK-në e kaluar ceket që Gllogoci duhet të jetë " komunë me zhvillim të planifikuar të ndërtimit, industrisë, xehetarisë dhe bujqësisë". Plani rekomandon që Gllogoci në bazë të burimeve të tij të minareleve, potencialit njerëzor dhe njohurive të teknologjisë duhet të funksionojë si qendër në rajonin e Drenicës. Si bazë për të ardhmen ekonomike tësigurohet nga Industria dhe Tregtia. Ndërsa në pjesë rurale jeta duhet të bazohet në bujqësi, industri familjare dhe turizëm. Për të arritur këto atëherë plani rekomandon që ajri duhet të jetë i pastër, trashëgimia e ruajtur kulturore si dhe infrastruktura rrugore duhet të jetë e mirë.

Plani ofron hartë për shfrytëzim të tokës ku identifikohen hapësirat rurale, malore, rrafshinore, zona për zhvillim të industrisë dhe komerciale si dhe parku industrial.

Plani identifikon zonën urbane dhe trajton fushat tematike (pejsazhin dhe mjedisin, trafikun dhe transportin, infrastrukturën teknike, infrastrukturën sociale) dhe jep propozime për të ardhmen si zgjerim të hapësirave, rregullim të rrugëve etj.

Plani në hartën e shfrytezimit të tokës përfshin zona që mund të akomodojnë rritjen e ardhshme mirëpo nuk jepen llogari të sakta për proporcioni numër të banorëve me sipërfaqe në hektar. Ceket se për qendër duhen edhe 50 ha shtesë, për qendra dytësore 2.2. ha dhe fshatra 1.2 ha.

PZHK 2008-2020+ propozon pakon e fushëveprimeve dhe prioriteteve strategjike. Pakoja ndahet në projekte për vendbanime, peizazh, trafik dhe infrastrukturë teknike. Në vazhdim plani jep tabelat me projekte për komunë me afate kohore për secilin prioritet që nuk janë krejtësisht identike me ato të përmendura paraprakisht por janë si në vijim: Hartimi i Planeve paraprake, Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, Ofrimi i infrastrukturës së domosdoshme për krijimin e kushteve për investime në zhvillim ekonomik, shfrytëzimi racional i territorit, përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe krijimi i asaj hekurudhore, përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe teknike.

Projektet për secilin prioritet të zonës urbane gjithashtu përfshihen dhe janë me ndryshe të formuluara nga ato komunale: hartimi i planeve përkatëse, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, infrastruktura teknike, demografia dhe çështjet sociale dhe zhvillimi ekonomik.

PZHK-së i mungon lidhja kronologjike e synimeve me objektiva dhe objektivave me veprime/projekte.

**Strategjitë rajonale dhe strategjitë e komunave fqinje**

Plani hapësinor i "SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË UÇK-ËS KLEÇKË DHE DIVJAKË"

Komuna e Gllogocit bën pjesë me 41% të totalit të sipërfaqes të Zonës me Interes të Veçantë ,,SHP. UÇK. Kleçkë-Divjakë'', i cili në total është 39km2. Përveç Gllogocit pjesë e Zonës me Interes të Veçantë janë edhe komunat Malishevë dhe Lipjan. Zona e Interesit te Veçantë "SHP UÇK Kleçkë-Divjakë" shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës me lartësi mbidetare 900-1025m. Kurrizi malor lidhet nëpërmjet grykave malore me dy regjionet e Kosovës, me rrafshin e Kosovës dhe me me Rrafshin e Dukagjinit.Kjo zonë karakterizohet me veçori gjeomorfologjike, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore-historike. Zona ishte çerdhe e luftës ku ka qenë i vendosur edhe shtabi i UCK-ës. Nga kjo zonë mbaheshin të gjitha komunikimet me zonat e tjera të luftës në Kosovë, si dhe bëhej organizimi i logjistikës ushtarake dhe civile.

DRAFT



Harta 2. Strategjia e zhvillimit hapësinor – ZIV ”Kleçkë-Divjakë”

Në periudhën e ofensivave luftarake me forcat serbe, në vendbanimet përgjatë vargmaleve të Berishës, gjetën strehim, mbrojtje dhe përkujdesje nga UÇK-ja mbi 85 mijë civilë. Për të strehuarin në këtë zonë u sigurua ushqim, veshmbathja, përkujdesja shëndetësore dhe për fëmijët u organizua edhe zhvillimi i procesit mësimor në shkollat-tenda. Pas luftës, në Kleçkë janë rivarrosur të gjithë dëshmorët e Brigadës 121 “Ismet Jashari – Kumanova.” Duke e pasur parasysh rëndësinë historike të zonës, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është shpallë Zonë e Interesit të Vecantë. Brenda territorit të komunës së Gllogocit janë të pranishme lokacionet e mbuluara me pyje dhe kullosa, të cilat japin një pamje shumë tërheqëse dhe shërbejnë si vende për strehimin e faunës. Po ashtu kjo pjesë karakterizohet me prezencën e monumentit natyror me karakter gjeomorfologjik i ashtuquajtur Guri i Gradinës që i jep zonës pamje mjaft atraktive.

Guri i Gradinës është monument natyror i cili arrin lartësinë 30 m, shtrihet në një sipërfaqe rreth 2 hektar, në pjesën jug-lindore të fshatit Llapushnikë në vendin e quajtur Gradinë, me lartësi mbidetare 976 m. Guri i Gradinës si monument natyrorë ka vlera unikate shkencore, kulturo-historike turistike, gjeomorfologjike, gjeologjike dhe arkeologjike, vlerat natyrore të tij nuk janë të dëmtuara në shkallë të gjerë me përjashtim të prerjeve ilegale të drunjtëve në këtë hapësirë[2]

Uji - Zona konsiderohet me rrjet hidrografik te rrallë dhe atë me burime ujore, proçka dhe përrenj. Rrjeti ujor i takon kategorisë së parë (pa ndotje).

Ajri - Është evidente ndotja e ajrit, sepse në disa lokacione brenda zonës gjenden furrat për djegien e gëlqeres, që si lëndë të parë përdorin gomat, kështu ndotja e ajrit ndodh në kohën kur bëhet pjekja e gëlqeres, sepse pas këtij procesi lirohet në atmosferë metani dhe dyoksidi i karbonit në formë tymi.

Trashëgimia natyrore- Në këtë zonë janë të pranishme lokacionet e mbuluara me pyje dhe kullosa, të cilat japin një pamje shumë tërheqëse dhe shërbejnë si vende për strehimin e faunës. Po ashtu kjo pjesë karakterizohet me prezencën e monumentit natyror me karakter gjeomorfologjik i ashtuquajtur Guri i Gradinës që i jep zonës pamje mjaft atraktive. Në zonën përreth në të gjitha ekspozicionet është prezentë fitocenoza Fagetum Montanum me rreth 47 lloje që kanë një shtrirje mjaft të gjerë përreth monumentit. Kurse në aspektin e faunës, sipas të dhënave që posedon AKMM në këtë hapësirë hasen këto lloje shtazore: 8 lloje gjitarësh, ndërsa dy lloje të tjera të gjitarëve janë zhdukur, 9 lloje shpendësh, 4 lloje zvarranikësh, 2 lloje ujë-tokësor.

*Park historik-kulturor dhe me vlera natyrore, i përkujtimit të luftës së popullit për çlirim, në shërbim të edukimit, promovimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.*

[2] Studim për mbrojtjen e vlerave të natyrës Guri i Gradinës si monument i natyrës – MMPH/AKMM

DRAFT

Kutia 2. Vizioni i Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë SHP UÇK Kleçkë-Divjakë

|  |
|---|
| *S1.O1. Edukimi, informimi dhe promovimi i vlerave historike, kulturore, natyrore dhe turistike për ZIV"SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë";* |
| *S1.O2. Promovimi i parkut historik dhe kulturori ZIV, brenda dhe jashtë Kosovës;* |
| *S1.O3. Bashkëpunimi i komunave në të cilat gjendet zona;* |
| *S1.O4. Menaxhimi objekteve historiko-kulturore dhe natyrore të zonës;* |
| *Synimi 2 - Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave natyrore të parkut* |
| *S2.O1. Mbrojtja e ajrit* |
| *S2.O2. Mbrojtja e ujit* |
| *S2.O3. Mbrojtja e tokës* |
| *S2.O4. Mbrojtja e peizazhit, biodiverzitetit dhe Monumenteve Natyrore brenda zonës* |
| *Synimi 3 - Zhvillimi rural* |
| *S3.O1. Zhvillimi i turizmit fshatar- ekologjik* |
| *S3.O2. Zhvillimi i blegtorisë, dhe bletarisë* |
| *S3.O3. Ngritja e cilësisë në arsimim dhe shëndetësi;* |
| *S3.O4. Sigurimi i qasjes përmes rrugëve në të gjitha objektet dhe monumentet e zonës dhesigurimi i transportit publik;* |
| *S3.O5. Sigurimi i furnizimit me energji elektrike;* |
| *S3.O6. Ndërtimi i infrastrukturës ujore;* |
| *S3.O7. Menaxhimi i mbeturinave* |
| *Prioritetet strategjike të PH të Zonës me Interes të Veçantë SHP UÇK Kleçkë-Divjakë:* |
| *-Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë historike - kulturore dhe mjedisit* |
| *- Zhvillimi i ekonomisë së qëndrueshme & i infrastrukturës fizike* |

Kutia 3. Synimet, objektivat dhe prioritetet strategjike të Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë SHP UÇK Kleçkë-Divjakë

DRAFT

# 2. PROFILI KOMUNAL DHE VLERËSIMI I GJENDJES

Në mënyrë që për lexuesin të jetë më e lehtë në këtë fazë, drafti i dy kapitujve të parë të PZHK-së, Profili dhe Vlerësimi i Gjendjes, janë prezantuar në një kapitull të përbashkët të ndara në fusha tematike.

## 2.1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

### 2.1.1.HISTORIA E ZHVILLIMIT

Komuna është themeluar para Luftës së Dytë Botërore si njësi sociale, politike dhe administrative e veçantë. Gjatë tetëdhjetë vjetëve të fundit zhvillimi ekonomik ka qenë tepër i ulët, ngase pushtetet e kaluara të dirigjuara nga qendra e kanë lënë anash Komunën e Gllogocit.

Komuna e Gllogocit ka qenë e orientuar në zhvillimin e bujqësisë ekstensive. Në vitet e '70-të fillojnë nismat e para të zhvillimit ekonomik të Gllogocit. Këto nisma të zhvillimit ekonomik përcillen edhe me zhvillimin hapësinor urban. Në vitin 1981 vendbanimi i Gllogocit shpallet qytet, e me këtë edhe qendër kryesore administrative, kulturore, sociale dhe komunës.

Kjo komunë ka hedhur disa hapa drejt transformimit gradualisht (ndonëse të ngadalshëm) të strukturave të saj ekonomike, bujqësore, arsimore, shëndetësore dhe industriale. Në përmirësimin e strukturës së zhvillimit komunal ka ndikuar sidomos ndërtimi i rrjetit arsimor-edukativ, rrjetit të shërbimit shëndetësor dhe intensifikimi i zhvillimit bujqësor është bërë sidomos pas ndërtimit të sistemit të ujitjes "Ibër-Lepenc", ndërkaq një lëvizje pozitive në ekonominë e pazhvilluar të Gllogocit është shënuar pas ndërtimit të kompleksit "Feronikelit". Aktivizimi i Feronikelit, në vitin 1984, në masë të konsiderueshme ndikoi që brenda një kohë të relativisht të shkurtër të arrihej gati te mesatarja e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Prej vitit 1999, kushtet për zhvillimin e komunës kanë ndryshuar rrënjësisht. Ndryshimi i madh i kushteve për zhvillim ekonomik, social, industrial, për zhvillimin e strukturave urbane dhe rurale, kushtëzojnë adaptimin dhe përshtatjen e nevojave për të ardhmen.

### 2.1.2.POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE KLIMA



Harta 3. Pozita e komunës së Gllogocit në Kosovë

Territori i komunës së Gllogocit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Territori i Komunës së Gllogocit është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Komuna e Gllogocit ka një sipërfaqe prej 275,63km$^2$ me një lartësi mbidetare prej: 575 m, pika më e ulët, dhe 1072 m, pika më e lartë.

Komuna e Gllogocit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug- Perëndimore, Kosmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug-Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica.

Sa i përket komunave fqinje, në veri kufizohet me Komunën e Skënderajit, në VL me atë të Vushtrisë, në lindje me komunën e Obiliqit dhe Fushë Kosovës, në JL me Lipjanin, në JP me komunen e Malisheves dhe në Perëndim me atë të Klinës.

Në tabelën e mëposhtme janë vendosur edhe gjatësitë kufitare në mes Gllogocit dhe tyre.

| Kufizimi me komunat fqinje | Gjatësia kufizuese |
|---|---|
| Gllogoc-Obiliq | 6.7km |
| Gllogoc-Fushë Kosovë | 11.4km |
| Gllogoc-Malishevë | 24.6km |
| Gllogoc-Lipjan | 15.8km |
| Gllogoc-Klinë | 0.6km |
| **Total perimetri** | **98.5km** |

Tabela 1. Gjatësia kufitare e Gllogocit me komunat fqinje

Kjo komunë, në pikëpamje të ndërlidhjës tokësore lidhet më pjesët tjera të Kosovës më anë të hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugës magjistrale Prishtinë – Bushat (Komoran)-Pejë, dhe rrugët ndërkomunale Shalë- Lipjan dhe Bushat-Gllogoc-Skënderaj.

**Hidrografia**- Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Gllogocit është Drenica, e cila është degë e majtë e lumit Sitnica dhe i takon pelgut të Ibrit. Ajo buron në Bretenc te mali Cërralevë. Drenica që nga Gllogoci e deri në Bardh i Madh, hyn në një pjesë të ngushtë, duke marrë pamjen e një gryke. Në këtë pjesë të lumit pjerrtësia është më e madhe, gjerësinë më të madhe (10 m) dhe me pjerrtësi të butë derdhet në Sitnicë. Prurja mesatare e lumit Drenica në Sitnicë është 2,0 $m^3/s$. Drenica ka dhe degëzimet e veta siç është Verbofc. Në territorin e komunës së Gllogocit ndodhet edhe Liqeni i Vasilevës. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit mineral në Poklek me temperaturë 13.0˚C, pH 6.3., rrjedhje 1.00l/sec dhe mineralizim 3.52 si dhe ai në Vërboc, lagjja Istog. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes "Ibër-Lepenc".

Klima - Kushtet klimatike janë mjaft të përshtatshme. Rajoni ka një klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohtë dhe verë të ngrohtë me ndikime të klimës mesdhetare. Kjo vie nga pozita e komunës në mes te Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Rrafshi i Dukagjini ka klime me ndikime mesdhetare nga deti Adriatik, kurse ai i Kosovës ka klime kryesisht kontinentale. Temperatura mesatare vjetore është 10.6 °C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm.

**Relievi** - Lartësia mbidetare është prej 500-650m. Rreth 46% e sipërfaqes së territorit të komunës së Gllogocit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo që është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore, ndërsa pika më e lartë është 1072m.

**Pedologjia dhe gjeologjia** - Tokat në këtë komunë janë mjaft heterogjene nga aspekti i krijimit, vetive fiziko-kimike, përkatësisë tipologjike, pjellorisë potenciale, problemeve melioruese etj.  Tokat në territorin e Komunës së Gllogocit sipas përbërjes pedologjike janë të përfaqësuara nga: tokat e murrme në shtresa kompakte, tokat e mesme të kuqërremtë, tokat e kuqe, tokat smonicë, tokat rendezinë, tokat ranker, tokat pseudogleje, tokat e livadheve, tokat diluviale dhe tokat aluviale etj.[3]

**Gjeologjia** - Gllogoci për nga struktura e tokës i takon Bazenit të Drenicës, që bën pjesë në Bazenet e Kenozoikut. Ndërtohet nga shkëmbinjë të Paleozoikut, me përbërje vullkanogjeno sedimentare të Triasikut. Në Qyqavicë, janë prezent edhe metamorfitet e Shtimës dhe ata permo-tirasik të Jezercit. Tereni është i përfshirë me thyerje të shumta tektonike, si atë të Baicës. Gllogocit, Kozmaqit, etj.[4]

| Emri | Sip_ha | % |
|---|---|---|
| Tokë e kuqe | 304 | 1.1 |
| Tokë e kuqërremtë | 6807 | 24.7 |
| Tokë e murrme kompakte | 4474 | 16.2 |
| Tokë e livadheve | 588 | 2.1 |
| Tokë aluviale | 601 | 2.2 |
| Tokë deluviale | 923 | 3.3 |
| Tokë pseudoglej | 4087 | 14.8 |
| Tokë ranker | 323 | 1.2 |
| Tokë rendzine | 2106 | 7.6 |
| Tokë smonice | 7350 | 26.7 |

Tabela 2. Sipërfaqja e llojeve të tokave sipas përbërjes pedologjike në ha dhe % (Burimi: Harta pedologjike, Baza e hidroekonomisë e KSA të Kosovës)

[3] Vlerësimi strategjik mjedisor i PZHK-së së Gllogocit
[4] Mundësitë e përdorimit të burimeve gjeotermike dhe perspektiva e tyre në Republikën e Kosovës, Atifete Zuna




Harta 4. Rrjeti hidrografik




Harta 5. Pjerrtësia e terenit




Harta 6. Llojet e tokave

## 2.2. DEMOGRAFIA

### 2.2.1.ZHVILLIMI DEMOGRAFIK

Analiza e zhvillimit demografik shqyrton të dhënat nga regjistrimet e popullsisë për periudhën e viteve 1948-2011. Në Kosovës nuk kishte regjistrim të rregullt te popullsisë ne mes te viteve 1981 deri në vitin 2011,ndërsa ai i vitit 1991 i zhvilluar nga Enti Federativ i Statistikës në Beograd, u bojkotua gati tërësisht nga banorët shqiptarë te Kosovës. Regjistrimi i vitit 2011 ka regjistruar vetëm banorët e përhershme të komunës, duke mos i kalkuluar banorët e përkohshëm, studentët dhe të punësuarit të cilët përkohësisht jetojnë në komunë.

| | Popullsia | | Ekonomitë Familjare (EF) | | Madhësia e Familjes (numri i anëtareve në EF) | | Pjesëmarrja e qytetit në komunë (%) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti | Komuna | *Qyteti* | Komuna | *Qyteti* | Komuna | *Qyteti* | Komuna | Qyteti |
| 1948 | 16177 | 558 | 2106 | 77 | 7.7 | 7.2 | 3.7 | 3.4 |
| 1953 | 17683 | 658 | 2295 | 95 | 7.7 | 6.9 | 4.1 | 3.7 |
| 1961 | 21125 | 836 | 2631 | 138 | 8.0 | 6.1 | 5.2 | 4.0 |
| 1971 | 28188 | 1343 | 3264 | 167 | 8.6 | 8.0 | 5.1 | 4.8 |
| 1981 | 39141 | 2440 | 4138 | 318 | 9.5 | 7.7 | 7.7 | 6.2 |
| 1991[5] | 53618 | 4499 | 5906 | 560 | 9.1 | 8.0 | 9.5 | 8.4 |
| 2011 | 58531 | 6143 | 8786 | 1047 | 6.7 | 5.9 | 11.9 | 10.5 |

Tabela 3 Të dhënat nga Regjistrimet e popullsisë në periudhat prej vitit 1948 – 2011

**Numri i banorëve -** Nga të dhënat e paraqitura të regjistrimeve të popullsisë rezulton që numri i popullsisë në Komunën e Gllogocit nga viti 1948 deri në vitin 2011 ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 42,354 banorë. Në bazë të kësaj rritjeje, brenda periudhës kohore 63 vjeçare, del se mesatarisht në qytet popullsia ka shënuar rritje prej rreth 672 banorë në vit. Përderisa ka rritje paralele në qytet si dhe vendbanimet tjera kur shikohen si vlera ne %, por duke i analizuar numrat e banoreve si njësi – numri i banorëve në vendbanimet tjera te komunës së Gllogocit është dukshëm më i madh se rritja e numrit të banorëve në qytet të Gllogocit. Kështu në qytet Gllogoc nga viti 1948 deri në vitin 2011 numri banoreve ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 8,228 banorë duke u rrit me më shumë se 10 fish sa ishte ne vitin 1948, pra vendbanim me vetëm 558 banorë. Ndërsa, rritja e popullsisë është evidentuar të jetë edhe më e madhe në vendbanimet tjera te komunës se Gllogocit. Nga 15,619 banorë që jetonin ne vendbanimet përreth qytetit të Gllogocit në vitin 1941, ky numër është rritur në 52,388 banorë.

Fenomeni i urbanizimit te qyteteve që vërehet në shumicën e qyteteve në Kosovë, sidomos në periudhën e pasluftës, pra migrimi i brendshëm fshat-qytet - nuk duket të jetë aq i theksuar ne Komunën e Gllogocit.

**Madhësia e familjes** - Madhësia mesatare e familjes në qytet del te jete më e vogël se në vendbanimet tjera ne komune. Në qytet mesatarisht familjet i kanë nga 5.9 anëtarë, përderisa në nivel te komunës i kanë nga 6.7 anëtarë.




**Mosha** -Grafiku prezanton të dhënat për strukturën e popullsisë sipas grup-moshave prej 0-4 vjeç deri në moshën 80+ vjeç. Nga te dhënat vërehet që grup-mosha 20 – 24 vjeç dominon me numër të popullsisë në krahasim me grup-moshat tjera.

**Gjinia** - Struktura e përgjithshme e popullsisë sipas gjinisë është burra/djem 51 % dhe gra/vajza 49%, kështu duke dominuar numri i burra/djem me një përparësi të vogël prej 2%. Më tutje vërehet se në grup-moshat 65+, rritet diferenca ne favor te grave/vajzave, gjë qe na sjell ne përfundim qe

[5] Regjistrimi nga Entit Federativ te Statistikës në Beograd

Grafiku 1 Popullsia e komunës së Gllogocit sipas regjistrimeve 1948-2011




Grafiku 2 Popullsia e paraqitur në tri grup-mosha, nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011

jetëgjatësia e femrave është më e lartë se jetëgjatësia e meshkujve.

Mosha e re 0 - 14 vjeç merr pjesë me 29.5 % në popullsinë e Gllogocit, ndërsa grup-moshat 15 - 64 që është popullsi aktive (e aftë për punë) merr pjese me 64.8%, kurse mosha 65 vjeç e më tepër kanë pjesëmarrje të vogël me rreth 5.6 % të popullsisë së përgjithshme. Në përgjithësi grup-moshat e popullsisë 15 – 64 vjeç dominojnë në popullatën e përgjithshme. Struktura gjinore e popullsisë ka karakteristikat e veta me dominim të gjinisë mashkullorë.

Dendësia e popullsis - Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, dendësia e popullsisë në komunën e Gllogocit është rreth 212 banorë në 1 km², që është mbi mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Nga harta vërehet se dendësia më e lartë e popullsisë e është në qytetin e Gllogocit ku mesatarisht jetojnë rreth 1651 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Shtrubullovë (395 b/km²), Komoran (389.5 b/km²), Çikatovë e Re (363.1 b/km²), Nekoc (301.3 b/km²), Gllabar (300.4 b/km²),etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Vasilevë (65.7 b/km²), Gradicë (68.7 b/km²), Vuçak (80.6 b/km²), Godanc (96.5 b/km²), etj.




Grafiku 3. Shtimi natyror në vitin 2017 në komunën e Gllogocit (ne promil)

Shtimi natyror i popullsisë

Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2017 janë vlerësuar duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Agjencia e Statistikës së Kosovës për vitin 2017 për komunën e Gllogocit. Për vitin 2017 është vlerësuar se në komunën e Gllogocit jetojnë 61133 banorë. Gjatë vitit 2017 në komunën e Gllogocit janë shënuar 1009 lindje dhe 249 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në ‰ dhe në përqindje për komunën e Gllogocit.

Siç shihet edhe nga grafiku, shkalla e natalitetit në komunën e Gllogocit është 16.5 ‰, kurse shkalla e mortalitetit është 4.07 ‰. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 12.43 ‰.

**Përmbledhje** - Rritja e numrit te popullsisë ne Komunën e Gllogocit është evidente nga te gjitha regjistrimet e kryera qe nga viti 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe e fundit me vitin 2011. Ne përgjithësi rezulton qe Komuna e Gllogocit ka pas rritje konstante te numrit te popullsisë për 42,354 banorë, nga 16,177 (regjistrimi ne vitin 1948) ne 58,531 (regjistrimi ne vitin 2011). Siç mundet të vërehet nga statistikat për 63 vitet e fundit nga viti 1948 deri në vitin 2011 ka rritje të popullsisë në komunën e Gllogocit për 3.6 herë. Regjistrimet zyrtare të popullsisë të viteve 1971,1981,1991 dhe 2011 si dhe vlerësimet nga viti 2012 deri 2018 janë përdorur për të vlerësuar rritjen e popullsisë në komunën e Gllogocit si dhe për kalkulimin e popullsisë së përafërt për vitin 2028. Duke marrë parasysh elementet bazë të zhvillimit demografik në komunën e Gllogocit, janë dhënë edhe rezultatet e parashikimit demografik. Këto rezultate japin vlera për rritjen e popullsisë dhe parashikimin demografik për të ardhmen, deri në vitin 2028. Gjatë vlerësimit të popullsisë për komunën e Gllogocit në vitin 2028 është marrë për bazë komponenti themelor që ndikon drejtpërdrejtë në

DRAFT

rritjen demografike siç është shtimi natyror. Ndërsa, ne mungesë të informatave zyrtare për migrimet – këto të fundit nuk janë pjese përbërëse te kalkulimeve.vSipas të dhënave të vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për periudhën 2011 deri 2017 del se në komunën e Gllogocit për çdo vite kemi shtim natyrore të popullsisë prej 888 banorë (1.517%) në vit. Si rezultat përllogaritja e rritjes se popullsisë për vitin 2028, popullata e komunës së Gllogocit do të jetë rreth **75,606 banorë**.




Harta 7. Dendësia e popullsisë sipas rrjetit/Grid-it për km², në komunën e Gllogocit



Harta 8. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

**VLERËSIMI I GJENDJES**

| | *POZITIVE* | *NEGATIVE* |
|---|---|---|
| *TË BRENDSH* | ▪ Shtimi natyror pozitiv<br>▪ Popullsia me moshë ekonomikisht aktive | ▪ Migrimi i banorëve nga komuna<br>▪ Rënie në trendin/intensitetin e rritjes së popullsisë |
| *TË JASHTME* | ▪ Mbështetja e ekonomive familjare, sidomos familjeve te reja<br>▪ Zvogëlimi gradual i madhësisë se familjes | ▪ Largimi i te rinjve jashtë vendit<br>▪ Migrimi selektiv: migrimi i burrave/djemve jashtë vendit |

**SFIDAT KYQE**

- Menaxhimi i migrimit te banoreve jashtë komunës
- Vazhdimi i trendit te rritjes se popullsisë

**NEVOJAT DHE KËRKESAT PËR TË ARDHMEN**

- Krijimi i kushteve te favorshme për sistemimin adekuat te familjeve te reja
- Integrimi i të rinjve në zhvillimet në komunë

## 2.3. EKONOMIA

Pasojat ekonomike të luftës të fundit kanë qenë të rënda dhe kanë ndikuar në shkatërrimin e shumë ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe pasurinë e qytetarëve. Shumica e ndërmarrjeve ndërprenë aktivitetin e tyre dhe disa prej tyre nuk u riaktivizuan në nivelin e para-luftës. Ndërsa Kompleksi i Ferronikelit, pas luftës iu nënshtrua procesit të privatizimit. Bazuar në të dhënat rreth strukturës së eksportit, Ferronikeli kontribuon me mbi 50% të eksportit të gjithëmbarshëm të Kosovës. Xehet eksportohen në mbarë botën: Itali, Gjermani, Belgjikë, Spanjë, Indi, Kinë dhe Kore[6].

Pas fazës së rindërtimit komuna e Gllogoc gradualisht ka filluar me rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale. Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe krijimi i bizneseve të vogla, priten të luajnë rol thelbësor në rrugën drejt një ekonomie moderne të tregut të lirë dhe si rrjedhim edhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike.

Deri në fund të vitit, të vitit 2018 raportohet se ne Komunën e Gllogocit, janë **2,021**[7], me rreth 90% prej tyre të regjistrauar si mikro-ndërmarrje. NVM-te përbëjne motorrin e zhvillimit ekonomik dhe pritet që do të sigurojnë vende të reja të punës, rritje dhe prosperitet ekonomik nën kushtet e një kornizë të favorshme ligjore dhe institucionale që munëdson treg të lirë dhe konkurrencë të barabartë. Komuna e Gllogocit, ngjashëm më komunat e tjera të Kosovës, ende nuk ka arritur t'i tejkalojë problemet e papunësisë dhe varfërisë.

### 2.3.1.SHKALLA E PAPUNËSISË

Shkalla e lartë e papunësisë, vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të ekonomisë së Kosovës, e cila reflektohet me probleme të shumta në shoqëri. Shkalla e papunësisë në nivel të Kosovës sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2017[8] është 30.5% dhe llogaritet të jetë më e larta në rajon. Në këtë mes, niveli i papunësisë është më i lartë për femrat se sa për meshkujt dhe qëndrojnë në raport 36.6 % krahasuar me 28.7 %. Të gjithë parametrat kryesore ekonomik, janë të publikuar në nivel të Kosovës, dhe nuk ka të dhëna të sakta mbi shkallën e papunësisë ne nivel komunal. Megjithatë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia edhe në nivel të komunës është e lartë.

[6] Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Gllogocit 2015-2019

[7] Administrata Tatimore e Kosovës, 2018

[8] Anketa e Fuqisë Punëtore 2017, ASK

Në anën tjetër faktorët social i kanë ndihmuar kësaj gjendjeje të papunësisë ku niveli i ulët i arsimimit (me theks të veçantë tek femrat), familjet e mëdha në numër dhe popullsia kryesisht agrare.

Tabela 4 Numri i punëkërkueseve të regjistruar në zyrat e punësimit, shtator 2017

| Gjinia | Numri i punëkërkuesve të regjistruar | % |
|---|---|---|
| Meshkuj | 2,061 | 57,4 |
| Femra | 1,527 | 42,5 |
| Gjithsej | 3,588 | |

Bazuar në të dhënat nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, numri kumulativ i punëkërkuesve të regjistruar në Komunën e Gllogocit, në shtator të vitit 2017 ishte 3,588 persona. Megjithatë, ky numër mendohet të jetë më e lartë për faktin se një numër i konsiderueshëm i personave të papunë nuk paraqiten në këtë zyre. Ndërsa bazuar në Raportin Puna dhe Punësimi në Kosovë[9], ky numër në vitin 2018 ishte 3,067.

Kur të analizohet struktura e punëkërkuesve sipas gjinisë, vërehet se papunësia më e lartë është e shprehur tek gjinia mashkullore, me 57,4% të kontingjentit të përgjithshëm të punëkërkuesve.

| Komuna | Papunësia | Vendet e Lira të Punës të Rregullta | Vendet e Lira PATP (Politikave Aktive të Tregut të Punës) | Ndërmjetësime në Punësim të Rregullt | Ndërmjetësime në Punësim PATP |
|---|---|---|---|---|---|
| Gllogoc | 3,067 | 323 | 47 | 55 | 50 |
| **Kosovë** | **95,890** | **10,497** | **4,350** | **3,764** | **3,000** |

### 2.3.2.SHKALLA E PUNËSIMIT

Në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP), për vitin 2017 është 29.8%, apo 357,651 persona. Punësimi me i lartë është te meshkujt (46.6%), ndërsa punësimi te femrat është 12.7%. Femrat janë të punësuara, kryesisht në sektorët e arsimit, kujdesit shëndetësor dhe tregtisë, me 48.4 % të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimtarisë, tregtisë dhe prodhimit, me 45.9%. Ngjashëm sikurse me shkallën e papunësisë, Anketa e Fuqisë Punëtore (2017) nuk ofron informacion mbi nivelin e punësimit në nivel komunal. Sigurimi i shifrave të përafërta të punësimit, në komunë të Gllogocit ngjashëm sikur se edhe në komunat tjera mbetet sfidë. Të dhënat e siguruara nga Komuna e Gllogocit, dëshmojnë që aktualisht në Komunën e Gllogocit janë të punësuar rreth 6,235 persona. Bazuar në regjistrimin në teren të zhvilluar në 2019 nga DZHE, del se numri i të punësuarve në sektorin privat është 2841, duke mos e përfshirë numrin e saktë të të punësuarve në sektorin e ndërtimtarisë, për shkak se një pjesës së bizneseve të tilla nuk i dihet adresa e saktë. Ashtu siç, prezantohet në grafikun në vijim punësimi në këtë komunë ka pasur një trend pozitiv duke u rritur nga viti në vit. Siç mund të vërehet në mes të vitit 2013 dhe 2018 punësimi në këtë komunë është rritur për mbi 20%, nga 5,206 të punësuar në vitin 2013 në 6,235 në vitin 2018. Edhe pse shifra e raportuar e të punësuarve në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë së Gllogocit, vazhdon të jetë ende ulët. Ajo çfarë mund të shihet në tabelën e mëposhtme është se, sektori i "Tregtisë me shumicë dhe pakicë" punëson numrin më të madh të të punësuarve në këtë komunë (30%), pasuar nga sektori i "Xeheroreve dhe Gurethyesit" (15%), ku përfshihet punësimi në NewCo Ferronikel. Ndërsa, sektori i "Transportit dhe magazinimit" përfaqëson sektorin e tretë ekonomik sipas numrit të të punësuarve me 12.0%. Këto të dhëna dëshmojnë për një ndërrim në strukturën e të punësuarve në Komunën e Gllogocit, krahasuar me vitet e 90-ta, nga sektori i prodhimit/ industrisë nxjerrëse në atë të tregtisë. Ajo cfarë bie në sy është që numri i të punësuarve në sektorin e bujqësië vazhdon të jetë ende i ulët, me vetëm 4%. Poashtu të dhënat e prezentuara nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, tregojnë që struktura e punësimit sipas sektorëve nuk ka pësuar ndryshime të theksuara në mes të viteve 2013 dhe 2018.

[9] Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social, Agjencia e Punësimit




Grafiku 4 Numri i te punësuarve neper vite, 2011-2018

Ndërsa analizuar në aspekt gjinor, vërehet se ekziston një pabarazi e lartë e punësimit, në favor të gjinisë mashkullore. Rreth 84 % e të punësuarve i takojnë gjinisë mashkullore ndërsa vetëm 16% asaj femërore[10]. Nga regjistrimi i bizneseve i zhvilluar në teren në verën e vitit 2019 nga DZHE, vërehet së kjo pabarazi ka filluar të zvogëlohet, ku del se rreth 7% e të punësuarve janë burra, kurse 28% e tyre janë gra. Ky numër i grave ka mundësi të jetë pak më e vogël, kur merret parasysh që gjatë regjistrimit nuk ka mundur të përfshihet numri i saktë i të punësuarve në sektorin e ndërtimtarisë (ku dominon gjinia mashkullore), sepse se një pjesës së bizneseve të tilla nuk i dihet adresa e saktë.

### 2.3.3.NIVELI I VARFËRISË

Një prej parametrave thelbësor për mirëqenien e një vendi është shkalla e punësimit. Niveli i lartë i papunësisë në vend është një prej katalizatorëve kryesor të zgjerimit të varfërisë në vend. Duke u bazuar në të dhënat e Mirëqenies Sociale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2017 në komunën e Gllogocit, janë gjithsej 1,223 ekonomi familjare të përfshira në programin për asistencë sociale, apo gjithsej 5,459 persona. Kjo, shifër paraqet rreth 9% të gjithë popullësisë së vlerësuar në Gllogoc (Gllogoc) (59, 752[11]). Gjatë vitit 2018, sipas të njëjtit burim, ka pasur mesatarisht 1,189 ekonomi familjare të përfshira në skemën për ndihmë sociale. Në të njëjtën kohë, bazuar në gjendjen e muajit dhjetor 2017, Komuna e Gllogocit, paraqet komunën me numrin më të madh të përfituesve nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës. Numri i përfituesve në këtë komunë ishte 1,245 apo 9.9 % e numrit të përgjithshëm të përfituesve në nivel të Kosovë.

Sipas të të dhënave nga regjistrimi i vitit 2011, vetëm 12% e banorëve mbështeten në të hyrat nga punësimi, që është për 10.4% nën nivelin e Kosovës. Të ardhurat nga skema e pensioneve dhe mirëqenies sociale janë gjithë shumë të ulëta - 4.9% e banorëve mbështeten në të hyrat nga pensionet bazë (2016), e 9% në ndihma sociale (2017). Shikuar përgjithësisht, niveli i varfërisë në komunë mbetet i lartë.

### 2.3.4.AMBIENTI I BIZNESIT

Në vitet e fundit qeverisja lokale në Gllogoc ka zbatuar një sërë masash reformuese me qëllim të përmirësimit të ambientit të biznesit në komunë. Si rrjedhojë e këtyre reformave, tani NMV-të regjistrohen përmes Qendres Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Politikat zhvillimore lokale në komunën e Gllogocit kanë luajtur rol thelbësor në përmirësimin e ambientitt të të bërit biznes. Bashkëpunimi i pushtetit lokal me bizneset e vogla dhe të mesme vlerësohet si çelës i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal, e në këtë segment Komuna e Gllogocit ka bërë disa përmirësime në aspektin ligjor dhe administrativ. Një prej zhvillimeve të rëndësishme në drejtim të krijimit të ambientit të përshtatshëm për biznes ishte vendimi për themelimin e Parkut të Biznesit. Nga viti 2012 deri në vitin 2014 Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Komunën e Gllogocit ka vazhduar me investimet e veta për të ofruar kushte më të mira për të bërë biznes brenda Parkut të Biznesi. Sot ky park është funksional, dhe vetëm në këtë Park janë të vendosura 43 biznese, që operojnë ne sektorin e prodhimit dhe shërbimeve. Çdo ngastër ka qasje direkte në rrugët kryesore të Parkut si dhe ka kyçjen individuale në rrjetin kryesor të parkut me kanalizim, ujë, telefoni, internet, etj. Poashtu, Komuna ka hartuar dhe plotësuar një mori rregulloresh, që ndërlidhen me mjedisin

DRAFT

[10] Regjistrimi i Popullësisë nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, 2011

[11] Regjistrimi I Popullësisë 2011, ASK

afarist- si uljen dhe heqjen e taksës komunale, lehtësira për të hapur biznese të reja dhe disa hapa të tjerë të politikave biznesore mbrenda kompetencave të saja, në interes të Komunitetit të Biznesit.
Në rregullorën komunale për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa, të aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit janë liruar nga taksa komunale këto veprimtari[12]:

- Të gjitha bizneset e vogla të kësaj katgorie si: DPT, DPSH, DPZ, DPH etj;
- Zejet e vjetra - artizanatet
- Të gjitha biznesët e lëmisë së Bujqësisë
- Për një vit të gjitha biznesët e regjistruara në vitin e parë të afarizmit;
- Për 3 vite të gjitha biznesët fillestare prodhuese

Bazuar në shënimet e siguruara nga Administrata Tatimore e Kosovës gjatë vitit 2018, në Komunën e Gllogocit kanë qenë rreth 2,056 tatimpagues aktiv, përfshirë këtu edhe OJQ-te, organizatat buxhetore dhe ndermarrjet në pronësi publike dhe shoqërore. Ndersa numri i ndërmarrjeve aktive në pronësi private, gjatë vitit 2018 ishte rreth 2021. Nga këto kompani, pjesa dërmuese e tyre rreth 84% janë biznese individuale/persona fizik. Ndërsa rreth 15% të bizneseve janë të regjistruara si shoqëri me përgjëgjësi të kufizuara. Pjesëmarrja e formave tjera të bizneseve te regjistruara është e ulët.

| Nr. | Lloji i pronësisë | Numri i ndermarrjeve | % |
|---|---|---|---|
| 1 | Biznes individual | 1,693 | 84% |
| 4 | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) | 295 | 15% |
| 2 | Ortakëri e përgjithshme dhe e kufizuar | 5 | 0% |
| 5 | Kompani e huaj | 8 | 0% |
| 6 | Te tjera | 19 | 1% |
|  | Gjithsej | 2,021 |  |

Tabela 5 Numri i ndërmarrjeve sipas llojit të pronësisë, në % (Burimi: ATK, 2018)

Ndërsa në bazë te regjistrimit në teren të bërë në vitin 2019 nga ana e zyrtarve të DZHE, del se janë 950 biznese aktive të cilave iu dihet adresa e saktë. Ky numër mund të jetë paksa më i madh, duke qenë se nuk dihet numri i biznese aktive që merren me ndërtimtari sepse nuk i dihet adresa dhe rrjedhimisht nuk kanë mundur të regjistrohen. Analizuar në aspekt të sektorëve ekonomik, shihet se numri më i madh i ndërmarrjeve, rreth 38% të tyre janë të regjistruara në sektorin e “Tregtisë dhe shumicë dhe pakicë”, pasuar nga sektori i “Ndërtimtarisë” (15%) dhe “Transporti dhe magazinimi” (13%). Kjo strukturë e ndërmarrjeve vërehet se nuk ka ndryshuar shumë ndër vite, dhe është e ngjajshme me strukturen e regjistrimit të ndërmarrjve në nivel të Kosovës. Ngjajshëm sikur në analizën e punësimit, ajo cfarë bie në sy është fakti që përfaqësimi i bizneseve në sektorin e “Bujqësisë, Pylltarisë dhe Peshkimi”, gjatë vitit 2018, ka qënë në nivel të ulët si për nga numri i kompanive që kanë po ashtu edhe për nga numri i punëtorëve (Tabela numër 4 ne Aneks). Përderisa në të kaluarën, bartëse kryesore e zhvillimit të ekonomisë në Gllogocka qenë Industria përfshire sektorin e xeheroreve, me një pjesëmarrje relativisht të lartë të të punësuarëve në këtë sektor. Sot në sektorin e industrisë përpunuese se bashku me xeherore aktualisht janë të regjistruara rreth 300 ndërmarrje ose 7% e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara. Në këto dy sektore janë të punësuar mbi 20% të të punësuarve në këtë komunë. Feronikeli luan një rol të rëndësishëm, duke punësuar numrin më të madh të qytetarëve të kësaj komune në këtë sektor. Ndërsa që Sektori i Tregtisë, prinë për nga numri i të punësuarëve me 30% e të punësuarëve në sektorin privat.

[12] Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Gllogocit 2015-2019

| Seksioni- Titulli | Ndermarrje (%) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2011 | 2012 | 2013 | 2018 |
| A- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi | 4% | 6% | 6% | 5% |
| B- Xeheroret dhe gurëthyesit | 0% | 0% | 0% | 0% |
| C- Industria përpunuese | 6% | 8% | 9% | 7% |
| D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim | 0% | 0% | 0% | 0% |
| E- Furnizimi me uje; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet | 0% | 0% | 0% | 0% |
| F- Ndërtimitaria | 13% | 14% | 14% | 15% |
| G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe | 41% | 36% | 36% | 38% |
| H- Transporti dhe magazinimi | 11% | 11% | 11% | 13% |
| I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit | 7% | 7% | 6% | 6% |
| J- Informimi dhe komunikimi | 2% | 2% | 2% | 2% |
| K- Aktivitetet financiare dhe te sigurimit | 0% | 0% | 0% | 0% |
| L- Aktivitetet e patundshmërive | 0% | 0% | 0% | 0% |
| M- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike | 0% | 0% | 0% | 0% |
| N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse | 1% | 1% | 1% | 1% |
| O- Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ | 0% | 0% | 0% | 0% |
| P- Arsimi | 1% | 1% | 1% | 1% |
| Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale | 1% | 1% | 1% | 1% |
| R- Arte, argëtimi dhe rekreimi | 2% | 2% | 2% | 1% |
| S- Aktivitetet tjera shërbyese | 10% | 10% | 10% | 10% |
| T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallera te | 0% | 0% | 0% | 0% |
| U- Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja | 0% | 0% | 0% | 0% |
| Gjithsej | 100% | 100% | 100% | 100% |

Tabela 6 Ndermarrjet ekonomike, sipas sektoreve ekonomik, 2011- 2018

**Bujqësia, pemtaria dhe blegtoria -** Bazuar në analizat hipsometrike të territorit të komunës, dy të tretat e territorit të komunës janë pjesë rrafshinore. Pjesa e rrafshët e komunës e sidomos lugina përgjatë lumit "Drenica" është tokë me potenciale të mundshme për zhvillimin e bujqësisë intensive dhe zhvillim të agro-industrisë. Lumi "Drenica", kanali i sistemit ujitës Ibër-Lepenc si dhe lumi Verbofc janë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë. Klima kontinentale me të reshura mesatare krijojnë kushte shumë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë.

**Vlerësimi i tokës bujqësore -** Toka në komunën e Gllogocit dallon nga ajo e punueshme deri të pyjet. Bazuar në të dhënat që posedon Komuna, gjatë vitit 2017 kjo komunë ka pasur rreth 14,389.00 ha tokë bujqësore, përkatësisht 52.21% të territorit të komunës dhe 9,885.40 ha tokë pyjore. Nga sipërfaqja e tokës bujqësore (ara dhe kullosa), toka bujqësore e kultivuar përfshinë 8182 ha, përkatësisht 0.13 ha për kokë banori, bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë, i zhvilluar nga Agjencia i Statistikave te Kosovës (2014). Nga mënyra e shfrytëzimit me të mbjella mund të thuhet së drithërat kultivohen në sipërfaqe më të madhe, prej rreth 75% të totalit të tokës së punueshme. Sipërfaqet me peme dhe perime përfshijnë 159 ha, ose 0.6% të territorit të komunës. (perime 47 ha, pemë 112 ha).

| | Sip ha | % |
|---|---|---|
| Klasa 2 | 9007 | 32.7 |
| Klasa 3 | 1876 | 6.8 |
| Klasa 4 | 6002 | 21.8 |
| Klasa 5 | 1635 | 5.9 |
| Klasa 6 | 8169 | 29.6 |
| Klasa 7 | 874 | 3.2 |
| Total: | 27563 | 100.0 |

**Boniteti -** Sa i përket cilësisë së tokës, përkatësisht përshtatshmerisë, Gllogoci karakterizohet me tokë cilësore me rreth 61.2 %, që është tokë e cilësisë së mirë e kategorisë I-IV, që përfshinë kryesisht pjesët qendrore dhe veriore të komunës. Pjesa tjetër e territorit, 38.7 %, është tokë e cilësisë më të ulët me kategori V-VIII, që përfshinë kryesisht pjesët perendimore dhe jugore të komunës. Ne komunën e Gllogocit dominon sipërfaqja e tokës me kategorinë nr. 2, 6 dhe 4. Në tabelë janë të paraqitura sipërfaqet dhe përqindjen.

DRAFT




Harta 9. Shpërndarja e bizneseve sipas vendbanimeve




Harta 10. Shpërndarja e tokave bujqësore




Harta 11. Kategoritë e tokave bujqësore

**Lavërtaria -** Ndër kulturat bujqësore me dominuese në Komunën e Gllogocit janë kulturat tradicionale gruri dhe misri, produkte këto me të cilat arrihen rendimente të larta. Grafiku në vijim, dëshmon që prodhimtaria në secilën prej kulturave të drithërave ka shënuar ngritje. Në përgjithësi, prodhimi drithërave në Komunën e Gllogocit, ndjeke mesataren e prodhimit të drithërave në nivel të Kosovës.

| | **Siperfaqe në Ha** | **Pjesëmarrja në %** |
|---|---|---|
| Perimet - Gjithsej | 45 | |
| Speca | 14 | 31% |
| Domate | 8 | 16% |
| Tranguj | 3 | 7% |
| Qepë | 7 | 15% |
| Hudhër | 1 | 3% |
| Lakër | 5 | 11% |
| Spinaq | 1 | 2% |
| Presh | 0 | 0% |
| Karrotë | 0 | 1% |
| Kungull misiri (vidim) | 0 | 1% |
| Shalqi | 1 | 1% |
| Pjepër | 1 | 2% |
| Dredhëz | 3 | 7% |
| Perimet e tjera | 1 | 3% |

Tabela 7 Prodhimtaria e Perimeve, në sipërfaqe (ha)[13]

Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, janë më pak se 50ha, që mbillen me perime në Komunën e Gllogocit. E që në përgjithësi paraqet një sipërfaqe të kufizuar të mbjelljes me perime. Kulturat më të shpeshta të perimeve janë, speci, domatja, trangujt dhe qepet. Këto katër lloje përfshijnë rreth 70% të sipërfaqeve të mbjellura me perime. Grafiku në vijim, dëshmon që prodhimtaria në secilën prej kulturave të perimeve ka shënuar ngritje.

Në total, është shënuar rritje prej mbi 33% në rendimentin e pesë kulturave kryesore të perimeve (t/ha) në vitin 2018 krahasuar me vitin 2013.

Shprehur në vlerë prodhimtaria e perimeve në këto pese kultura (spec, domate , trangull, patate dhe lakër) është rritur nga 78 t/ha në vitin 2013 në 104 t/ha në vitin 2018. Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së produktivitetit të punës së fermerëve dhe avancim të teknikave prodhuese.




Grafiku 5 Prodhimi i dritherave, t/ha




Grafiku 6 Prodhimi i perimeve, t/ha[14]

[13] Regjistrimi i Bujqesise, 2014 ASK

[14] Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, Komuna e Gllogocit, 2018

| | Siperfaqja (ha) | Nr. i trupave te pemve ne plantacion |
|---|---|---|
| Plantacionet e pemëve - Gjithsej | 106 | 155,227 |
| Mollë | 83 | 93243 |
| Dardhë | 4 | 4601 |
| Ftua | 1 | 899 |
| Mushmollë | 0 | 274 |
| Kumbull | 16 | 11610 |
| Qershi | 0 | 111 |
| Vishnje | 0 | 114 |
| Pjeshkë | 1 | 563 |
| Kajsi | 0 | 238 |
| Arrë | 0 | 74 |
| Lajthi | 1 | 269 |

**Pemtaria** - Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, janë rreth 112 ha apo rreth 155,227 trupa të pemëve, që mbillen me pemë në Komunën e Gllogoci. Rreth 75% e kësaj sipërfaqe është e mbjellë me Mollë, që paraqet llojin më të shpeshtë të kultivuar. Ngjashëm me rastin e drithërave dhe perimeve, trend pozitiv vërehet edhe në rritjen e prodhimtarisë së pemëve nga viti në vit. Në total, është shënuar rritje prej afër 40% në rendimentin e pesë kulturave kryesore të pemëve ( t/ha) në vitin 2018 krahasuar me vitin 2013. Shprehur në vlerë prodhimtaria e pemëve në këto pese kultura ( Molla, dardha , kumbull, arra dhe dredhëza) është rritur nga 65t/ha në vitin 2013 në 90 t/ha në vitin 2018.

Tabela 8 Prodhimtaria e Pemëve, në sipërfaqe (ha) dhe nr. të trupave[15]




Grafiku 7 Prodhimi i pemëve, t/ha[16]

**Blegtoria -** Kualiteti i tokës, kushtet klimatike, burimet me ujë dhe struktura e popullsisë paraqesin potencial për zhvillimin blegtorisë. Gjedhet, delet dhe dhitë- prodhimi i mishit dhe bylmetit, paraqesin një prej prioriteteve të zhvillimit agro-ekonomik të komunës së Gllogocit. Zhvillimi i kësaj veprimtarie primare do të mundësoj edhe zhvillimin ekonomik të vendbanimeve të kësaj ane, por njëkohësisht do të mundësoj edhe zhvillimin e bizneseve në zonën aktive zhvillimore për shkak të posedimit të kushteve më të përshtatshme infrastrukturore. Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, Gllogoci posedon rreth 6,692 ha me livadhe dhe kullota. Kjo sipërfaqe, paraqet potencial të kënaqshëm të kësaj komune për zhvillimin e blegtorisë. Tabela më poshtë është prezanton fondin blegtoral në Komunën e Gllogocit, bazuar në regjistrimin e bujqësisë në vitin 2014.

Me qëllim të eliminimit të karakterit stinor të prodhimtarisë, duhet të punohet në drejtim të rritjes së sipërfaqeve të mbjella me perime dhe të ngritën sera për kultivimin e perimeve në të cilat mundë të arrihen dy deri tri vjelje apo kultura brenda vitit.

[15] Regjistrimi I Bujqesise, 2014 ASK

[16] Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, Komuna e Gllogocit, 2018

| | Numri |
|---|---|
| Gjedhe gjithsej | 12,062 |
| Buallica | 9 |
| Dele | 5,787 |
| Dhi | 1,807 |
| Derra | - |
| Kuaj, gomare dhe mushka | 10 |
| Shpeze | 110304 |
| Kafshë të tjera | 197 |
| Koshere bletësh | **3594** |

Tabela 9 Fondi Blegtoral, Komuna e Gllogocit 2014[17]

Një prej objektivave strategjike të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik[18], në fushën e zhvillimit të perimtarisë mbetet, zhvillimi i agro- biznesit, përmes ngritjës së mini serave për skultivimi e perimeve/zhvillimin e perimtarisë; ngritja e serave për kultivimin pemëve/pemtarisë; ngritja e depove për grumbullimin, klasifikimin dhe ruajtjen e pemëve të imta dhe bimëve mjekësore e aromatike. Krahas, faktorëve tjerë që ka ndikuar pozitivisht në rritjen e produktivitetit, si dhe zgjerimin e sipërfaqeve punuese është edhe përkrahja e ofruar për fermer nga ana e autoriteteve lokale dhe bashkëpunimi me donatorë.

Në këtë drejtim, Drejtoria për Bujqësi, brenda kompetencave të veta, për mbështetje të fermerëve për krijim të kushteve për rritje të kapaciteteve prodhuese, modernizim të bujqësisë, ngritjen e serrave, mbështetje të iniciativave të fermerëve në ngritjen e cilësisë së prodhimeve bujqësore, vetëm gjatë 3 viteve të kaluara ka ofruar subvencione në vlerë prej mbi 118,000 EU dhe në total kanë përfituar mbi 400 përfitues. Subvencionimi i shumë sektorëve të bujqësisë nga Komuna dhe MBZHR, është treguar një impuls mjaft i mirë dhe ka ndikuar që interesimi i fermerëve për t'u marrë më bujqësi të jetë në rritje të vazhdueshme.

**Turizmi: Hapësirat për akomodim dhe shërbim të ushqimit -** Komuna e Gllogocit nuk posedon ndonjë ofertë të larmishme të llojeve të akomodimit për vizitorë. Në total janë 3 hotele ku 2 nga ato posedojnë dhoma për akomodim me një numër të caktuar të shtretërve. Këto hotelet kanë restorante, sallë për aheng dhe argëtim, sallë për konferenca dhe hapësira tjera për socializim. Ky fakt na bën të kuptojmë që aspekti i kapacitetit akomodues nuk është i mjaftueshëm dhe komuna e Gllogocit duhet të investojë në këtë drejtim. Ofrimi i akomodimit mund të bëhet në tipin shtëpi pritëse që mund të përfshijë edhe shërbimin e ushqimit. Akomodim i tillë mund të bëhet edhe në objekte me vlera të trashëgimisë kulturore (elaboruar në kapitullin e Trashëgimisë Kulturore).

Sa i përket ofrimit të ushqimit në Komunën e Gllogocit janë 34 restorante dhe 6 tjera në kuadër të pompave të benzinës. Shërbimi i ushqimit është cilësor dhe ofrohen lloje të ndryshme duke filluar nga ushqimi tradicional deri tek ai i shpejtë. Kapaciteti i restoranteve është i ndryshëm dhe mund të sillet prej 20 deri në 500 vetë tek sallat për argëtim.

Ofertës akomoduese ende i mungojnë hapësirat për kampim, që kryesisht mund të bëhen në afërsi të Liqenit të Vasilevës. Ajo çfarë synohet është ngritja e standardeve të akomodimit, për të përmbushur pritjet e vizitorëve dhe krijimin e vlerës së shtuar.

DRAFT

[17] Regjistrimi i Bujqësisë, 2014 ASK
[18] Strategjia për Zhvillim Lokal 2015 -2019

**VLERESIMI I GJENDJES:**

| | *POZITIVE* | *NEGATIVE* |
|---|---|---|
| *TË BRENDSHME* | ***Përparësitë***<br>▪ Pozita gjeografike qendrore si dhe infrastruktura adekuate e transportit (autostrada, hekurudha)<br>▪ Resurset minerare (xehet, guroret)<br>▪ Parku industrial (100% funksion)<br>▪ Zona ekonomike (64ha)<br>▪ Klima e favorshme për biznes<br>▪ Toka bujqësore (2/3 e sipërfaqes)<br>▪ Sistemi i ujitjes (zyrtarisht4573 ha)<br>▪ Subvencionet ne bujqësi (3 vjet -> 118,000; 400 përfitues)<br>▪ Resurset natyrore për zhvillim te turizmit (liqeni i Vasilevës, Vërbovcit)<br>▪ Fuqia punëtore e re | ***Mangësitë***<br>▪ Papunësia e larte (30%); Meshkuj 47% & Femra 13%?!)<br>▪ Varfëria<br>▪ Menaxhimi jo i mire i resurseve natyrore (xehet, toka, bujqësia 40% e pashfrytëzuar)<br>▪ Koncentrimi i bizneseve vetëm ne zona urbane (Gllogoc, Komoran)<br>▪ Numri i vogël i NVM prodhuese (30% tregti, 12% trans., 4% bujqësi)<br>▪ Blegtoria dhe agro-industria e pazhvilluar<br>▪ Përqendrimi i prodhimit te kulturave bujqësore (gruri, misri,..)<br>▪ Buxheti i vogël i komunës<br>▪ Mungesa e shkathtësive praktike |
| *TË JASHTME* | ***Mundësitë***<br>▪ Krijim i lehtësirave  për NVM<br>▪ Rritja e bashkëpunimit te grupeve te interesit (prodhuesit + përpunuesit + plasimi) dhe krijimi i shoqatave te biznesit si dhe funksionalizimi i atyre ekzistuese<br>▪ Intensifikimi i prodhimit bujqësor<br>▪ Zgjerimi i sistemit te ujitjes<br>▪ Diversifikimi i prodhimtarisë bujqësore (perimet, pemët, arroret,...)<br>▪ Zhvillimi  i blegtorisë<br>▪ Tërheqja e investimeve te huaja<br>▪ Subvencionet<br>▪ Bashkëpunimi me donatorë ne ngritjen e kapaciteteve<br>▪ Trajnimet profesionale | ***Rreziqet***<br>▪ Ndotja e mjedisit (uji, ajri, toka)<br>▪ Humbja e tokës bujqësore (shndërrimi ne toke ndërtimore)<br>▪ Konkurrenca nga jashtë e prodhimeve bujqësore<br>▪ Mungesa e mbrojtjes se prodhimeve vendore nga niveli qendror<br>▪ Kamatat e larta te kredive<br>▪ Hyrja ne fuqi e ligjit për tatimin e tokave bujqësore<br>▪ Mungesa e mjeteve financiare për projekte kapitale<br>▪ Largimi i kuadrove dhe migrimi i popullatës (i brendshëm dhe i jashtëm) |

**SFIDAT KYÇE:**

- Krijimi i kushteve për zbutjen e papunësisë dhe zhdukjen e varfërisë
- Rritja e numrit te NVM prodhuese
- Stimulimi i prodhimit bujqësor dhe të blegtorisë
- Krijimi i kushteve për zhvillimin e agro-industrisë
- Krijimi i kushteve për shfrytëzimin e resurseve minerale

**NEVOJAT DHE KËRKESAT PËR TË ARDHMEN:**

- Mbrojtja dhe konsolidimi i tokës bujqësore
- Zhvillimi dhe konsolidimi i NVM
- Shfrytëzimi i mundësive nga resurset minerale
- Mbështetja e fermerëve në ngritjen e serave dhe kapaciteteve  për ruajtjen e prodhimeve bujqësore
- Diversifikimi i prodhimtarisë dhe sigurimi I tregjeve, lidhja me industritë përpunuese

DRAFT

## 2.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

### 2.4.1.UJËSJELLËSI

Ndërtimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit është realizuar përmes investimeve nga donatorët e ndryshëm, komuna si dhe me kontribut të qytetarëve. Sistemi i ujësjellësit në komunën e Gllogocit menaxhohet nga njësia operative e kompanisë regjionale për ujë dhe kanalizim “Prishtina”.

Vendbanimet me ujësjellës janë gjithsej 12 dhe ato janë: Gllogoc, Shtrubullovë, Gllobar, Tërstenik, Çikatovë e Vjetër, Poklek, Korroticë e Ulët, Komoran, Krajkovë, Çikatovë e Re, Zabel i Epërm dhe Zabel i Ulët. Pjeserisht kane ujësjellës 3 vendbanime: Gllanasellë, Dobroshec dhe Llapushnik. Si dhe plotesishte pa ujësjellës janë 20 vendbanime: Abri e Epërme, Arllat, Baicë, Domanek, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ulët, Godanc, Gradicë, Kishnarekë, Korroticë e Epërme, Likoshan, Negroc, Nekoc, Polluzhë, Sankoc, Shtuticë, Tërdec, Vasilevë, Vërboc dhe Vuçak.

Për nga numri i banorëve ne këto vendbanime, rezulton qe rrjeti i ujësjellës shpërndahet dhe i shërben 26,116 banore (apo 44.6%), pjesërisht kane qasje 6,481 banore (apo 11.1%), ndërsa plotësisht pa ujësjellës janë 25,934 banore (apo 44.3%).

Furnizimi me ujë bëhet nga fabrika për punimin e ujit e cila gjendet në fshatin Çikëtova e Vjetër që është e dizajnuar dhe ndërtuar për të furnizuar me ujë industrial dhe me ujë për pije kompleksin industrial të Feronikelit. Për shkak të mungesës së ujit për pije në këtë rajon, është dashur që nga kjo fabrikë si i vetmi burim i furnizimit me ujë të pijes të furnizohet qyteti i Gllogocit dhe disa fshatra përreth. Për furnizim me ujë të fabrikës shfrytëzohet uji nga liqeni artificial i Ujmanit në pjesën veriore të Kosovës. Uji transportohet me anë të një sistem të gjerë të infrastrukturës ujore:

- Kanali i hapur i Sistemit të i Iber Lepencit me gjatësi prej 35 km (Ujman-Bivolak)
- Kaptazha për marrjen e ujit nga kanali;
- Stacioni i pompimit ne fshatin Bivolak (katër pompa me kapacitet Q=110 l/s,P=315kë)
- Flokulatori te stacioni i pompimit (ku sipas nevojës dozohën kemikalet alumin sulfati ose polielektroliti kur ka turbullira te mëdha);
- Prej stacionit të pompimit me anë të gypit prej çelikut me diametër 600 mm dhe L=17 km transportohet uji deri te rezervuari i ujit të papërpunuar në fabrikë të Gllogocit.

Nga ky sistem mund të prodhohet uji i pijes me kapacitet prej Q=150-180l/s (tani prodhohen 65- 100l/s, sipas kërkesave) dhe shpërndahet me gyp PE-100, DN 300 mm për Gllogocin dhe disa fshatra : Komorani, Tersteniku I, Gllobari, Gllanasella pjeserisht, Pokleku u ri, Pokleku i Vjeter, Shtrubullova, Dobrosheci pjesërisht si dhe disa lagje përreth Gllogocit. Disa fshatra, Krajkova, Llapushniku, Arllati, Kishnareka kanë burime vetanake dhe sasia e ujit që merret nga këto burime nuk dihet.

Problem në vetë paraqesin humbjet e ujit në sistemin distributiv të cilat llogariten të jenë në shkallë mjaftë të lartë, prej 57% deri 60%. Këto janë humbjet nga sasia e ujit të prodhuar. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Faktorët kryesor që ndikojnë në këtë shkallë të lartë vlerësohet të jenë: rrjeti i vjetruar i ujësjellësit, kyçjet ilegale, mos-matja e saktë e ujit etj.

Ndërprerjet mesatare të ujit për 24 orë është deri në 5 orë (5/24 orë) reduktime dhe intervenime për eliminim të defekteve në rrjet. Pasi që uji për furnizim merret nga kanali i hapur, në kohën kur ka të reshura ka dhe turbullira të ujit dhe duhet të ndërpritet uji për shkak të trajtimit. Uji i trajtohet me Flokulim (sulfat alumini) filtrimi, dhe dezinfektimi (klor të gaztë). Uji trajtohet sipas standardeve të cilësisë së ujit të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP).

Kualiteti i ujit të pijshëm të shpërndarë në tërë zonën e shërbimit të Kompanisë së ujësjellësit monitorohet rregullisht nga Instituti IKSHP-ja dhe rezultatet e ujit të furnizuar janë të kënaqshme.

IKSHP vazhdojnë të kontrollojë cilësinë e ujit përmes testimit të mostrave të ujit të nxjerra nga pika të ndryshme të furnizimit nga Kompania. Të gjitha mostrat kimike dhe bakteriologjike janë në përputhje me standardet për ujë të pijes.

Pjesa e popullatës së komunës që nuk kanë qasje në sistemin qendror të furnizimit me ujë, që llogaritet të jetë rreth 27%, furnizohet me ujë të pijshëm nga sisteme e vogla lokale, të cilat nuk menaxhohen nga kompania e ujësjellësit. Këto sisteme shfrytëzojnë burimet natyrore me kapacitet të vogël dhe furnizojnë disa shtëpi ose lagje të fshatit. Këto sisteme të vogla nuk e dezinfektojnë ujin dhe nga të dhënat e IKSHPK pothuajse të gjitha mostrat e mara nga këto sisteme rezultojnë me kontaminim bakteror dhe nuk janë ujëra të sigurta për pije nga aspekti higjienike.
Pjesa e tjetër e popullatës, e cila nuk është e kyçur në ujësjellës qendror ose në ujësjellës lokal, furnizohen me ujë nga bunarët e cektë dhe të pambrojtur (7-8m thellësi dhe shtyllë ujore 2-3m). Këta bunarë/kaptazha të pambrojtur nuk janë të ndërtuar sipas standardeve për bunarin higjenik. Kjo flet se uji në bunarë është sipërfaqësor me mundësi të madhe të ndotjes dhe me keqësimin e cilësisë së ujit për pije. Nga aspekti shëndetësor këta bunar janë faktor rreziku permanent dhe e rëndon situatën epidemiologjike.

### 2.4.2.KANALIZIMI

Sistemi i kanalizimit është i tipit te ndarë. Si në çdo vend në Kosovë edhe në komunën e Gllogocit rol dominues në shpërndarjen e rrjetit të kanalizimit, ka luajtur konfiguracioni i terrenit. Rrjeti është i shpërndarë nëpër pika të caktuara të lagjeve dhe fshatrave. Megjithatë, shumë familje nuk janë kyçur në kanalizim, shkaku i kostos që ka ardhur nga distanca e madhe mes shtëpive, pra nga shpërndarja e shtëpive pa ndonjë rregullim adekuat te planifikuar. Vendbanimet Gllanasellë, Gllobar, Tërsteniku, Verboci, Gradica, Likoshani dhe Shtutica nuk kane rrjet te kanalizimit.
Për vendbanimet me rrjet kanalizimi, të gjithë ujërat e kanalizimit, pa trajtim paraprak, shkarkohen në rrjedhat e Lumit Drenica dhe në këtë mënyrë shkaktojnë ndotje të lumit, tokës dhe sigurisht edhe ujërave nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës dhe për mjedisin në tërësi. Kanalizimi bazuar në të dhënat e anketës, të realizuar gjatë muajit Maj 2011 për qytetin e Gllogocit, me përjashtim të dy familjeve, të gjitha të tjerat janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit publik të qytetit. Nuk ka matje të sakta për këto rrjeta, por përafërsisht janë rreth 25km. Kolektor kryesor qe përcjelle ujerat e kanalizimit fekale është nga betoni. Por i gjithë rrejti i kanalizimit fekal ne pjesën urbane dhe rurale ku menaxhon 'Ujësjellësi' është përafërsisht i ndare ne dy segmente. Për hapësirat rurale nuk ka informacione lidhur me rrjetat e kanalizimeve, sepse nuk menaxhohen nga 'Ujësjellësi-Njësia Operative e Ujësjellësit' në Gllogoc. Grumbullimi bëhet në gropat septike (dy prej tyre), dhe shkarkohet në lum nga gropa septike, pra nuk ka trajtim te mëtutjeshëm.

### 2.4.3.RRJETI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK

Rrjeti i kanalizimit atmosferik është ndërtuar pas atij fekal për arsye se ka qene te organizuar ne drejtim te rrjetit hidrografik qe gjendet ne Komunën e Gllogovcit. Rrjeti i kanalizimit atmosferik është komplet i orientuar në drejtim të Lumit Drenica dhe përroskave tjera siç është ajo e Verbovcit. Gypat janë nga materialet e ndryshme; Beton, Azbest, PVC etj. me dimensione te ndryshme.

### 2.4.4.UJITJA

Komuna e Gllogocit zyrtarisht ka 4,573 ha tokë bujqësore që ujiten nga sistemi i ujitjes Ibër-Lepenc. Sipërfaqja reale e tokës nën ujitje pa sipërfaqen e ndërtesave ilegale (duke mos llogaritur edhe oborret e ndërtesave) është 4553 ha. Gjatësia e tubacioneve nëntokësore të sistemit të ujitjes është 192 km. Gjendja fizike e rrjetit nëntokësor është e mirë, në rreth 4000 ha, rrjeti i tubacioneve është i rehabilituar, pjesa tjetër prej 1,620 ha, pritet të rehabilitohet në të ardhmen. Në këtë pjesë të sistemit të ujitjes gjegjësisht në komunën e Gllogocit nuk ka liqene akumuluese as penda. Ujitja bëhet përmes kanaleve të hapura (sifona dhe kalesa) që ka gjithsejtë 17.2 km. Ka 4 stacione pompike 4 (katër), në Gllobar(Krashticë), Korroticë, Gjurashin, Fushticë, dhe një objekt ndarës në Vasilevë.




Harta 12 Shtrirja e rrjetës se ujësjellësit ne Gllogoc dhe disa fshatra si dhe paraqitja e vendbanimeve të cilat kanë ujësjellës dhe ato qe nuk posedojnë Ujësjellës




Harta 13 Paraqitja e vendbanimeve të cilat kanë rrjetë të kanalizimit dhe ato qe nuk posedojnë rrjetë të kanalizimit.

### 2.4.5.ENERGJETIKA

Furnizimi i Kosovës me energji elektrike bëhet nga dy burime primare: dy termocentralet me ndezje të thëngjillit "Kosova A" dhe "Kosova B" në rajonin e Prishtinës, dhe importeve përgjatë rrjetit 400 kV dhe 220 kV në termocentralin "Kosova B", dhe përgjatë rrjetit 400 kV në NS Peja 3 dhe Ferizaji 2, si dhe përmes NS 220kV Prizreni 2 dhe NS 220 kV Podujeva.

Komuna e Gllogocit furnizohet nga Nënstacionit Gllogoc (NS 35/10kV), i cili mëtutje furnizohet nga Nënstaconi Ferronikel (NS 220/35kV, 2x160 MVA) që është në pronësi private, përmes një LP 35 kV të tipit AlFe 95/15. Sistemi 110 kV shërben si shtyllë kryesore e furnizimit me energji të shtatë distrikteve të Kosovës, përderisa distrikti i Prishtinës (DPR –Prishtina, prej se cilës furnizohet me energji elektrike edhe Komuna Gllogoci) e bene shpërndarjen mëtutje përmes sistemeve 35 kV (gjatësia 75km me shtylla metalike); 10 kV (gjatësia 125km me shtylla betoni dhe druri) si dhe 0.4kV (gjatësia 213km me shtylla druri) duke shpërndarë energjinë në lokalitete dhe duke furnizuar shumicën e konsumatorëve përmes transformatorëve (10/0.4 kV).

Në qershor 2019 është bërë inaugurimi i nënstacionit elektrik në Gllogoc i cili do të shërbejë për të gjitha ekonomitë familjare dhe bizneset e komunës së Gllogocit, duke përfshirë edhe Stadiumin nacional dhe Parkun e Biznesit.

Largpërçuesi i ri 220kV është kyçur në largpërçuesin ekzistues që lidhë SSH Gllogoci me NS Prizreni 2, në fshatin Krajkovë dhe gjatësia e tij është 4 kilometra.

Nënstacioni Gllogoci 220/10 kV/kV është ndërtuar me standardet e tipit GIS (gjenerata më e re e këtyre pajisjeve) me dy transformatorë te fuqisë 2×40 MVA, pra gjithsejtë 80 MVA transformim dhe se për një kohë shumë të gjatë do ta zgjedhë çështjen e furnizimit me energji elektrike të banorëve dhe bizneseve të Gllogocit.Një nga problemet kryesore ne këtë rast është gjendja e rrjetit elektrik. Shumica e objekteve të banimit furnizohen me energji nga kabllot mbitokësore, e të cilat të shumtën e rasteve janë në gjendje të dobët teknike. Rinovimi i këtij sistemi të vjetruar duhet të ketë një prioritet të lartë. Komuna e Gllogocit ka gjithsej 13,000 konsumator, prej tyre banim (amvisërii-shtëpiak) janë 10,500, dhe komercial (biznese) janë 1,673.

### 2.4.6.TELEKOMUNIKACIONI

Në territorin e Komunës së Gllogocit veprojnë tre operatorë: Vala, Telekomunikacioni i Kosovës (TK) dhe IPKO të cilat ofrojnë telefoni fikse, mobile, televizion kabllor dhe internet brenda zonës urbane, si dhe në tere vendbanimet rurale. Ne rastet te shumta, linjat tele-komunikuese përdorin rrjetin ajror të KEDS-it, respektivisht shtyllat e tensionit të ulët, pa ndonjë planifikim paraprak. Megjithatë, gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në komunën e Gllogocit është relativisht e mirë.

Posta e Kosovës (PTK) ofron shërbime postare (mbledhjen, pranimin dhe shpërndarjen e letrave, paketave, të hollave dhe dërgesave të ndryshme) qe mbulojnë tere territorin e komunës. Gjithashtu, operatoret ndërkombëtarë siç janë TNT dhe FEDex operojnë përmes Postes së Kosovës. Duke analizuar te dhënat nga tabela e mëposhtme mbi qasjen mesatare në Internet, kompjuter personal dhe telefon, Komuna e Gllogocit renditet nen mesataren për nivel te Kosovës.

| | Internet | PC | Telefon |
|---|---|---|---|
| Në Kosovë | 57% | 62.50% | 98.50% |
| Në Gllogoc | 46% | 53.40% | 98.90% |

Tabela 10 Qasja e popullsisë ne Internet, PC dhe telefon

### 2.4.7.NGROHJA

Komuna e Gllogocit nuk ka sistem të ngrohjes qendrore. Kryesisht përdoret druri, thëngjilli, peleti ose energjia elektrike për ngrohje.




Harta 14 Rrjeti energjetik dhe telekomunikacionit

### 2.4.8.GRUMBULLIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE

Komuna e Gllogocit është ndër më te avancuarat në këtë fushë. Ka hartuar Plan të menaxhimit te mbeturinave (2015-2020), Orar te grumbullimit të mbeturinave, si dhe Rregullore për menaxhimin e mbeturinave (Nr. 501-1768 të datës 27 dhjetor 2012). Këto plane zbatohen mjaft mirë, që tregon fakti se në komunën e Gllogocit të gjitha vendbanimet (100%) janë të mbuluara me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Kjo mbulueshmëri në nivel të Kosovës deri në fund të vitit 2016 qëndron në 57.8%. Në anën tjetër, sipas Raportit të Performansës së Komunës së Gllogocit, 45.5% e ekonomive kanë qasje në sistemin për grumbullimin e mbeturinave.

| | |
|---|---|
| 1. Ekonomi familjare në komunë | 8681 |
| 2. Ekonomi familjare të përfshira në sistemin e mbeturinave | 6024 |
| 3. Institucione publike në komunë | 62 |
| 4. Institucione publike të përfshira në sistemin e mbeturinave | 29 |
| 5. Ekonomi komerciale dhe industriale në komunë | 2335 |
| 6. Ekonomi komerciale dhe industriale të përfshira në sistemin e mbeturinave | 470 |

Tabela 11 Mbulimi i territorit komunës me shërbime te grumbullimit te mbeturinave

Në qytet mbledhja e mbeturinave bëhet për çdo ditë, në fshatra 1 herë në javë, në ditët e caktuara. Ofrimi i mbledhjes së mbeturinave është shumë i qëndrueshëm, për çka tregon realizimi 99.7% i orarit për mbledhjen e mbeturinave në vit. Grumbullimi bëhet përmes 102 kontejnerëve me vëllim prej 1,1m3, 6 kontejnerë të madhësisë 7 m3, e në fshatra grumbullimi bëhet përmes 6095 shportave prej 120 l dhe 72 shportave të madhësisë prej 240 litrave (2015). Grumbullimi i mbeturinave vazhdon përmes kamionit dhe zbrazja e tij bëhet çdo ditë në deponi të transferit, të cilat më pastaj dërgohen në deponinë rajonale në Mirash. Në ditë grumbullohen dhe zbrazen 30 tonë mbeturina. Sasia e deponimit të mbeturinave për kokë banori në vit është 105.7kg.

Deponia e transferit ndodhet pranë minierës së Feronikelit në Gllogoc. Arkëtimi është 87%, në nivel të Kosovës vlerësohet se është rreth 60%. Se fundmi, ka filluar edhe procesi i ndarjes së mbeturinave në burim, ku janë caktuar 16 pika të grumbullimit të mbeturinave në qytet me kontejnerë 1.1 m3 për banime kolektive dhe institucionet publike me shporta 240 litërshe , në të cilat janë të vendosur 2 lloje të kontejnerëve, për të përziera dhe mbeturina të riciklimit.

Përkundër mbulueshmërisë shumë të mirë me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, në territorin e komunës ka deponi të ndryshme ilegale që janë krijuar me kohë.

Mbeturinat e veçanta - Problemet kryesore nuk kanë të bëjnë vetëm me mbeturinat e amvisërisë. Nuk ka sistem për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave të veçanta (sipas Ligjit për Mbeturinat), siç janë: vajrat e përdorura, bateritë, akumulatorët, gomat, pajisjet elektrike, automjetet, mbeturinat bujqësore (mbeturinat e bimëve dhe kafshëve, përfshirë nënproduktet e kafshëve) mbeturinat mjekësore, barnat me afat të skaduar, pesticidet dhe produktet e ngjashme të vjetruara. Pikat karakteristike të mbeturinave të veçanta janë:

- Në Korroticë të Epërme është ndërtuar fabrika për përpunimin e mbetjeve shtazore, por ende nuk është në funksion. Është planifikuar të caktohen lokacionet e kontejnerëve për hedhjen e materialit nga thertoret. Nuk ka informata për sasitë e mbeturinave shtazore që prodhohen në këtë komunë e as për mënyrën se si ato trajtohen, përveç që përzihen me mbeturinat e amvisërisë. Aktualisht për mbeturinat e tilla përdoret tarifa prej 90€ për ton, e cila është e shtrenjtë edhe për komunitetin, edhe për kompanitë.
- Incineratori per mbetje medicinale nuk funksionon, një kompani e angazhuar nga MSH vjen kohë pas kohe dhe i mbledhë.

Kompleksi industrial i ”Ferronikelit” në Gllogoc. Mbeturinat e minierave të kontaminuara me metale të rënda i rrezikojnë burimet e ujit, e përmes ujit edhe tokën. Gjithashtu mbetjet industriale ndotin edhe ajrin.



Figura 1. Pamje dhe ortofoto të deponive ilegale në qytetin e Gllogocit[19]

Organizimi - Në komunën e Gllogocit, si rëndom në komunat e Kosovës, përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave është Drejtoria e shërbimeve publike, planifikimit emergjent dhe shpëtim. Megjithatë, është një zyrtar që merret me menaxhimin e mbeturinave. Në Gllogoc, mbeturinat mblidhen nga kompania rajonale e mbledhjes së mbeturinave “Pastrimi”, e cila selinë e ka në Prishtine.



Figura 2. Pamja nga ajri e deponisë së rajonit të Prishtinës (Google maps, 2017)

Deponia rajonale në Mirash drejtohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-ja), kompani kjo e ndarë nga “Pastrimi” që është pronë e qeverisë.
Viti i ndërtimit: 2004-2006 (financuar nga KE)
Ka filluar të operojë: 2006
Jetëgjatësia e planifikuar: 15 vjet (mbyllet në vitin 2020)
Jetëgjatësia sipas KMDK-së: deri në vitin 2026
Madhësia: 40 ha

DRAFT

[19] Burimi: Plani i menaxhimit të mbeturinave), të cilat janë në proces të vazhdueshëm të eliminimit

**VLERËSIMI I GJENDJES:**

| | *POZITIVE* | *NEGATIVE* |
|---|---|---|
| *TË BRENDSHME* | <u>*Përparësitë*</u><br>Ujësjellës<br>▪ Sasia e mjaftueshme e ujit ne burim<br>▪ Kapacitetet e mjaftueshme ne stacionin e pompimit dhe përpunimit te ujit<br>▪ Ështëndërruar rrjeti i vjetër ne gypa standard<br>▪ Investime te reja ne rrjetin e ujësjellësit ne 14 fshatra<br>*Ujitja*<br>▪ Përfshirja e komunës ne sistem te ujitjes, përafërsisht 43%<br>*Energjia*<br>▪ Modernizimi i rrjetit te furnizimit me sistem kabllor nëntokësor<br>▪ Ndriçimi publik me trupa ndriçues me led llamba<br>▪ Ndërtimi i nënstacionit te ri 2 x 40 MVA (LP 220kV)<br>▪ Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit<br>*Telekomunikacioni*<br>▪ Gjendja relativisht e mirë e infrastrukturës së telekomunikacionit<br>▪ Ofrimi i shërbimeve postare nga Posta e Kosovës (PTK)<br>*Mbeturinat*<br>▪ Shtrirja e sistemit te menaxhimit te mbeturinave ne tere territorin e komunës<br>▪ Ndarja ne burim (riciklim)<br>▪ Deponua e transferit ne Gllogoc (Qikatove e vjetër)<br>▪ Ndërtimi i pikave grumbulluese ne qendër te qytetit<br>▪ Plani për Menaxhim te mbeturinave<br>▪ Rregullore komunale për mbeturina<br>▪ Shërbimecilësore nga kompania publike (për ato qe kryhen)<br>▪ Ndërtimi i depo nisëpër mbeturina inerte | <u>*Mangësitë*</u><br>Ujësjellës<br>▪ Mungesa e rrjetit te ujësjellësit ne 24% te vendbanimeve<br>▪ Distanca e madhe e burimit te furnizimit nga impianti për trajtim<br>▪ Teknologjia e vjetër e sistemit te pompimit<br>▪ Teknologjia e shtrenjta e furnizimit<br>▪ Mungesa e ballansit ne çmimin e furnizimit me atë te inkasimit dhe faturimit<br>▪ Reduktimet e ujit gjate natës<br>▪ Mungesa e burimeve ujore ne territorin e komunës<br>▪ Mungesa e bartjes te rrjetave ne menaxhim te kompanisë se ujësjellësit<br>*Ujitja*<br>▪ Mungesa e investimeve ne rehabilitim te rrjetit ekzistues te ujitjes<br>▪ Mirëmbajtja jo e duhur e kanalit te hapur te ujitjes<br>▪ Siguria e pamjaftueshme te stacioneve te pompimit dhe kanaleve te hapura<br>▪ Pamundësia e përfshirjes se tere territorit nen ujitje për shkak te konfiguracionit te terrenit<br>*Energjia*<br>▪ Mosshfrytëzimi i kapaciteteve te burimeve te ripertritshme (alternative)<br>▪ Rrjeti i vjetruar i furnizimit ne vendbanime me energji elektrike<br>▪ Mungesa e ndarëseve te tensionit ne kryqëzimet e linjave qe furnizojnë fshatrat<br>▪ Mungesa e ndriçimit publik në terë territorin<br>▪ Mungesa e energjisë elektrike të mjaftueshme<br>*Telekomunikacioni*<br>▪ Mosshtrirja e rrejtit te telefonis fikse ne te gjitha venbanimet<br>▪ Mungesa e inqizimit te katastrit nentoksor te sistemit kabllor optik te TK, ne Gllogoc,<br>▪ Mungesa e objekteve postare ne bashkesit lokale<br>*Mbeturinat*<br>▪ Përfshirja e te gjitha ekonomive familjare ne sitëm te M.M<br>▪ Deponite ilegale<br>▪ Mos-inkasimi i shërbimit te M.M nga ekonomitë familjare me asistence sociale<br>▪ Vështirësimi i grumbullimit nga infrastruktura joadekuate rrugore<br>▪ Mungesa e automjeteve për bartje te mbeturinave & vjetërsia e atyre ekzistuese |

DRAFT

| | Mundësitë | Rreziqet |
|---|---|---|
| TË JASHTME | *<u>Mundësitë</u>*<br>Ujësjellës<br>▪ Shfrytëzimi i financimit te donatoreve për shfrytëzimin e burimeve akumuluese<br>Ujitja<br>▪ Zgjerimi i rrjetit te ujitjes<br>Energjia<br>▪ Zëvendësimi i trafo stacioneve nga ato (10/0.4 kV) ne ato (20/o.4 kV)<br>▪ Shfrytëzimi i burimeve alternative (paneleve solare dhe erës) ne gryken e Llapushnikut dhe Arllat dhe ne Bjeshkët e Qyqavices<br>▪ Kogjenerimi - Shfrytëzimi i ujit te ngrohte te Feronikelit për ngrohje qendrore<br>*Telekomunikacioni*<br>▪ Investimet nga Telekomi i Kosoves, lidhur me shtrirjen e rrjetit optik ,mundësisht në ëe gjitha bashkësitë lokale,<br>▪ Vendosja e Antenave difuzive te operatorëve te VALA dhe IPKO, ne disa zona qe kanë mungesë te shtrirjes se valëve,<br>▪ Mundësia e ndërtimit te objekteve postare ne Bashkësi lokale<br>Mbeturinat<br>▪ Ngritje e kapaciteteve humane & teknike te njësisë se kompanisë publike ne Gllogoc | *<u>Rreziqet</u>*<br>Ujësjellës<br>▪ Ndërprerja me furnizim nga burimi aktual për shkak te ndryshimeve<br>Ujitja<br>▪ Mungesa e ujit ne burim<br>▪ Dëmtimi i kanaleve, nënstacioneve dhe pusetave kryesore<br>Energjia<br>▪ Rrjeti i vjetërsuar i energjisë elektrike (fatal)<br>*Telekomunikacioni*<br>▪ Mos funksionimi i rrjetit te telefonisë fikse, ne te gjitha vendbanimet,<br>▪ Dëmtimet e rrjeteve kabllore optike gjatë punimeve, si mungesë e incizimit kadastral nëntokësor,<br>▪ Mungesa e kryerjes se shërbimeve postare neper bashkësi lokale<br>Mbeturinat<br>▪ Amortizimi i pajisjeve motorike<br>▪ Mungesa e fondit për mirëmbajtjes e makinerisë |

**SFIDAT KYÇE:**

| | |
|---|---|
| <u>Ujësjellës</u> | Mbulimi i 100% të vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit<br>Ofrimi i shërbimit të ujësjellësit 24 orë gjatë ditës, pa reduktime<br>Trajtimi i ujërave të zeza dhe kanalizimit atmosferik në tërë territorin e komunës |
| <u>Ujitja</u> | Hulumtimi mundësive për shfrytëzimin e ujit te shiut për ujitje<br>Përmirësimi i menaxhimit të ujësjellësit, duke përfshirë futjen e menaxhimit të rrjetave nën ombrellën e kompanisë |
| <u>Energjia</u> | Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike<br>Shtrirja e rrjetit elektrik mbitokësor, i cili edhe ashtu është i vjetruar në masë të madhe<br>Shtrirja e ndriçimit publik në terë territorin<br>Shfrytëzimi i burimeve të energjisë të ripërtitshme për prodhim të energjisë elektrike dhe ko-gjenerimit për ngrohje |
| <u>Mbeturinat</u> | Përfshirja e te gjitha ekonomive familjare ne sistem të M.M<br>Eliminimi i deponive ilegale<br>Përmirësimi i ofrimit të shërbimit dhe inkasimit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave |
| <u>Telekomunikacioni</u> | Ngritja e cilësisë së telekomunikacionit<br>Promovimi i qyteteve te mençura ('smart city')<br>Mungesa e sistemit ngrohjes qendrore |
| <u>Ngrohja</u> | Hulumtimi i mundësive për ndërtimin e sistemit të ngrohjes me ko-gjenerim të bazuar në energjinë që lirohet nga termocentralet e KEK-ut përmes shfrytëzimit të gypave ekzistues deri tek Ferronikeli apo nga burimet e ripërtritshme |

DRAFT

**NEVOJAT DHE KËRKESAT PËR TË ARDHMEN:**

| | |
|---|---|
| Ujësjellës | Kyqja e vendbanimet Abria e Epërme, Fushtica e Epërme, Fushtica e Poshtme, Gradica, Negroci, Nekoci, dhe Terdeci në sistem të ujësjellësit dhe furnizmi me 24 orë ujë të pijshëm<br>Ndarja nga fabrika e Çikatovës së Vjetër që është e dizajnuar dhe ndërtuar për të furnizuar me ujë industrial dhe ndërtimi i një burimi tjetër për furnizim me ujë të pijshëm<br>Furnizimi I tërë komunës me 24 orë të pijshëm në përputhje me standardet për ujë të pijes.<br>Përtëritja e sistemit të vjetër dhe zëvendësimi me gypa të ri në mënyrë që të evitohen humbjet e ujit të pijshëm |
| Ujitja | Grumbullimi dhe shfrytëzimi i ujit të reshurave atmosferike për ujitje<br>Ndërtimi I impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe atyre atmosferik |
| Energjia | Përtëritja e rrjetit të vjetruara energjisë së dhe shtrirja e atij nëntokësor<br>Vendosja e ndriçimit publik në vende ku mungojnë<br>Vendosja e paneleve solare për shfrytëzim te energjisë së ripërtritshme |
| Mbeturinat | Përmirësimi i kushteve të punës në stacion,<br>Të verifikohet përbërja e mbeturinave,<br>Transferimi i mbeturinave të bëhet në mënyrë të vazhdueshme,<br>Të eliminohen ujerat e grumbulluara,<br>Të bëhet dezinfektimi i hapësirave etj. |
| Telekomunikacioni | Digjitalizimi i informative dhe mundësia e përdorimit të tyre nga ana e qytetarëve me anë të teknologjisë |
| Ngrohja | Përdorimi i gypave ekzistues nga KEK-u deri tek Ferronikeli për ndërtimin e sistemit dhe rrjetit të ngrohjes qendrore në Gllogoc. |

## 2.5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

### 2.5.1.GJENDJA EKZISTUESE DHE PROBLEMET

Komuna e Gllogocit është e pozicionuar në qendër të Republikës se Kosovës, ngjashëm qyteti i Gllogocit është i pozicionuar në qendër të shtrirjes hapësinore të komunës. Kjo përparësi i mundëson që të gjitha vendbanimeve në komunë të kenë lidhje të afërta rrugore me qytet, si dhe i jep përparësi komunës së Gllogocit përmes lidhjeve të mira me të gjitha komunat në Kosovë.

Sipas regjistrit të rrugëve në nivel komunal, gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor është 570.20km, prej te cilave 512.5km janë rruge lokale, 35.4km janë rruge regjionale, 19.53km janë rrugë nacionale, si dhe 2.78km janë autoudhë. (Shënim: Gjatësia tek rrugët me 4 korsi është llogaritur vetëm me një anë të rrugës).

Në mungesë të kategorizimit të rrugëve (sipas normave te planifikimit apo Ligjit për Rrugë), të gjitha rrugët në menaxhim të Komunës janë të përcaktuara si rrugë lokale. Në mungesë të informatave, në analiza nuk janë të përfshira rrugët e kodrave apo rrugët e tokave bujqësore. Infrastruktura rrugore në komunë është kryesisht e modelit me dy korsi, përveç **rrugës nacionale Prishtinë-Pejë** në gjatësi prej 19.53km, si dhe segmentit të shkurtë të **autoudhës Rruga e Kombit** me gjatësi 2.78km të cilat janë me 4 korsi. Rruga nacionale Prishtinë-Pejë, segmenti i autoudhës, rrugët tjera nacionale dhe regjionale shërbejnë si nyje kyçe për transport rrugor dhe gjendja e tyre konsiderohet të jetë kryesisht e mirë.

Në total **rrjeti rrugor lokal** është në gjatësi prej 570.20km, prej tyre rrugë me **zhavorr** janë 258.21km (56.49%) dhe të **asfaltuara** janë 335.22km (43.21%) (shih shtojcën). Rrjeti rrugor lokal i komunës se Gllogocit lidhet me rrjetin e rrugëve nacionale përmes rrugëve Prishtinë-Pejë dhe asaj regjionale Mitrovicë-Lipjan. **Kryqëzimet kryesore** në komunë janë në Komoran dhe në hyrje të Gllogocit tek rrethi.

Rrugët lokale ofrojnë lidhje shumë të mirë në mes të vendbanimeve në zona rurale si dhe me qytetin e Gllogocit. Rrugët lokale janë kryesisht në gjendje të mirë, megjithatë një pjesë e tyre janë të ngushta dhe plotësisht ju mungon infrastruktura përcjellëse siç janë pushimoret, shtigjet për këmbësorë apo biçikleta duke paraqitur një sfide serioze për këmbësorët dhe përdoruesit e mjeteve të pa motorizuara. Me fokus të veçantë duhet te trajtohen ato segmente të rrugëve që kalohen nga fëmijët në baza ditore (shtëpi-shkollë-shtëpi) apo segmentet nga njëri fshat në tjetrin.

| | | | SHTRIRJA HAPESINORE E RRUGEVE (km) | | | | GJENDJA FIZIKE (km) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri i Vendbanimit / Zonës kadastrale | Popullsia 2011 | Rrugë lokale | Rrugë regjionale | Rrugë magjistrale | Autoudhë | Rrugë te asfaltuara | Rrugë me zhavor |
| 1 | Gllogoc | 6,143 | 23.36 | 4.06 | | | 20.97 | 6.45 |
| 2 | Komoran | 4,393 | 30.6 | 3.72 | 2.75 | | 23.99 | 13.08 |
| 3 | Tërstenik | 3,903 | 34.7 | 4.97 | | | 23.58 | 16.09 |
| 4 | Llapushnik | 3,433 | 33.1 | | 4.67 | | 17.79 | 19.98 |
| 5 | Arllat | 3,134 | 21.22 | 5.37 | 4.94 | 2.78 | 20.9 | 13.41 |
| 6 | Nekoc | 3,118 | 22.22 | | | | 8.79 | 13.43 |
| 7 | Baicë | 2,307 | 26.56 | | | | 14.96 | 11.6 |
| 8 | Çikatovë e Re | 2,026 | 12.18 | 0.94 | | | 9.13 | 3.99 |
| 9 | Poklek | 1,967 | 19.12 | 0.94 | | | 10.28 | 9.78 |
| 10 | Abri e Epërme | 1,776 | 18.24 | | | | 11.82 | 6.42 |
| 11 | Gllanasellë | 1,591 | 25.54 | | | | 16.97 | 8.57 |
| 12 | Negroc | 1,540 | 12.04 | | | | 7.36 | 4.68 |
| 13 | Gllabar | 1,526 | 9.18 | 1.59 | | | 6.01 | 4.76 |
| 14 | Kishnarekë | 1,504 | 8.94 | | | | 4.08 | 4.86 |
| 15 | Dobroshec | 1,457 | 15.53 | 4.76 | | | 11.24 | 9.05 |
| 16 | Sankoc | 1,437 | 17.3 | | 1.4 | | 6.83 | 11.87 |
| 17 | Çikatovë e Vjetër | 1,261 | 17.34 | 1.78 | | | 10.07 | 9.05 |
| 18 | Vërboc | 1,247 | 17.84 | | | | 8.73 | 9.11 |
| 19 | Korroticë e Epërme | 1,240 | 11.51 | | 3.9 | | 6.81 | 8.6 |
| 20 | Krajkovë | 1,181 | 11.6 | | | | 6.86 | 4.74 |
| 21 | Tërdec | 1,121 | 11.63 | | | | 9.94 | 1.69 |
| 22 | Shtrubullovë | 1,102 | 8.77 | | | | 7.93 | 0.84 |
| 23 | Zabel i Ulët | 1,077 | 6.48 | 2.19 | 1.87 | | 6.69 | 3.85 |
| 24 | Fushticë e Ulët | 1,066 | 9.88 | 1.72 | | | 9.19 | 2.41 |
| 25 | Polluzhë | 1,017 | 11.47 | 1.63 | | | 9.22 | 3.88 |
| 26 | Fushticë e Epërme | 984 | 7.65 | | | | 5.42 | 2.23 |
| 27 | Korroticë e Ulët | 972 | 7.25 | 1.73 | | | 2.94 | 6.04 |
| 28 | Shtuticë | 934 | 9.34 | | | | 6.39 | 2.95 |
| 29 | Gradicë | 842 | 13.36 | | | | 6.81 | 6.55 |
| 30 | Domanek | 706 | 6.27 | | | | 4.56 | 1.71 |
| 31 | Vasilevë | 634 | 6.58 | | | | 4.26 | 2.32 |
| 32 | Likoshan | 600 | 11.13 | | | | 5.72 | 5.41 |
| 33 | Zabel i Epërm | 565 | 5.46 | | | | 1.83 | 3.63 |
| 34 | Vuçak | 369 | 2.4 | | | | 1.96 | 0.44 |
| 35 | Godanc | 358 | 6.7 | | | | 5.19 | 1.51 |
| | TOTAL | 58,531 | 512.50 | 35.40 | 19.53 | 2.78 | 335.22 | 234.99 |

Tabela 12. Shtrirja hapësinore e rrugëve dhe gjenda fizike e tyre

Ndotjet akustike dhe pluhuri janë dukuri te zakonshme që rrjedhin si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda. Këto dukuri negative janë të shfaqura në veçanti tek rrugët regjionale dhe nacionale, prej segmenteve të identifikuara është rruga rajonale që kalon kah Gllogoci përmes fshatrave lidhet me komunën e

DRAFT

Skenderajit. Segmenti rrugor dhe kryqëzimi që ka nevojë për zgjerim është fyti i ngushtë në rrethrrotullim në hyrje të Gllogocit.

### 2.5.2.TRANSPORTI NDËRURBAN

Transporti ndërurban i udhëtarëve ka për shërbim një stacion të autobusëve me 12 vend parkingje për autobus si dhe 24 vend parkingje për taxi. Linjat e autobusëve e lidhin Gllogocin me Shqipëri, qytetet Prishtinë dhe Skenderaj, si dhe me të gjitha vendbanimet e Gllogocit në drejtimet vajtje dhe ardhje. Frekuentimi bëhet kryesisht me autobus (shiko shtojcën) por në disa fshatra edhe me minibus. Ka mungesë të linjave pas orës 19:00 dhe gjatë pushimit veror.

| | **Numri ditor i operimeve** | |
|---|---|---|
| Linja e autobusëve | E Hënë - e Premte | Fundjavë |
| Gllogoc - Shqipëri | 3 | 3 |
| Gllogoc - Prishtinë | 33 | 12 |
| Gllogoc- Prishtinë - Skenderaj | 15 | 5 |
| Gllogoc - Dobroshec (Operatori I) | 6 | 2 |
| Gllogoc- Dobroshec - (Operatori II) | 6 | 0 |
| Gllogoc - Fushticë Epërme | 8 | 3 |
| Gllogoc - Gjergjicë | 5 | 0 |
| Gllogoc - Bytyq | 8 | 0 |
| Gllogoc - Vasilevë | 3 | 0 |
| Gllogoc - Krajkovë | 4 | 0 |
| Gllogoc - Gradicë | 8 | 0 |
| Gllogoc - Vuqak | 5 | 3 |
| Gllogoc - Terstenikë ( L.Kukaj) | 9 | 0 |
| Gllogoc - Nekoc | 13 | 4 |
| Gllogoc - Fushticë e Ultë | 3 | 3 |
| Gllogoc - Vërboc | 8 | 0 |
| Gllogoc - Polluzhë - Lagja Istogu | 7 | 0 |
| Gllogoc - Tërdecë | 7 | 0 |
| Gllogoc - Abri e Eperme | 8 | 0 |
| Gllogoc - Damanek | 3 | 0 |
| Gllogoc - Likoshan | 5 | 2 |
| Gllogoc - Kizharek | 7 | 0 |

Tabela 13. Linja e autobusëve si dhe frekuenca e shërbimeve në bazë të ditëve të punës dhe fundjave

### 2.5.3.VENDPARKINGJET

Në komunën e Gllogocit përfshihen hapësira të projektuara për të akomoduar automjetet – parkingjet. Parkingjet ekzistuese të menaxhuara nga Komuna janë:

| **Hapësirat publike (sheshet dhe parqet), kapacitetet infrastrukturore- vendparkingjet, 2018** | | |
|---|---|---|
| Hapësira | Vendparkingjet (nr.) | |
| | Për vizitorë | Për zyrtarë |
| Hapësira 01 Parkingu tek Qendra e re zejtare | 65 | 5 |
| Hapësira 02 Parkingu përballë rrugës Ilaz Kodra | 70 | 10 |
| Hapësira 03 Parkingu përballë rrugës Adem Mula( blloku i pest) | 40 | 10 |
| Hapësira 04 Parkingu në stacionin e autobusëve i përkohshëm) | 350 | 25 |
| Hapësira 05 Parkingu përballë rrugës '' Shaban Shala" | 25 | 5 |
| Hapësira 06 Parkingu përballë rrugës ''Xhevat Demaku"në SHFMU "Rasim Kiqina" | 0 | 25 |
| Hapësira 07 Parkingu përballë rrugës ''Xhevat Demaku"në QKMF" Hafir Shala" | 15 | 15 |
| Hapësira 08 Parkingu përballë rrugës ''Fadil Demaku" Tek Banesat e reja- Gllogoc | 0 | 45 |
| Hapësira 09 Parkingu përballë rrugës " Shaban Shala" në Komunën e vjetër | | 37 |
| Hapësira10 Parkingu përballë rrugës " Besim Mala" ,përballë komunës ës re | 2 | 12 |
| Hapësira11 Parkingu përballë rrugës " Besim Mala" ,përballë QRA | 7 | 10 |
| Hapësira12 Parkingu përballë rrugës " Rasim Kiqina" në QPS | 2 | 8 |
| Hapësira13 Parkingu përballë rrugës "Xhevat Demaku" për Autotaksi | | 24 |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| Hapësira14 Parkingu tek Shtëpia Integruese-Gllogoc | 5 | 4 |
| Hapësira15 Parkingu në shiritin e rrugës Shaban Shala dhe Fehmi e Xhevë Lladrovci | 40 | 10 |

### 2.5.4.INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE

Komuna e Gllogocit e ka rrjetin hekurudhor me pesë terminale hekurudhore në Dobroshec, Gllogoc, Damanek, Baicë dhe Tërdec. Në shërbim të udhëtarëve janë 3 operime ditore në linjën Fushë Kosovë – Gllogoc – Pejë. Infrastruktura hekurudhore është nën menaxhim të kompanisë publike 'TRAINKOS'. Përveç një laurete (-kufizuese apo barriere) në qytet, asnjë vendbanim nuk ka laureta mbrojtëse në kryqëzimin e rrugëve me hekurudhë dhe kjo paraqet rrezik të madh për banorët.

### 2.5.5.URAT

Në territorin e komunës janë të identifikuara në total 70 ura, në përgjithësi ura të vogla përmbi rrjedha të lumenjve e kanale të ujitjes. Gjatësia totale e urave arrin në 920 metra dhe gjerësia 527m. Kryesisht janë në gjendje të mirë fizike, përveç urës së Dobroshecit e cila është identifikuar me nevojë për intervenim ku tani më ka filluar procesi i intervenimit.

### 2.5.6.SIGURIA NË TRAFIK

Sipas raportit të zyrës për informim në policinë e Kosovës, në komunën e Gllogocit për tri vitet e fundit, janë të paraqitura gjithsej 17 aksidente me fatalitet, ku në vitin 2017 janë 7 raste, vitin 2016 janë 5 raste dhe në vitin 2015 janë 5 raste me fatalitet. Ky trend i aksidenteve tregon që nuk kanë ndonjë ndryshim të madh në vite dhe pothuajse është i njëjtë. Në këto aksidente gjatë tri viteve kanë humbur jetën gjithsej 19 persona. Lokacionet në të cilat më së shpeshti ndodhin aksidentet me fatalitet janë në rrugën regjionale Komoran-Gllogoc-Skenderaj në lokacionet: Korroticë e Ulët, Tërstenik dhe Polluzhë.

DRAFT




Harta 15 Shpërndarja e rrjetit të rrugëve në komunën e Gllogocit

**VLERËSIMI I GJENDJES:**

| | *POZITIVE* | *NEGATIVE* |
|---|---|---|
| *TE BRENDSHME* | *Përparësitë*<br>• Investimet e vazhdueshme në rrugë<br>• Kalimi i autostradës së Kombit (Prishtinë-Priren)<br>• Zgjerimi i rrugës Komoran- Skenderaj<br>• Prania e hekurudhës<br>• Përfshirja e vendbanimeve me transport publik<br>• Vendosja e kamerave afër shkollave | *Mangësitë*<br>• Cilësia e dobët e punimeve<br>• Mungesa e trotuareve në hapësirat rurale dhe afër shkollave<br>• Fyti i ngushtë në rrethrrotullim në hyrje të Gllogocit<br>• Mungesa e një nënkalimi afër qendrës tregtare<br>• Mungesa e shtigjeve për këmbësore dhe biçikleta<br>• Mos përcjellja e investimeve rrugore me infrastrukturë ndihmëse teknike (uji, kanalizimi, posta, energjia,..)<br>• Mungesa e transportit publik pas orës 19 dhe verës gjatë pushimit shkollor<br>• Mungesa e sigurisë së këmbësorëve në rrugë dhe në afërsi të hekurudhës |
| *TE JASHTME* | *Mundësitë*<br>• Hapja e rrugës alternative për transportin e xehes dhe materieve te rrezikshme<br>• Vendosja e lauretave (barrierave) tek hekurudha (ka vendkalime te pambrojtura) | *Rreziqet*<br>• Dëmtimi i rrugëve dhe trotuareve nga mbipesha e materieve të bartura nga Feronikeli<br>• Kalimi i ngarkesave të rrezikshme nëpër vendbanime siç është oksigjeni i lëngshëm nga Feronikeli |

**SFIDAT KYÇE:**

- Përfshirja e të gjitha vendbanimeve me transport publik dhe zgjatja e kohës së operimit
- Përmirësimi i lëvizshmërisë motorike dhe mundësimi i lëvizshmërisë jo-motorike (shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta, nënkalimet)
- Përmirësimi i cilësisë së punimeve në infrastrukturë të transportit dhe përcjellja e punimeve me infrastrukturë ndihmëse teknike
- Rritja e sigurisë në trafikun rrugor dhe hekurudhor dhe zvogëlimi i ndikimeve negative që shkaktohen nga transportimi i ngarkesave të Ferronikelit (bartja e oksigjenit të lëngshëm, dëmtimi i rrugëve, tollovia, zhurma)

**NEVOJAT DHE KËRKESAT PËR TË ARDHMEN:**

Për të siguruar zhvillim më të qëndrueshëm dhe rritje ekonomike që sjell përfitime të rëndësishme sociale është shumë me rëndësi që komuna të ketë infrastrukturë adekuate. Edhe pse komuna e Gllogocit ka bërë investime në këtë drejtim megjithatë duhet të konsiderohen kërkesat si në vijim:

- Ngritja e sigurisë së këmbësorëve përmes ofrimit të shtigjeve për ecje
- Ofrimi i shtigjeve për çiklistë
- Zgjerimi i rreth-rrotullimit në hyrje të Gllogocit
- Shtimi i sinjalizimit horizontal, vertikal dhe semaforët në kryqëzimet e rrugëve, sidomos tek kryqëzimet me hekurudhë
- Parashikimi i brezit të gjelbër tek rrugët dhe parkingjet për mbrojtjen e këmbësorëve nga zhurma dhe nga trafiku
- Ofrimi i linjave të mjaftueshme të transportit urban pas orës 19:00 dhe gjatë pushimit veror të nxënësve

DRAFT

## 2.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

### 2.6.1.SHËNDETËSIA

**Gjendja ekzistuese dhe problemet -** Komuna e Gllogocit sa i përket shëndetësisë ofron kujdesin parësor për gjithë territorin e komunës dhe në total janë: 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF); 5 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF), 7 Ambulanca të Mjekësisë familjare (AMF) apo Ambulantë siç njihet në termin më të zakonshëm.

Shtrirja hapësinore është e mirë dhe mbulueshmëria e tyre përkon me normat dhe standardet në fuqi. Objektet gjenden në afërsi të shkollave, duke përjashtuar disa objekte që janë në projekte për rinovim apo rindërtim (objekti në Baicë është i vjetër dhe ka nevojë për rindërtim, ai në Abri e Epërme për rinovim).Sa i përket qasjes, QMF në Arllat nuk ka pjerrinë dhe vështirëson qasjen e personave me nevoja të veçanta ndërsa në AMF-në në Tërdevc ka vështirësi për parking. Në fshatin Tërstenik aktualisht është duke u bërë zgjerimi dhe renovimi i qendrës e cila sipas projektit do të përfundoj në vitin 2019. Në fshatin Sankovc objekti i QMF-së është i vjetër dhe do të ketë disa renovime por jo të mjaftueshme. Parkingjet në asnjë objekt shëndetësor nuk janë të definuara.

Edhe pse i gjithë territori është i mbuluar me shërbime, QKMF në Gllogoc është e mbingarkuar me pacientë për shkak që mjeku në QMF-të dhe AMF-të punon një herë në javë.

Në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH)në Gllogoc, numri i mjekëve është 39 plus 5 mjekë në marrëveshje me Caritas Kosova për kohë të caktuar (3 vite), 119 infermierë dhe 3 stomatologë. Sipas Udhëzimit Administrative duhet të jetë 1 stomatolog në 6000 banorë. Kujdesi shëndetësor dytësor ofrohet në komunën e Prishtinës.

**Përkujdesja Sociale -** Qendra për Punë Sociale (QPS) gjendet në qendër të qytetit në një objekt të vjetër që nuk përmbush normat për funksionin që ka. Këtu kryhen të gjitha shërbimet sipas mandatit të kësaj qendre nën administrimin e DSHMS në vijë të drejtë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Hendikosi operon si OJQ dhe është e vendosur në një hapësirë provizore brenda hapësirave të QKMF-së dhe subvencionohet nga komuna.

Sa i përket banimit social janë 2 objekte shumë banesore në gjendje jo shumë të mirë dhe që shfrytëzohen nga familjet/banorët me asistencë sociale. Në të ardhmen duhet të punohet më shumë në integrimin e familjeve me asistencë sociale dhe të shmanget banimit social kolektiv ngase është duke ndikuar negativisht në shtimin e numrit të këtyre familjeve dhe mos-interesimin e tyre për punësim.

Gllogoci nuk ka jetimore e as shtëpi të pleqve. Qendra për Punë Sociale fëmijët jetimi strehon tek familjet strehuese ose tek të afërmit ndërsa të braktisur apo të dhunuar dërgohen në strehimore për mbrojtjen e gruas dhe fëmijëve në Prishtinë, në koordinim me Departamentin e Politikave Sociale Familjare (DPSF).

Nën menaxhimin e Ministrisë Për Punë dhe Mirëqenie Sociale është objekti i shtëpisë integruese, institucion i cili ofron shërbime mjekësore për trajtimin e personave me probleme mendore/rehabilitim të rasteve me sëmundje mentale (qëndrim ditorë). Në objektin e vjetër të komunës është e vendosur "Qendra për rehabilitimin e grave të dhunuara" e para e këtij lloji në Kosovë.

### 2.6.2.INSTITUCIONET ARSIMORE

Organizimi i arsimit në komunën e Gllogocit realizohet në katër nivele edukativo-arsimore: parashkollor-0, fillor-1, arsimi i mesëm i ulët-2 si dhe i mesëm i lartë-3. Në komunën e Gllogocit gjatë vitit 2018-2019 janë përfshirë në sistemin arsimor 136 fëmijë dhe 13,088 nxënës. Ndërsa, personel të angazhuar si mësues, arsimtar dhe profesorë janë 954 të punësuar (418 gra dhe 846 burra), derisa 168 të angazhuar të tjerë janë punëtor teknik.

Komuna e Gllogocit përfshin 33 institucione arsimore publike, si dhe 2 qerdhe private (shih shtojcën). Duke u bazuar në Norma Teknike të Planifikimit Hapësinor [20] komuna e Gllogocit plotëson kriterin e mbulueshmërisë (shih hartën). Për të gjithë nxënësit të cilët janë në largësi më shumë se 4 km komuna mundëson ofrimin e transportit. Numri i nxënësve është në rrënjë ku në vitin shkollor 2017/2018 kishte 150 nxënës më pak se vitin shkollor paraprak.

| Përshkrimi | QEAP-Qerdhe | Institucione parashkollore | Shkolla fillore | Shkolla të mesme |
|---|---|---|---|---|
| Institucione | 2 | 30 | 30 | 2 |
| Edukator / Arsimtarë / Profesorë | 22 | 49 | 555 | 171 |
| Fëmijë / Nxënës | 136 | 1052 | 9,984 | 3,108 |
| Punëtor administrativ | | | 37 | |

Tabela 14. Numri i institucioneve, edukatorëve, nxënësve dhe punëtorëve arsimor

Gjatë kohës së hartimit te PZHK-së është duke u realizuar ndërtimi i shkollës së mesme profesionale "FehmiLladrovci" në Komoran që përfshin 24 klasë me nga 8 paralele, profilet profesionale nuk janë të caktuara. Sistemi i mësimit parafillor është i organizuar në kuadër të shkollave dhe funksionon sipas normave në fuqi. Në total është 1 çerdhe publike në Gllogoc dhe një pjesë e saj në Komoran, 2 çerdhe private në komunën e Gllogocit dhe një e re do të ndërtohet në Gllogoc për të cilën është siguruar donacioni nga komisioni Evropian. Lokacioni i shkollave është i mirë dhe i qasshëm, përjashtim bëjnë shkollat në Zabel, Polluzhë, Tërstenik të cilat ndodhen në afërsi të rrugëve me frekuentim të lartë. Gjendja fizike e objekteve e mirë, mirëpo duhet theksuar që atyre iu mungon infrastruktura për një shkollë moderne. Vetëm shkolla profesionale do të posedojë palestër sportive, përderisa edhe 3 shkolla tjera janë në ndërtim e sipër të palestrës sportive ("Xheladin Gashi", "Hasan Prishtina" dhe "7 Marsi"). Synimi është që deri në vitin 2025 të punohet vetëm në një ndërrim.

**Analfabetizmi** në komunë është prezentë edhe pse nuk dëshmohet me të dhëna statistikore. Nuk është shënuar ndonjë praktikë e braktisjes së shkollimit dhe nuk ka të dhëna për nxënës të cilët nuk kanë shkuar në shkollë fare. Komuna e Gllogocit ka 57 nxënës me nevoja të veçanta dhe shpërndarja e tyre është pothuajse në tërë komunën. Transporti i tyre mundësohet nga komuna por duhet t'iu sigurohet mësues mbështetës dhe integrimi social. Sa i përket cilësisë në arsim, 85% është kalueshmëria e testit të maturës në gjimnaz, ndërsa në SHMP rreth 61%.

Në tërësi, institucionet arsimore mbulojnë rreth 47.96 ha (apo 470,960m2), të cilat janë në shërbim të numrit përgjithshëm të banorëve (58,531sipas regjistrimit zyrtar në vitin 2011). Duke iu referuar normave minimale (normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit para-universitar: ndërtesat e shkollave fillore 1.60 m²/banor; ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta 1.20 m²/banor; si dhe ndërtesat e shkollave të mesme të larta 1.00 m²/banor) është bere kalkulimi i hapësirës ekzistuese dhe çdo kërkesë për rritje ne te ardhmen.

470,960 m2 / 58,531 banorë = 8.05m2 infrastrukturës së institucioneve të arsimit para-universitar për banore (Gjendja ekzistuese)

470,960 m2 / 75,606 banorë = 6.23m2 infrastrukturës së institucioneve të arsimit para-universitar për banore (Gjendja e projektuar)

Sipas rekomandimeve nga Normat Teknike për Planifikim, duke u bazuar Komuna e Gllogocit ka hapësirë të mjaftueshme të infrastrukturës për periudhën e planifikimit të PZHK-së 2020-2028.

[20] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14822




Harta 16 Shtrirja e objekteve shëndetësore në Komunën e Gllogocit




Harta 17 Shtrirja e objekteve arsimore në komunën e Gllogocit

### 2.6.3.ADMINISTRATA PUBLIKE

Komuna e Gllogocit ka një numër të objekteve të cilat administrohen nga administrata komunale. Përpos 2 objekteve të komunës i vjetri dhe i riu, komuna administron me qendrën e shërbimit të zjarrfikësve, qendrën për të riatdhesuar, qendrën rinore, zyrat e gjendjes civile në 5 nën qendrat e komunës (në Arllat, Komoran, Tërstenik, Dobrochec, Abri dhe Epërme).

Pjesë e administratës publike që gjendet nën menaxhim të ministrive të linjës janë stacionet policore të cilat gjenden në qytetin e Gllogocit dhe një nënstacion ne Komoran.

Zyrat e gjendjes civile në Dobroshec dhe në Abri gjenden në objektet të Qendrave të mjekësisë Familjare ne këto zona. Gjatë vitit 2018-2020 është parashikuar që të bëhet ndërtimi i tyre.

### 2.6.4.KULTURA

Kultura është pjesë e rëndësishme e jetës së njerëzve që ndikon në pikëpamjet e tyre dhe ndërton identitetin e tyre. Komuna e Gllogocit në këtë grupacion përfshin 6 objekte të kulturës: 4 biblioteka, 1 qendër rinore dhe 1 sallë e kulturës.

Biblioteka në Gllogoc - (134 $m^2$) gjendet në një objekt të banesave që është pronë publiko-private me gjendje relativisht të mirë. Nëse i referohemi normave të planifikimit (0.25$m^2$/b) atëherë vërehet që sipërfaqja e bibliotekës nuk i plotëson normat teknike. Një tjetër mangësi më e madhe është se nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuar.

Salla e Kulturës në Gllogoc - (410 $m^2$) përfshin 310 ulëse, me sallë verore që gjendet në kuadër të sallës së kulturës me një sipërfaqe prej 385$m^2$ dhe përfshin parkingun e sallës me 55 vend parkingje në total që është e ndarë për zyrtarë 25 parkingje dhe për vizitorë me 30 parkingje.

Qendra Rinore në Gllogoc – (323.24 $m^2$)është objekt i vendosur në një parcelë prej 20.77.66 ha. Ky objekt ka pjerrina për persona me aftësi të kufizuar vetëm në përdhesë, ndërsa qasja në kat nuk është e mundur (nuk posedon ashensor apo pjerrinë).

Biblioteka në Arllat– me një sipërfaqe prej 54 $m^2$ është në objektin e vjetër të shkollës "Emin Duraku" dhe gjendja e objektit nuk i plotëson standardet e nevojshme dhe normat e teknike të kërkuara me ligj dhe nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuar.

Biblioteka në Tërstenik – me një sipërfaqe prej 40 $m^2$ për shkak të mungesës së hapësirës është e vendosur në objektin e ofiqarisë. Gjendja fizike e objektit është mesatare dhe nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuar. Gravitohet nga banorët që jetojnë në Tërstenik dhe rreth saj.

Biblioteka në Komoran - me një sipërfaqe prej 41 $m^2$ për shkak të mungesës së hapësirës është e vendosur në objektin e ofiqarisë. Gjendja fizike është mesatare dhe nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuar. Ky objekt gravitohet nga banorët e Komoranit dhe banorët rreth saj.

Tabela 15 Zonën gravituese, numrin e banorëve dhe vitin e themelimit.

| Vendbanimet | Institucioni | Viti I themelimit | Lagjja/ zona gravituese | Numri I banoreve |
|---|---|---|---|---|
| Gllogoc | Qendra Rinore 1 | 2001/2002 | Gllogoc | 58540 |
| Gllogoc | Salla e Kulturës 1 | 1963/64 | Gllogoc | 58540 |
| Gllogoc/ B. L. | Biblioteka 4 | 1963/64 | Gllogoc, Tërstenik, Arllat, Komoran | |

Në Gllogoc organizohen edhe disa aktivitete kulturore tradicionale: Festivali i Folklorit Burimor, Humoriada, Festivali i Memorialëve.

### 2.6.5.OBJEKTET E RINISË, SPORTIT DHE REKREACIONIT

Sporti dhe rekreacioni jo vetëm që siguron dobinë nga aktiviteti fizik por është i rëndësishëm në aspektin e zhvillimit mendor. Prandaj është më se e domosdoshme të sigurohemi që njerëzit të kenë mundësi të marrin pjesë në sport dhe aktivitete fizike. Për të arritur një gjë të tillë duhet të ofrohen objekte të qëndrueshme që rrisin nivelin e aktivitetit normal ditor. Komuna e Gllogocit ka në total 6 objekte të sportit:

DRAFT

- Stadiumi i qytetit Rexhep Rexhepi në Gllogoc- me një sipërfaqe prej 6300 $m^2$që menaxhohet nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Nëse krahasohet me norma teknike[21] ($4.5m^2/b$) atëherë vërehet se nuk është i plotësuar ky kriter. Duhet të theksohet se përveç fushës së lojës nuk ka shtegun për vrapim. Gravitohet nga banorë e Gllogocit dhe banorët e fshatrave që jetojnë rreth saj (shih shtojcën).
- Palestra sportive në Gllogoc – është objekt që përfshin në vete edhe zyre dhe menaxhohet nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Stadiumi sintetik Gllogoc – përdorët gati çdo ditë nga klubet sportive dhe shkollat e futbollit. Menaxhohet nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- 3 fusha sintetike/ Damanek, Polluzhë, Komoranë- janë prona publike por të menaxhuara nga komuniteti i fshatit. Fusha në Polluzhë dhe Komoran janë nga betoni (shih shtojcën).
- Komuna është duke investuar në përmirësimin e fushave sportive (rrethojat).

### 2.6.6.HAPËSIRAT PUBLIKE DHE TË GJELBËRA

Komuna e Gllogocit ka të identifikuara 7 hapësira publike të cilat gjenden në qytetin e Gllogocit: Sheshi "Fehmi Lladrovci"; Parku i qytetit; Parku i Komunës së re; Parku i Komunës së Vjetër; Hapësirë e gjelbëruar i Banesave (tek 5 blloqet); Hapësirë e gjelbëruar tek Çerdhja "Ardhmëria" dhe Hapësirë e gjelbëruar te qendra e re zejtare.

Këto hapësira janë pjesë-pjesë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe tentojnë të formojnë një rrjet të unifikuar të gjelbër me përmbajtje rekreative për të rritur dhe fëmijë. Qasja ofrohet kryesisht përmes transportit privat, ndërsa për banorë të moshuar, nënat me fëmijë dhe personat me nevoja të veçanta, qasja është e lehtësuar përmes intervenimeve si 'pjerrinat', ofrimit të ulëseve dhe hijes për mbrojtje nga dielli si dhe ofrimit të ujit të pijshëm. Në total janë 4.13 ha sipërfaqe të hapësirave të gjelbra që i shërben 61,133[22] banorëve në tërë komunën, që rezulton me vlerë prej 0.67m2/banor. Duke e krahasuar këtë rezultat me standardet nga Normat e Planifikimit[23], rezulton që Komuna e Gllogocit ka deficit. Tek 34 vendbanimet tjera rurale, pasi nuk ka fare hapësira të identifikuara situata rezulton të jetë shumë më e rënduar.

### 2.6.7.OBJEKTET E RELIGJIONIT

Në komunën e Gllogocit popullata i përket besimit musliman dhe katolik. Objektet e tyre të kultit hasen të shpërndara në tërë komunën e Gllogocit. Në tërësi janë 17 Këshille të Bashkësisë Islame (KBI) me xhamitë e tyre të shpërndara në fshatrat Kishnarekë, Arllat, Komoran, Korroticë e Epërme, Zabel i Ulët, Krajkovë, Damanek, Abri, Tërstenik, Verboc, Gllanasellë, Dobroshevc, Gradicë, Gllobar, Sankoc, Terdec (shih shtojcën).

Sipërfaqja totale e parcelës së xhamive është 9.27ha ndërsa sipërfaqja e ndërtuar është 0.29ha. Numri total i zyrtarëve që punojnë në KBI janë 22. Nga të gjitha këto më e vjetra është e themeluar në vitin 1748 në Arllat. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin që gravitojnë këto objekte të kultit. Në Llapushnik është e vetmja kishë katolike e ndërtuar në vitin 2016 me sipërfaqe të parcelës 0.68ha, ndërsa sipërfaqja e objektit është 0.046ha.

### 2.6.8.VARREZAT

Këto hapësira publike janë prezente në qytetin e Gllogocit dhe në shumicën e fshatrave të komunës. Të gjitha varrezat janë të popullatës të besimit mysliman. Për më tepër, nuk hasen varreza të ndara të besimit katolik. Sipërfaqja totale e varrezave në komunën e Gllogocit është 71.32ha.

DRAFT

---

[21]Udhëzimi Administrativ të MMPH-së me NR-.08.2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor

[22] Sipas vlerësimit të vitit 2017 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

[23]Ekstrakt nga Normat e planifikimit:

- Parqe publike ne kuadër te lagjes: 1m2/banor;
- Parqe publike ne kuadër te vendbanimit 2m2/banor;
- Brezat te gjelbër përgjatë rrugëve 1m2/banor;
- Brezat te gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2m2/banor;

Në disa fshatrat hasen varreza të shpërndara në 2 hapësira të ndryshme dhe kryesisht janë në prona publike. Duhet të theksohet se qasja deri tek varrezat ekziston ndërsa sa i përket objekteve përcjellëse për kryerjen e shërbimeve të varrimit mungojnë. Tek fshatrat ku varrezat janë afër xhamive atëherë shërbimet përcjellëse kryhen në xhamia. Ekziston marrëveshja në mes të Këshillit të Bashkësisë Islame dhe Komunës së Gllogocit ku komuna i mbulon shpenzimet e varrimit.

| **Nr. Rendor** | **Emri I Varrezave** | **Sipërfaqja m2** | **Mirëmbajtja në E/m2** | **Çmimi për njësi ne E/m2** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Varrezat e Qytetit Gllogoc | 16740 | 11.293,64 € | 0,67 € |
| 2 | Varrezat në Poklek | 223100 | | |
| 3 | Varrezat e Dëshmorëve ne Gllanaselle | 8249 | 5.565,19 € | 0,67 € |
| 4 | Varrezat e Dëshmorëve ne Negroc | 1678 | 1.132,06 € | 0,67 € |
| 5 | Varrezat e Dëshmorëve ne Abri e Eperme | 1838 | 1.240,01 € | 0,67 € |
| 6 | Varrezat e Dëshmorëve ne Terstenik | 1140 | 769,10 € | 0,67 € |
| Total | | 29645 | 20.000,00 € | 0,67 € |

Tabela 16. Sipërfaqja dhe kosto e mirëmbajtjes së varrezave që mbulohet nga komuna e Gllogocit

DRAFT




Harta 18 Shtrirja hapësinore e objekteve të kulturës, rinisë dhe sportit në territorin e komunës së Gllogocit




Harta 19 Shpërndarja e hapësirave të gjelbra në zonën urbane të Gllogocit

## VLERËSIMI I GJENDJES

| | POZITIVE | NEGATIVE |
|---|---|---|
| TË BRENDSHME | *Përparësitë*/Shëndetësia/Arsimi/<br>Administrata Publike/Mirëqenia<br>• Investime te vazhdueshme ne objektet arsimore dhe shëndetësore<br>• Zona e mbulimit dhe raporti mësimdhënës – nxënës me standarde<br>• Mbulueshmeria me infrastrukture adekuate dhe sipas normave<br>• Strategjia zhvillimore e komunës për arsim 2014 / 2019<br>• Qasja e lehte ne objekte<br>• Subvencionimi i Hendikosit (50%)<br>• Hartimi i programit te banimit social<br>• Shtëpia integruese dhe qendra për rehabilitimin e grave te dhunuara<br>• Objektet e administratës publike<br>• Administratoret e fshatrave<br>*Përparësitë/*Kultura, Objektet e Rinisë, Sportit dhe Rekreacionit<br>• Rinia aktive ne fushën e kulturës dhe sportit<br>• Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike ne kulturë<br>• Përdorimi i terreneve te sportit me shkolla nga komuniteti<br>• Investime në sport dhe rekreacion<br>• Infrastruktura ekzistuese është në përputhje me standarde dhe norma<br>• Mirëmbajtja e parqeve<br>• Mobilieri urbane dhe ndriçimi i mire ne parqe<br>• Hapësira e mjaftueshme e gjelbër ne objektet arsimore dhe shëndetësore dhe mirëmbajtje e mire e tyre<br>• Siguria<br>*Përparësitë Administrata Publike*<br>• Posedimi I objekteve për gjendje civile<br>• Funksionimi I objekteve për gjendje në civile qendër dhe rreth saj<br>• Stafi I trajnuar për punën që kryen<br>• Funksionimi I qendrës së zjarrfikësve në Gllogoc | *Mangësitë*/Shëndetësia/Arsimi/<br>Administrata Publike/Mirëqenia<br>• Mungesa e çerdheve<br>• Arritje e standardeve përqasje te PAK<br>• Mungesa e inventarit për teknologji informative<br>• Mungesa e sallave për edukate fizike dhe e terreneve sportive<br>• Mbulueshmria e pjesshme me transport e nxënësve (PAK)<br>• Mungesa e ri sistemimit te stafit aktual shëndetësor<br>• Buxhet jo i mjaftueshme për renovime<br>• Mungesa e stomatologeve<br>• (sipas normave)<br>• Pjerrinat<br>• Objekti i vjetër i QPS-se<br>• Objekti për Hendikos<br>• Gjendja jo e mire e ndërtesave te banimit social<br>• Mungesa e shtëpisë se pleqve<br>• Mungesa e zyrave te gjendjes civile ne 2 nën qendra (Dobroshec dhe Abri)<br>*Mangësitë/*Kultura, Objektet e Rinisë, Sportit dhe Rekreacionit<br>• Mungesa e objekteve kulturore për te plotësuar nevojat e komunitetit<br>• Qasja jo e lehtë për – PAK.<br>• Gjendja fizike e objekteve ekzistues, te bibliotekave jo e mire<br>• Mungesa e terreneve sportive dhe hapësirave për rekreacion neper zona rurale<br>• Mungesa e hapësirave te gjelbra dhe publike ne territorin e komunës<br>• Ne disa hapësira publike dhe te gjelbëria – qasja jo e lehte për PAK<br>• Mungesa e investimeve ne hapësirat publike dhe sipërfaqet te gjelbra<br>*Mangësitë Administrata Publike*<br>• 2 objekte të gjendjes civile nuk ekzistojnë (Abri dhe Dobroshec)<br>• Mosfunksionimi i rrjetit të internetit<br>• Mos ekzistimi I Objektit të zjarrfikësve në Komoran |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| TË JASHTME | *<u>Mundësitë</u>*/Shëndetësia/Arsimi/<br>Administrata Publike/Mirëqenia<br>• Përkrahje financiare nga MASHT për stafin zëvendësues ne arsim<br>• Sigurimi donacioneve për infrastrukture<br>• Programe te ndryshme për avancim profesional te stafit arsimor<br>• Sigurimi i mësueseve dhe arsimtareve për nxënësit (PAK)<br>• Programet dhe projektet për zvogëlimin e papunësisë<br>*<u>Mundësitë/</u>*Kultura, Objektet e Rinisë, Sportit dhe Rekreacionit<br>• Ndërtimi i qendrës multi-funksionale kulturore<br>• Investimet nga qeveria dhe donatoret me përmirësimin e infrastrukturës (pishina, shtigjet e vrapimit, çiklist, dhe objekti sportiv multi-funksional)<br>*<u>Mundësitë</u>/Administrata Publike*<br>• Funksionalizmi I më tepër sporteve sidomos në qendër | *<u>Rreziqet</u>*/Shëndetësia/Arsimi/<br>Administrata Publike/Mirëqenia<br>• Mbyllja e shkollave për shkak te migrimit dhe rënies se shtimit natyror<br>• Mungesa e barnave esenciale<br>• Shtimi i numrit te familjeve me asistence sociale<br>• Segregimi social<br>*<u>Rreziqet/</u>*Kultura, Objektet e Rinisë, Sportit dhe Rekreacionit<br>• Reduktimi i buxhetit për objektet dhe aktivitet kulturore<br>*<u>Rreziqet/</u> Administrata Publike*<br>• Mos funksionimi I sistemit teknologjik dhe pajisjeve<br>• Humbja e informatave, shkatërrimi nga ndonjë virus (edhe pse data baza është e ruajtur |

**SFIDAT:**

| | |
|---|---|
| Shëndetësia | Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore<br>Përmirësimi i qasjes PAK tek të gjitha objektet e shëndetësisë |
| Mirëqenia Sociale | Sigurimi mirëqenies për të gjitha grupet e margjinalizuara<br>Ofrimi i banimit dhe ulja pabarazisë ekonomike |
| Arsimi | Ofrimi i arsimit adekuat për nxënës me nevoja të veçanta dhe ngritja e nivelit të arsimit në të gjitha shkollat<br>Përmirësimi i qasjes PAK tek të gjitha objektet e arsimit<br>Shtimi i aktivitetit fizik tek fëmijët |
| Administrata Publike | Përmirësimi, perfeksionimi i shërbimeve në Gllogoc dhe rritja e numrit të stafit<br>Mungesa e shërbimeve të zjarrfikësve në fshatrat më larg qendrës |
| Kultura | Fuqizimi i kulturës përmes ofrimit të objekteve të kulturës |
| Rinia, Sporti dhe Rekreacioni | Fuqizimi i Sportit dhe Rekreacionit përmes ofrimit të objekteve dhe hapësirave adekuate<br>Përkrahja e rinisë përmes ofrimit të hapësirave adekuate për zhvillim dhe avancim |
| Hapësira publike dhe hapësira të gjelbra | Krijimi hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra të qëndrueshme (duke përfshirë shtigjet për këmbësorë, vrapim, çiklist) dhe i hapësirave të rekreacionit në viset rurale<br>Ofrimi i qasjes për PAK tek të gjitha objektet e rekreacionit |
| Objektet e religjionit dhe varrezat | Shfrytëzimi efikas i tokës publike në varreza |

DRAFT

**KËRKESAT PËR TË ARDHMEN:**

| | |
|---|---|
| Shëndetësia | Rindërtimi i QKMF në të ardhmen<br>Definimi i parkingjeve në objektet shëndetësore<br>Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore |
| Mirëqenia Sociale | Ndërtimi i shtëpisë së pleqve dhe strehimores<br>Ofrimi i qëndrimeve ditore për pleq në kuadër të QMF në bashkësitë lokale.<br>Ndërtimi i Qendrës për punë dhe mirëqenie sociale në të cilën do të mund të funksiononte edhe Handikos (për persona me nevoja të veçanta);<br>Banimi social i integruar |
| Arsimi | Ndërtimi i shkollave të reja në disa lokacione për arsye të mbingarkimit të objekteve ekzistuese<br>Sigurimi i inventarit dhe pajisjeve të teknologjisë informative (kabinete dhe laboratorë përkatëse)<br>Ofrimi i qasjes së duhur për nxënës me nevoja të veçanta |
| Administrata Publike | Sigurimi i hapësirave/kushteve për punë për funksionimin e bashkësive lokale<br>Funksionalizmi i 2 objekteve të administratës publike për shërbim civil<br>Mbulimi i tërë territorit me shërbim të zjarrfikësve |
| Kultura | Ndërtimi i bibliotekave dhe qendrës shumë-funksionale (kinemanë, sallën koncertale, teatrin, muzeun, ofrimin e shërbimit të trajnimeve)<br>Ndërtimi i qendrës sportive shumë-funksionale (pishinë, palestër etj.)<br>Përmirësimi i qasjes PAK tek të gjitha objektet e kulturës |
| Rinia, Sporti dhe Rekreacioni | Ndërtimi i Pishinës<br>Shtigjet për vrapim-gara<br>Shtigjet për çiklistë<br>Objekti sportiv shumë-funksional. |
| Hapësira publike dhe hapësira të gjelbra | Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese e sidomos në vendet e ekspozuara ndotjes (nëse është e mundur në ndonjë hapësirë në qytet)<br>Të shqyrtohet mundësia që lokacioni tek pishat në Gllobar të shndërrohet park komunal (duke rregulluar shtigjet brenda pishave, ndriçimin, ulëset , etj.) |
| Objektet e religjionit dhe varrezat | Në fshatra ku varrezat janë të ndara duhet të parashihet bashkimi i tyre me qëllim të mbrojtjes së tokës publike dhe distanca prej vendbanimeve nuk duhet të jetë më e madhe se 15km (sipas Normave Teknike)<br>Të parashihen objekte përcjellëse te kultit ku mund të ofrohen shërbime të varrimit |

DRAFT

## 2.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

### 2.7.1.MJEDISI

Ndotja e mjedisit është rezultat i shumë faktorëve si: industria, ndërtimet ilegale, infrastruktura joadekuate, shtimi i numrit të automjeteve, importimi i automjeteve të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lartë të sulfurit), deponimi joadekuat i tyre, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerja e pakontrolluar e pyjeve,

akumulimi i plehrave urbane si pasojë e menaxhimit të dobët, mungesa së riciklimit, etj. Duke konsideruar prezencën e shumicës së faktorëve të lartpërmendur, gjendja e mjedisit në komunën e Gllogocit nuk mund të konsiderohet në nivel të kënaqshëm. Industria e prodhimit të metaleve (NeWCo Feronikeli) është një nga industritë me ndikim më të madh mjedisor në Kosovë, edhe pse vërehet ulje e emisioneve që vijnë si rezultat i aktiviteteve të tyre [24]. Sektori i transportit dhe infrastrukturës së tij është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit ngase ndikon në fragmentimin dhe degradimin e habitateve (biodiverzitetit), ndryshimin e peizazhit, shfrytëzimin e tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësorë, ajrit dhe dheut. Si pasojë kemi dëmtimin e resurseve natyrore dhe humbje të tokës bujqësore. Shfrytëzimi joracional dhe pa kritere të ujit, tokës si dhe pyjeve është një tjetër çështje që duhet të konsiderohet si çështje serioze në të ardhmen. Është përgjegjësi komunale që të mbrojë dhe ruaj mjedisin natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror.

**Ndotja e ajrit -** Cilësia e ajrit në Gllogoc monitorohet përmes stacionit në Gllogoc nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, i cili raporton në Agjencinë për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Stacioni i vendosur në Gllogoc është reprezentativ për cilësinë e ajrit në sfondin urban. Matjet behën vetëm në sfondin urban e jo në tërë territorin e komunës. Nga të dhënat për matjen e përqendrimit $SO_2$, CO, $NO_2$, dhe $O_3$ shihet se nuk janë regjistruar tejkalime të vlerave mesatare vjetore (VML) në stacionin monitorues për vitin 2017.
Është vërejtur se gjatë sezonës vjeshtë-dimër-pranverë kishte tejkalime të përqendrimit të pluhurit në formë të PM10 dhe PM2.5 që janë rezultat i aktiviteteve të Feronikelit, transportit rrugor dhe amvisërive, të cilat gjatë sezonit të ngrohjes përdorim lëndë djegëse që lirojnë emisione të cilat shkaktojnë ndotjen e ajrit.
*Emisionet në ajër nga NeëCo Feronikeli*- Përmbajtja e metaleve të rënda në xehen fillestare, si Fe-hekur, Ni-Nikel, Co-Bakër, Cd-Kadmijum, Cr-Krom, As-Arsenik, Pb -Plumb etj. dhe proceset metalurgjike që e shoqërojnë procesin e tërësishëm e karakterizojnë Feronikelin ndotës të kategorisë A (sipas Kritereve për VNMBEZH dhe BB). Emisionet në ajër lirohen veçanërisht nga furrat rrotulluese, furrat elektrike, konvertori dhe ngrohtorja. Matjet nuk bëhen në mënyrë të vazhdueshme, por vetëm kohë pas kohe. Sipas një projekti të financuar nga UNDP për nivelin e ndotjes së ajrit në zonën Gllogocit[25] janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara kryesisht gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2015 në të katër lokacionet e mostrimeve (Çikatovë e vjetër, Çikatovë e Re, Gllobar dhe Lagja e Feronikelit).

**Ndotja e ujit -** Monitorimi i gjendjes së ujërave (cilësinë - ndotjen dhe sasinë) e bënë IHMK/AKMM, IHMK bën monitorimin e sasisë së ujërave ndërsa monitorimin e cilësisë ujit të pijshëm e bën IKSHP. Komuna është kompetente për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore brenda zonave urbane. Përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj kryhen matje të sasisë së ujit. Në këto stacione matet Niveli (h) dhe Prurja (Q). Në Gllogoc sasia minimale e prurjes është 0.02 $m^3/s$, mesatarja 1.52 $m^3/s$ dhe ajo maksimale është 32.80 $m^3/s$. Në komunën e Gllogocit lumenjtë kryesor janë Drenica me gjatësi 50km dhe Vërboci dhe në anën tjetër kanali i Ibër-Lepencit i cili nuk është lum. Monitorimi i lumit Drenica bëhet nga Pjetërshtica dhe para bashkimit me Sitnicën në Vragoli. Gjatë pranverës në stacionin e parë ka një cilësi më të mirë përderisa në stacionin e dytë në Vragoli gjendja pëson ndryshime të theksuara p.sh. përçueshmëria elektrike rritet për disa qindra njësi si rezultat i shkarkimeve të ujërat të mihjeve sipërfaqësore të KEK-ut.
Të gjitha ujërat e kanalizimeve të qytetit dhe fshatrave të Gllogocit derdhen në Lumin Drenica. Në komunën e Gllogocit me efekt të madh të ndotjes duhet veçuar Neë Co Feronikeli, i cili shkarkon ujëra me ngarkesë termike, ujëra të procesit dhe ujëra sanitar dhe nuk ka impiant për pastrimin apo para-trajtimin e tyre. [26]

[24]Draft raporti i Gjendjes së Mjedisit 2017, AMMK
[25]UNDP/IHMK, "Monitorimi i PM10 në ajër dhe përcaktimi i metaleve të rënda në PM10 në zonën e Gllogocit, Tetor 2015 – Mars 2016"
[26] Raporti Kadastri I Ndotësve të Ujërave të Kosovës

DRAFT

Sipas të dhënave NewCo Feronikeli, gjatë vitit 2013 janë shfrytëzuar rreth 1.2 milion m3 ujë, që shënon një rënie të ndjeshme krahasuar me vitin paraprak.[27]

| Vendbanimi | Nr, I banorëve | Vendshkarkimi |
|---|---|---|
| Qyteti | 9500 | Drenica |
| Arllat | 3199 | Drenica |
| Damaneku | 847 | Drenica |
| Gllobari | 1628 | Drenica |
| Komoran 1 | 1699 | Drenica |
| Komoran 2 | 1213 | Drenica |
| Llapushnik | 3585 | Drenica |
| Nekoc | 3230 | Drenica |
| Pokleku i ri | 900 | Drenica |
| Pokleku I vjetër | 1265 | Drenica |
| Shtrubullovë | 1287 | Drenica |
| Tërsteniku | 1958 | Drenica |

Tabela 17 Ndotësit kolektiv në komunën e Gllogocit

Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore. Megjithatë, burimet e ndotjes kryesore të ujit shkaktohen për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza dhe hedhjes se mbeturinave të ngurta (AMMK)[28]. Sa i përket Feronikelit, posedon sistem të brendshëm të trajtimit, por derdhja në lumin Drenica pas trajtimit bëhet në mënyrë nëntokësore dhe vështirëson monitorimin. Transportimi në kamionë pa mbulesë i mbetjes xehërore pas përpunimit bëhet në Çikatovë të Vjetër afërsi të kanalit të Ibër-Lepencit për ujitje, dhe ka shumë mundësi që i njëjti ndotet.

Në territorin e komunës së Gllogocit ndodhet Liqeni i Vasilevës. Ka plane[29] për shfrytëzimin e tij për turizëm. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit termal në Poklek me temperaturë 13.0˚C, pH 6.3., rrjedhje 1.00l/sec dhe mineralizim 3.52 g/l. Kohëve të fundit (dimri 2018-19) për shkak të punimeve joadekuate në kanalizim, burimi është dëmtuar dhe më nuk është i përshtatshëm për pije dhe nuk ka karakteristikat termale që i ka pasur. Nevojiten veprime konkrete në mbrojtjen e të gjithë ujërave në komunë.

**Ndotja e tokës -** Faktorët që më së shumti dëmtojnë sipërfaqe të tëra të tokës në Gllogoc janë: Vendbanimet (ndërtimet pa leje dhe të pa planifikuara), Industria (mbeturinat industriale, mihjetsipërfaqësore), Mbeturinat komunale, Deponitë, Eksploatimi i drurit (erozionet), Eksploatimi i zhavorrit (përmbytjet), Përdorimi i plehrave dhe i pesticideve për qëllime bujqësore. Monitorimin e ndotjes së tokave në nivel vendi e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.
Deponia Industriale e Feronikelit ndodhet nëÇikatovë dhe ka një sipërfaqe prej 24ha, ndërsa zona e ndikimit të saj është 71.37ha.Ky trend i ndotjes dhe degradimit të tokës akoma është në rritje, përkundër shumë masave të ndërmarra nga institucionet lokale dhe qendrore.
Përgjatë rrugëve kryesore tokat e shumta janë duke u zënë nga objektet afariste pa një strukturë te mirëfillte të planifikimit. Mungesa e planeve, mungesa e kontrollit tëzbatimit në hapësirat ku ka pasur plane (Qendra e Gllogocit), konsiderohet të jetë në favor të ndotjes së tokës. Ndotja nga metalet e rënda dhe shumë komponime organike është praktikisht e pakthyeshme (Komisioni Evropian, 2012). Dheu ka aftësi të kufizuar për të përpunuar kemikalet, për shembull nëpërmjet filtrimit apo transformimit[30]. Sipas hulumtimit të bërë nga profesorët  Muhamet Zogaj, Musaj Paçarizi, Rolf-Alexander Duering me 20 mostra të dheut nga horizontin punues i tokave bujqësore  dhe 20  mostra të bimëve në Komunën e Gllogocit janë marrë dhe analizuar për përmbajtjen e Ni, Cr, Pb, Zn, Cd, Cu, As. Është raportuar përmbajtja e metaleve të rënda në tokat bujqësore të Gllogocit. Cd në mostrat e dheut nën kulturën e grurit kanë treguar vlera deri në 0.48 mg . kg-1, me një mesatare 0.08 mg . kg-1 ndërsa në tokat nën e kulturën e misrit deri 0.08 mg . kg-$^{1}$, me një mesatare prej 0.01 mg . kg-$^{1}$. Krahasuar me standardet e BE për vlerat e lejuara të Cd në tokë (3 mg . kg-$^{1}$, EC 1986), mostrat e analizuara janë brenda standardeve. Përmbajtja e Cr  ka variruar nga 47.87 deri në 532.59 mg . kg-$^{1}$ në tokat nën kulturën me grurë, me një mesatare prej 219.39 mg . kg-1 dhe median dukshëm me te ulët prej 153.85 mg . kg-1. Në mostrat e dheut nën kulturën me misër, po ashtu Cr ka treguar variacione mjaft

[27] Raporti i ujërave 2015
[28]Draft raporti i Gjendjes së Mjedisit 2017, AMMK8
[29]IDENTIFIKIMI I PRODUKTIT TURISTIK NË RAJONIN E PRISHTINËS, MTI 2017
[30]Studimi mbi Ndotjen e Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, Identifikimi i burimeve të ndotjes dhe propozimet për masat e përmirësimit,  Janar 2015

DRAFT

të shprehura prej 95.89 deri 315.27 mg . $kg^{-1}$, mesatarja e të cilave ka qenë 153.92 mg . $kg^{-1}$ dhe median 136.71 mg . $kg^{-1}$ . Rreth 20 % e mostrave të analizuara të dheut në tokat nën kulturën e grurit i kanë tejkaluar vlerat e lejuara sipas standardit holandez (380 mg . $kg^{-1}$, Deutch list 1996), ndërsa tokat nën kulturën me misër kanë treguar vlera më të ulëta se vlera kritike. Sasia e Cu në tokë ka qenë nën pikën kritike të vlerave të lejuara sipas standardit evropian (140 mg . $kg^{-1}$ , EC 1986), përkatësisht është sjell nga 18.76 deri në 83.31 mg . kg-1 në tokat nën kulturën me grurë dhe 17.10 deri 32.35 mg . $kg^{-1}$ në tokat nën kulturën me misër, me një mesatare 33.65 mg . kg-1 dhe median 28.25 mg . kg-1, respektivisht 24.95 mg . $kg^{-1}$ dhe median 27.61 mg . $kg^{-1}$. Edhe përmbajtja e Ni ka treguar një variacion të gjërë prej 50.99 deri 583.66 mg . $kg^{-1}$ në tokat nën kulturën me grurë (mesatarja 232.67 mg . kg-1 dhe median 153.56 mg . $kg^{-1}$), respektivisht 63.38 deri 596.28 mg . kg-1 në tokat nën kulturën me misër (176.58 mg . $kg^{-1}$ dhe median 119.48 mg . $kg^{-1}$). 70% e mostrave të dheut nën kulturën e grurit dhe 90 % e mostrave të dheut nën kulturën e misrit e kanë tejkaluar pragun kritik sipas standardit të BE (75 mg . kg-1, EC 1986 ). Pb në tokat nën kulturën e grurit ka treguar vlera prej 40.24 deri në 87.11 mg . kg-1 (mesatarisht 58.07 mg . $kg^{-1}$ dhe median 55.87 mg . $kg^{-1}$), ndërsa në ato nën kulturën e misrit 38.62 deri 64.11 mg . $kg^{-1}$ (mesatarisht 50.30 mg . $kg^{-1}$ dhe median 50.69 mg . $kg^{-1}$), duke mos i tejkaluar vlerat kritike sipas BE (300 mg . $kg^{-1}$).



Figura 3 Lokacioni dhe vendndodhja e metaleve të rënda

Po ashtu edhe përmbajtja e Zn në mostrat e dheut të analizuara nuk e ka tejkaluar pragun kritik spas BE (300 mg . kg-1), duke u sjell nga 45.71 deri 110.32 mg . $kg^{-1}$ në tokat nën kulturën e grurit (mesatarisht 77.12 mg . $kg^{-1}$ dhe median 73.68 mg . $kg^{-1}$), përkatësisht 40.59 deri 82.48 mg . $kg^{-1}$ në tokat nën kuturën e misrit (mesatarisht 59.75 mg . kg-1 dhe median 59.27 mg . kg-1).

**Eksploatimi i zhavorrit** është shumë i shfaqur në Komunën e Gllogocit dhe atë shpesh guroret ndodhen ne afërsi ngjitur me lumin Drenica, siç është rasti në Lagjen Cërvadiku, në zonën kadastrale të Poklekut dhe Çikatovë të Vjetër. Ndotja shkaktohet edhe nga deponitë ilegale që ndodhen në Abri e Epërme, Gllogoc, Gradicë, Komoran, Korroticë e Epërme, Korroticë e Poshtme, Krajkovë, Likoshan, Llapushnik, Negoc, Poklek, Polluzhë, Sankoc, Shtrubullovë, Shtuticë, Tërdec, Tërstenik, Vasilevë, Verboc, Vuçak dhe Zabel i Poshtëm dhe numri I tyre në disa vende është më i madh se 1 ndonëse numri i tyre është zvogëluar dukshëm viteve të fundit. Lokacioni i tyre është i paraqitur në hartë. Nga 80 deponi që janë eliminuar, mbesin edhe rreth 50 sosh ekzistuese[31] në territor të komunës.

**Ndotja nga zhurma -** Ndotja akustike në komunën e Gllogocit është prezentë dhe kryesisht vjen nga rrugët nacionale, autoudha dhe hekurudha që kalojnë nëpër komunë, të cilat nuk kanë kurrfarë barrierash për mbrojtjen nga zhurma. Kjo manifestohet edhe si rezultat i veprimtarive të ndryshme të punës si aktivitetet e ndërtimit, gurëthyesit, pajisjet industriale, etj.

Komuna nuk ka të hartuar Planin e Veprimit dhe Hartën e zhurmës, me të cilat obligohet sipas Ligjit për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102. Këto dokumente duhet të identifikojnë lokacionet të nënshtruar zhurmës, prezantimin e tyre në hartë dhe propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma.

[31]Raporti i performanses komunale, Drenas 2017




Harta 20. Shpërndarja e objekteve fetare dhe varrezave




Harta 21 Gjendja e Mjedisit në komunën e Gllogocit

### 2.7.2.FATKEQËSITË NATYRORE

Fatkeqësitë natyrore janë dukuri të papritura nënatyrëqërezultojnë me dëme serioze dhe përbejnë rrezik për jetën, pasurinë, ambientin dhe trashëgiminë kulturore të një vendi. Në tërësi procesi i zhvillimit të një vendi është i cenuar nga rreziqet e fatkeqësive natyrore të cilat shpesh i kushtojnë miliona dhe në veçanti prekin popullatën. Komuna e Gllogocit sikurse edhe disa komuna tjera nuk është i kursyer nga këto dukuri të papritura. Ligjin nr. 04/-L-027 për FNFT, UA 02/2012, si dhe Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera janë bazë për komunat në menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore në territorin e tyre. Mbrojtja e njerëzve dhe të pasurisë së tyre private dhe publike nga zjarret, tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortekët e borës, thatësira, shpërthimi i sëmundjeve infektive, shkatërrimet e digave dhe aksidentet e ndryshme ekologjike është e rëndësisësëveçantë. Nëmënyrëqëtë adresohen sfida që rrjedhin nga fatkeqësitë komuna ka hartuar Vlerësimin e Rreziqeve për Territorin e Komunëssë Gllogocit (2010) i cili shërben si udhëzues për identifikimin e rrezikshmërisë dhe planifikimin e masave parandaluese.

### 2.7.3.VËRSHIMET

Pothuajse të gjitha komunat e Kosovës janë të prekura nga rreziku i vërshimeve që ndodhin kryesisht pas stuhive në hapësirat malore, shirave të vazhdueshme, shkrirjes së borës si dhe në rastet kur brigjet e lumenjve degradohen nga shfrytëzimi i pakontrolluar i rërës dhe hedhjes së mbeturinave. Nëpër pjesët më të ulëta të territorit të Komunës së Gllogocit kalon lumi Drenica i cili me rastin e të reshurave të mëdha atmosferike del nga shtrati dhe shkakton dëme të konsiderueshme. Në bazë të statistikave prej vitit 2004 e deri në vitin 2008 kanë ndodhur pesëvërshimeme përmasatëmëdha (në fund të shkurtit dhe fillim tëmarsit) ku janë shkaktuar dëme të mëdha në pronat bujqësore, infrastrukturë dhe objekte të banimit. Vendbanimet që ndodhen përgjatë një pjese të lumit Drenica si ato në Zabel të Ulët, Komoran, Fushticë e Poshtmë dhe Nekoc janë të rrezikuara nmga vërshimet.  Zona e rrezikuar nga vërshimet është paraqitur në në hartë. Sipërfaqja totale e rrezikuar nga përmbytjet është 264.61ha me 236 objekte. Të dhëna më të reja në lidhje me vërshimet dhe pasojat komuna nuk i posedon.

### 2.7.4.TËRMETET

Territori i komunës është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS. Për zonat mikro-sizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore.

### 2.7.5.THATËSIRA

Hulumtimet e bëra nga Komuna e Gllogocit përsasinë e ujit kanë rezultuar që disa fshatra nuk kanë burime të mjaftueshme të ujit tëpijespërtërë vitin prandaj si pasoj e mungesëssëtë reshurave atmosferike gjatëperiudhës kohore prej 15 qershorit e deri me 15 shtator këto rajone përballen me mungesën e ujit të pijes dhe rrezikun e thatësisë. Sipas shënimeveqë posedon komuna e Gllogocit nuk ka tëdhënapër shfaqjen e ndonjë epidemie pos disa rasteve të hepatitit. Në bazë të vlerësimeve që janë bërë, shkalla e rrezikshmërisëështë *i mesëm* dhe duhet kushtuar njëvëmendjetë nevojshme.

Erërat - Erërat dominante në territorin e Gllogocit është jugu si dhe erërat me kahje veriore. Forca e erërave është 2.6 deri më gjegjësisht 2.8 Bosfor, ndërsa shpejtësia prej 4.4 deri në 9.5 m/sek. Dominimi i lartë i veprimit të këtyre erërave në qytetin e Gllogocit vërehet mësë shumti në periudhën janar-prill.

### 2.7.6.FATKEQËSITË TEKNIKO-TEKNOLOGJIKE

Sipas shënimeve të DrejtoratitpërShërbime Publike dhe Emergjencë, bizneset individuale në Gllogoc kanë ndërtuar 26 Pompa të karburanteve të lëngëta për naftë dhe benzinë dhe 6 pompa me butan gaz. Shumica prej tyre janë ndërtuar pa përfillur procedurat dhe dispozitat ligjore. Kapacitet e deponive të këtyre karburanteve nuk kalojnë më tepër se 30 $m^3$ lëndë ndezëse. Bartja e këtyre lëndëve djegëse bëhët përmes magjistrales Prishtinë – Pejë, rrugëve rajonale Komoran-Gllogoc, Gllogoc-Skenderaj si dhe rrugës për Grykë të Carralevës. Rreziku kryesor është shfaqja e zjarrit dhe shpërthimeve të ndryshme.

DRAFT

Sipas shënimeve që posedon komuna nuk ka pasur ndonjë rast të shpërthimit të autocisternave apo ndezjes së tyre. Pokleku i ri dhe Komorani konsiderohen si lokacione me rrezikshmëri të lartë. Ndërsa, Fabrika e Feronikelit sasinë e lëndëve djegëse e bart përmes transportit hekurudhor si dhe një pjesë me transport rrugor. Në disa pjesë të komunës hasen edhe grumbullime të hekurit dhe automjeteve të vjetra që janë mjaft të rrezikshme për shëndetin e popullatës dhe mjedisin ngase lirojnë sasi të rrezeve radioaktive dhe vaj të automjeteve dhe njëkohësisht e kontaminojnë tokën.




Harta 22 Zonat Sizmologjike[32]

[32] Burimi i informatave nga Instituti per Seizmologji, Beograd (1987)

### 2.7.7.SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LARTË (HOT SPOTET)

Kompleksi i industrisë së Feronikelit daton që nga viti 1984 dhe ka funksionuar deri në vitin 1998. Është pronësi private të dy magnatëve izraelite dhe llogariten si njëra ndër ndërmarrjet më të mëdha në Kosovë që bën prodhimin e hekurit dhe nikelit. Mbetjet hidhen në një hapësirë afër lumit Drenica duke krijuar kodra të skories. Deponia ka njësipërfaqe prej 24ha ndërsa zona e ndikimit 45 ha dhe konsiderohet si burim i ndotjes. Gjenerohen mesatarisht 1 milion ton $m^3$ skorie në vit që ka përbërje kimike $SiO_2$, MgO, FeO dhe CaO. Këtu hidhen edhe mbeturinat komunale te Gllogocit.

### 2.7.8.SIPËRFAQET E RREZIKUARA NGA ZJARRI

Në komunën  e Gllogocit vazhdimisht ka pasur raste të shpërthimeve të zjarrit nëpër objekte banimi dhe objekte tjera ndihmesë duke mos përjashtuar rastet tjera qëkanëqenë zjarre malore dhe fushore. Sipërfaqe të shkatërrimit të pyjeve nga zjarri pas lufte janë gjithsej 120ha (deri në vitin 2010), prej tyre 94ha pishë dhe 26ha të tjera. Dëmetnuk janë të vogla por nëse përfshihen edhe zjarret në pyje kapin një kosto shumëtë madhe.  Zjarret që janë paraqitur në male dhe fusha dyshohet që janë shkaktuar nga pakujdesia e faktorit njeri. Malet Qyqavicës, Malet Vasileves, Malet e Polanës (Komoran), Malet e Pallanikut dhe Malet Kosmaqit janë hapësira që konsiderohen të rrezikuara nga zjarri.

### 2.7.9.EROZIONI

Erozioni është një fenomen që rrezikon tokën dhe ka të bëj me gërryerjen, zhvendosjen dhe transportimin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor, kryesisht nën forcën e veprimit të ujit, akullit, erës dhe aktivitetit human. Në territorin e Komunës së Gllogocit janë prezentë erozionet natyrore në malet e Qyqavicës, në Kosmaq - erozioni vertikal, në luginën e Drenicës – erozioni anësor. Fatkeqësisht janë prezente edhe erozionet në mihjet sipërfaqësore në Çikatovë të vjetër, Korreticë të epërme dhe Baicë.

### 2.7.10.  RRËSHQITJA E TOKËS, NGRICAT, STUHITË DHE ORTEQET E BORËS

Në Komunën e Gllogocit ka rrëshqitje të tokës vetëm tek minierat pra hapësirat e shfrytëzuara. Ndërsa sa i përket ngricave, stuhive dhe ortekëve të borës ku mund të pëson popullata apo të shkaktohen dëme materiale  fatmirësisht nuk hasen.




Harta 23 Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

**VLERËSIMI I GJENDJES:**

| | *POZITIVE* | *NEGATIVE* |
|---|---|---|
| *TE BRENDSHME* | *Përparësitë*/Mjedisi, Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera<br>• Ekzistimi i raportit për vlerësim të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë teknologjike<br>• Peizazhi i bujshëm bimor dhe shtazor (flora dhe fauna)<br>• Shtrirja e rrjetit të grumbullimit të mbeturinave<br>• Lokacioni për deponitë mbeturinave të konstruksioneve | *Mangësitë* Mjedisi, Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera<br>• Angazhim i pamjaftueshëm në vetëdijesim të komunitetit rreth FNFT<br>• Ndotja e lumenjve nga shkarkimet e ujërave të zeza<br>• Eksploatimi i pakontrolluar i pyjeve<br>• Prezenca e 5 gurëthyesve<br>• Djegia e gomave<br>• Deponitë e mbeturinave e metaleve (Skrap) – afërsisht 30 lokacione<br>• Prania e deponive ilegale<br>• Gjuetia e pakontrolluar<br>• Qentë endacak<br>• Detonimet nga gurëthyesi<br>• Kontaminimi ujërave nëntokësore |
| *TE JASHTME* | *Mundësitë* Mjedisi, Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera<br>• Ndërtimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga FNFT përmes trajnimeve<br>• Shfrytëzim i të dhënave nga sistemi i inventarit historik të FN (desinventar)<br>• Ndërtimi i pendës/liqeni i Vërbovcit<br>• Formimi i liqenit Verbovcit (ndërtimi i pendës)<br>• Kontrolli i vazhdueshëm i filtrave dhe funksionimi i tyre i vazhdueshëm<br>• Shfrytëzimi i donacioneve/fondit të dedikuar për komunat të cilat i ekspozohen ndikimeve negative mjedisore (Feronikeli)<br>• Hulumtimi i mëtejmë i resurseve ujore<br>• Masat mbrojtëse për zvogëlim të rrezikut nga vërshimet | *Rreziqet* Mjedisi, Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera<br>• Prania e Feronikelit dhe deponisë së Skorjes që rritë ndotjen jo vetëm të ajrit por edhe të ujit nëntokësor<br>• Ndotja nga zhurma nga makineritë dhe transporti në funksion të Ferronikelit dhe nga gurëthyesit<br>• Shpeshtësia e fatkeqësive natyrore si rezultat i ndryshimeve klimatike<br>• Vërshimi i lumit Drenica për shkak të konfiguracionit të tij<br>• Rrjet i hidrografik lumor sipërfaqësor i rrallë – lumenj të vegjël<br>• Burime të pamjaftueshme ujore dhe jo-cilësore<br>• Ndotja nga komunikacioni<br>• Bartja e lëndëve industriale të rrezikshme brenda vendbanimeve |

**SFIDAT:**

- Zvogëlimi i ndikimeve mjedisore nga industria e rëndë (Feronikeli-ajri, uji dhe toka)
- Zvogëlimi i ndikimeve mjedisore nga ndotja e ujërave dhe sigurimi i një mjedisi më të pastër
- Zvogëlimi i ndikimit nga vërshimet dhe ofrimi i një mjedisi më të sigurt
- Ruajtja e tokës nga degradimi përmes kontrollimi i ndërtimeve pa leje, deponive ilegale dhe eksploatimit legal dhe ilegal (gurëthyeseve)

**KËRKESAT PËR TË ARDHMEN – MJEDISI:**

Në të ardhmen duhet të konsiderohen këto veprime:

- Implementimi i veprimeve që rrjedhin nga Plani të veprimit lokal në mjedis
- Hartimi i Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis për projekte kapitale si dhe Vlerësimit Strategjik të Mjedisit
- Matja e vazhdueshme e përqendrimit SO2, CO, NO2, O3 dhe përqendrimit të pluhurit
- Trajtimi i ujërave të zeza përmes ndërtimit të impiantit
- Ndërtimi i akumulimit të ujit – Lumi Drenica
- Kontrollimi i humbjes së tokës përmes hartimit të planeve
- Kontrollimi dhe mbyllja e deponive ilegale, ndalimi i eksploatimi të drurit dhe zhavorit (përmbytjet),
- Kontrollimi i sasisë së përdorimi i plehrave dhe i pesticideve për qëllime bujqësore

DRAFT

- Krijimi i tampon zonave me gjelbërim rreth hapësirave të ekspozuara në zhurmë
- Shtimi i hapësirave gjelbra afër gurthyesve, hapësirave me ndotje të lartë të ajrit

**KËRKESAT PËR TË ARDHMEN DHE MASAT PREVENTIVE PËR MBROJTJEN NGA FATKEQËSITË NATYRORE:**
Duke pasur parasysh faktin që nga fatkeqësitë natyrore që godasin Komunën e Gllogocit më të shpeshta janë vërshimet, zjarret dhe skorja nga Feronikeliduhet konsideruar çështjet si në vijim:

- Integrimi i politikave në plane zhvillimore dhe hartimi i strategjive për zvogëlim të rrezikut nga FNFT
- Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhim të fatkeqësive natyrore
- Përmirësimi i bashkëpunimit mes nivelit qendror dhe lokal për menaxhim më të mirë të situatave nga fatkeqësitë natyrore.

## 2.8. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE

### 2.8.1.ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE

Trashëgimi kulturore është çdo gjë që konsiderohet e rëndësishme për të përcjellë në gjenerata të ardhshme. Është pasqyrim i mënyrës së jetesës që është zhvilluar nga komuniteti dhe e përcjellënga një brez në brezin tjetër. Në Kosovë, trashëgimia kulturore është një ndër elementet më të rëndësishme dhe pjesë përbërëse e mjedisit jetësor dhe përbën një nga pikat kryesore për zhvillimin e turizmit.[33] Sipas "Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027" trashëgimia definohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.[34] Tabela në vijim përfshin numrin e objekteve të trashëgimisë kulturore sipas kategorive (nën mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme).

| Kategoritë | Numri | Siperfaqja (ha) |
|---|---|---|
| Trashëgimia arkitekturale | 11 | 0.40.24 |
| Trashëgimia arkeologjike | 7 | 32.33.44 |
| Peizazhet kulturore | 0 | |
| Zonat e veçanta te mbrojtura | 0 | |
| Gjithsej | 18 | 32.56.44 |

Tabela 18 Trashëgimia kulturore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore, 2018[35]

Nga të gjitha kategoritë e trashëgimisë kulturore në Komunën e Gllogocit trashëgimia arkeologjike përfshin 7 asete ndërsa ajo arkitekturale përfshin 11 objekte. Duke u bazuar në informata nga Komuna e Gllogocit, prej 11 objekteve të trashëgimisë kulturore që përfshin lista e përkohshme, 1 prej tyre është në gjendje të mirë, 1 në proces të ndërtimit, 3 në gjendje mesatare, 5 të dëmtuar dhe 1 fare nuk ekziston (shih shtojcën).

Kjo na bën të kuptojmë që për promovim të trashëgimisë arkitekturale objektet që janë të dëmtuar kërkojnë intervenim serioz ndërsa për pjesën tjetër duhet të ndërmerren masa komfor ligjeve dhe praktikave të mirëfillta të konservimit. Megjithatë duhet të theksohet se komuna e Gllogocit përveç për disa asete që ka të dhëna për sipërfaqet (në hektar) e tyre për pjesën dërmuese nuk posedon. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë që komuna e Gllogocit është një vend i vjetër. Këtë më së miri dëshmon prania e gjurmëve në fshatin Vuçak ku hasen rrënojat e mureve që përcjellin konfiguracionin e kodrës dhe formojnë Gradinën e Madhe (Gjyteti i Madh) dhe Gradinën e vogël (Gjyteti i Vogël). Duke u mbështetur në materialin arkeologjik që është gjetur këtu, janë dëshmuar gjurmë që nga parahistoria e deri tek mesjeta. Kalaja ishte tipike për kohën e antikitetit të vonë dhe shërbente si sistem mbrojtës për popullatën vendase.[36]

[33] https://dtk.rks-gov.net/tkk_hyrje.aspx
[34] http://ëëë.mkrs-ks.org/repository/docs/shqip_strategjia_per_trashegimi.pdf
[35] Burimi: Aprovimi i Listës së përkohshme të trashëgimisë Kulturore MKRS
[36] Komuna e Gllogocit/Databaza MKRS

| Nr. | Emërtimi | Periudha | Vendi | Nr. Unik në databazë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Gërmadhat e kishës së vjetër në Fushticë | Mesjetë | Fushticë, Gllogoc | 715 |
| 2 | Kalaja Antikë dhe mesjetare në Vërboc | Antikitet i Vonë, Mesjetë | Vërboc, Gllogoc | 2934 |
| 3 | Qyteza e vogël dhe e madhe në Vuçak | Antikitet i Vonë | Bajicë , Gllogoc | 720 |
| 4 | Kalaja e Llapushnikut | Parahistori, Antikiteti i Vonë | Llapushnik, Gllogoc | 3608 |
| 5 | Tuma e vetmuar në Llapushnik | Parahistori | Llapushnik Gllogoc | 723 |
| 6 | Fortifikata parahistorike "Gradina" në Çikatovë të Vjetër | Parahistori | Çikatovë e Vjetër, Gllogoc | 3616 |
| 7 | Kalaja - Çuka e Godancit | Parahistori | Godanc, Gllogoc | 3706 |

Tabela 19. Trashëgimia arkeologjike/Lokalitet arkeologjik

Gllogoci edhe pse komunë jo shumë e madhe megjithatë përfshin asete të trashëgimisë kulturore-historike, materiale dhe shpirtërore të cilat veçohen për nga vlera, cilësitë dhe karakteristikat. Trashëgimia që posedon Gllogoci e sidomos ndërtesat e banimit shfaqin vërtetësinë e identitetit të shoqërisë dhe konsiderohet që mund të kontribuojnë në zhvillimet të ardhshme. Këto asete mund të jenë pika të pushimit që ofrojnë ushqim tradicional dhe të plotësojnë agjendat turistike regjionale apo më gjerë. Në mesin e këtyre aseteve mund të veçohen: *Kulla e Ibish Morinës* - pronë e z.Ibish Morinës, gjendet në fshatin Qikatovë në komunën e Gllogocit dhe është ndërtuar nga fundi i shek. XIX. Shtëpia e banimit – Smail Haxhiu, P+1 është ndërtuar në fillim në shek. XIX. *Kompleksi i Banimit i Familjes Dervisholli* gjendet në fshatin Gradicë të komunës së Gllogocit, i ndërtuar në shek. XVIII-XIX. *Mulliri i Gani Sylës*, në Kishna Rekë gjendet në mes të fshatit Kshnarekë dhe i përket shekullit XIX. *Mulliri i Gani Sylës* – ana Veri – Lindore Shek. XIX Kishna Rekë, Gllogoc. *Stacioni i Trenit* në fshatin Dobroshec – gjendet në rrugën hekurudhore Prishtinë – Fushëkosovë – Pejë në fshatin Dobroshec.

| Nr. | Emërtimi | Periudha | Vendi | Nr. Unik në databazë | **Gjendja fizike** | **Koment** *(çfarë lloj intervenimi duhet të bëhet)* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kullë – Veli Pajaziti* | Shek. XIX | Gllogoc | 3354 | dëmtuar | Nuk ekzton por është e shkatërruar |
| 2 | Kulla e Habib Xhemajlit | Shek. XX | Dobroshec, Gllogoc | 3116 | mirë | Hapur për vizitore |
| 3 | Stacioni I trenit ne Dritan (Dobroshec) | 1936 | Dobroshec, Gllogoc | 4115 | dëmtuar | Nuk funksionon |
| 4 | Kulla e Ibish Morinës | Shek. XIX | Qikatovë, Gllogoc | 3218 | mesatare | Nuk ka funksion |
| 5 | Kompleks banimi - Familja Dervisholli | Shek. XIX | Gradicë, Gllogoc | 3220 | dëmtuar | Nuk funksionon restaurim |
| 6 | Kulla e Shaban Polluzhës | Shek. XX | Polluzhë, Gllogoc | | Në process të ndërtimit | Nuk funksion |
| 7 | Shtëpi banimi – Smail Haxhiu | Shek. XIX | Poklekë i vjetër Gllogoc | 3349 | dëmtuar | Konzervim restaurim |
| 8 | Mulliri i Gani Sylës | Shek. XIX | Kishna Rekë, Gllogoc | 3351 | mesatare | restaurim |
| 9 | Shtëpi banimi - Muharrem Veseli | | Koreticë e Ulët, Gllogoc | 4449 | dëmtuar | rikonstruim |
| 10 | Linja hekurudhore Gllogoc- Pejë | 1936 | Gllogoc | 4225 | dëmtuar | rikonstruim |
| 11 | Shtëpi banimi Rexhep Zatriqi | Shek.XIX | Baincë | 3353 | dëmtuar | rikonstruim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Kulla banimi Rashit Istogu | 1912 | Polluzhë, Drenas | 4650 | Pjesërisht e dëmtuar | restaurim |

Tabela 20. Trashëgimia arkitekturale; Burimi: Komuna e Gllogocit

Duke iu referuar Planit Hapësinor Zona e Interesit të Veçantë "SHTABI I PËRGJITHSHËM I UÇK-ËS KLEÇKË DHE DIVJAKË" që përfshin territorin e komunave Lipjan, Malishevë dhe Gllogoc ku ka qenë i vendosur Shtabi i UÇK-së. Si zonë që përfshin hapësirën në afërsi të Kalasë së Llapushnikut është me rëndësi dhe Interes të Veçantë dhe gjatë përcaktimit të kushteve duhet të merren për bazë parametrat që dalin nga Ligji për Zona të Veçanta dhe të jenë në harmoni me planin e lartpërmendur.

### 2.8.2.ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE

**Gjendja aktuale, identifikimi i çështjeve**

Trashëgimia natyrore i referohet biodiversitetit duke përfshirë florën dhe faunën, ekosistemet dhe strukturat gjeologjike. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i natyrës është i rregulluar sipas ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës[37]. Sipas këtij ligji, inventarizimin e të gjithë përbërësve të larmisë biologjike, gjeologjike e peizazheve - llojet, tipit të vendbanimeve, gjeolokaliteteve dhe të peizazheve paraqitjen hartografike të llojeve të kërcënuara, gjeolokaliteteve dhe tipat e vendbanimeve etj. bëhet nga ana e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) janë marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera tjera të natyrës në mesin e të cilave janë edhe asetet e Trashëgimisë Natyrore të komunës së Gllogocit.

Si pejzazh i propozuar për mbrojte është Liqeni i Vasilevës me sipërfaqe rreth 17 ha, i cili karakterizohet me një biodiversitet të pasur bimor, shtazor dhe peisazhor. Zona e propozuar për mbrojtje e Pejsazhit te Mbrojtur "Liqeni i Vasileves" perfshin një siperfaqe të pergjithshme prej 320.9 ha. Edhe pse këto janë liqene artificiale të krijuara me depozitimi i materialit (dheut) nga mihjet sipërfaqësore në Bardh dhe Mirash nga KEK ne vitet e '60 te shekullit te kaluar, ato paraqesin zonë të rëndësishme të natyrës dhe me potencial për zhvillimin e turizmit[38]. Duke pasur parasysh rëndësinë e vlerave natyrore, Komuna e Gllogocit merr vendim që të mbrohen 9 vlera të Trashëgimisë Natyrore dhe 3 tjera propozon për mbrojtje. Këto atraksione të natyrës japin komoditet vizual dhe kënaqësi adhuruesve të natyrës.

| Kategorite | Numri | Siperfaqja (ha) |
|---|---|---|
| Rezervat i natyres | o | |
| Park kombetar | 0 | |
| Zone e vecant e mbrojtur e natyres | 0 | |
| Park i natyres | 0 | |
| Monument i natyres | 11 | 0.55 |
| Pejzazh i mbrojtur | 0 | |
| Monument i arkitektures se parkut | 0 | |
| Gjithsej : | 11 | 0.55 |

Tabela 21 Trashegimia natyrore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapesinore, 2018[39].



Foto 2. Liqeni i Vasileves

DRAFT

[37]https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2716

[38] AMMK-IKMN/Propozim profesional për shpalljen e Liqeneve të Vasileves Peizazh i Mbrojtur, 2014

[39] Burimi: Ekipa nga Instituti për mbrojtjen e monumenteve Natyrore, dhe K. E Gllogocit




Figura 4 Harta e zonës së propozuar për mbrojtje Liqenet e Vasilevës

Në mesin e vlerave të mbrojtura me vendim të komunës radhiten: "Trungjet e rrënjës "(Quercusrobur L.) në Nikaj, "Trungjet e shpardhit (Quercusfrainettoteu) në Fatos (Negrovc), "Kompleksi i trungjeve" (Quercusrobur L.) në Fatos (Negrovc), "Shpella e Kishnarekës" (me karakter Gjeomorfologjik) "Trungu i Qarrit (Quercuscerris L.) në Krajkovë, "Guri i gradinËs" në Llapushnikë,"Trungu i dushkut "(Quercussp.) në Likashan, "Trungjet e dushkut (Quercussp.) në Qëndresë, "Guri i Plakës" në Dritan.

### 2.8.3.TURIZMI

Është njëri nga industritë më të fuqishme të zhvillimit ekonomik që ngërthen në vete turizmin kulturor dhe ekoturizmin. Turizmi i trashëgimisë kulturore ofron prezantimin e objekteve që janë të trashëguara, traditave, gastronomisë etj. dhe sikur shumë segmente tjera mund të gjenerojnë beneficione ekonomike si shtim të numrit të bizneseve, hapja e vendeve të reja të punës etj. Gllogoci edhe pse ka numër të kufizuar të vlerave të trashëgimisë kulturore megjithatë ka potencial që të tërheq vëmendjen vizitorëve regjional dhe jo vetëm por edhe të turistëve. Me numrin e aseteve që posedon kjo komunë mund të jetë destinacion turistik në kuadër të agjendave regjionale të Kosovës. Atraktiviteti i trashëgimisë arkeologjike meriton të vizitohet, ndërsa ajo arkitekturale pas restaurimit mund të shërbejë për fjetje, restorante, muze, info-qendra etj.

Duhet theksuar se Liqeni i Vasilevës është potencial që gjeneron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim të ekoturizmit ku mund të organizohet peshkimi dhe ecja në natyrë. Ky lloj turizmi mund të ndërlidhet edhe me ekoturizëm të shpellave të Peshterrit në Nekovc, Shpella në Kizharekë, Shpella e KokilitVerboc, Shpella e Baicës, Shpella e Gllanasellës duke mos injoruar edhe Pishat në kodrën e Kamenicës -Gllobar dhe Pishat në Komoran si atraksion. Në këtë mënyrë ofrohet mundësia që vizitorët të shijojnë bukuritë e natyrës dhe të gjejnë pushim në brigjet e freskëta të liqenit e sidomos në ditët e nxehta të verës. Me këto vlera që ka komuna e Gllogocit është shumë me rëndësi të bëhet balancimi mes turizmit që ofron trashëgimia natyrore dhe atij që ofron trashëgimia kulturore dhe njëkohësisht të plotësojnë njëra tjetrën. Vizitorët që vijnë për të shijuar bukurinë natyrore të liqenit të Vasilevës mund të vizitojnë objektet e trashëgimisë dhe të shijojnë ushqim tradicional në Gllogoc. Në këtë mënyrë ofrohet mundësia për zhvillim të gastronomisë dhe promovimit të ushqimit tradicional. Turizmi mund të ndikohet nga festivalet dhe ngjarjet kulturore që arrijnë të mbledhin shumë vizitorë. Kërcimet e Drenicës që janë trashëgimi shpirtërore që mund të vijnë më tepër në shprehje përmes festivaleve e posaçërisht përmes Festivalit të grupeve kulturo-artistike që është pa dyshim një prej manifestimeve më të vjetra në komunën tonë është Festivali i Grupeve Kulturo-artistike të shkollave fillore i cili ka filluar të mbahet që nga viti 1955 dhe deri më sot është mbajte rregullisht me përjashtim të vitit 1990-1991 dhe 1997-1999. Për të siguruar përfitime nga turizmi, komuna e Gllogocit duhet të fokusohet në zhvillim dhe promovim të turizmit gjatë tërë vitit. Pra, promovimi është një ndër veprimet më se të domosdoshme që duhet të ndermirët sa më parë dhe të bëhet në mënyrë të duhur.

DRAFT




Harta 24 Shtrirja e Aseteve të trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë natyrore

**VLERËSIMI I GJENDJES**

| | *POZITIVE* | *NEGATIVE* |
|---|---|---|
| *TE BRENDSHME* | *<u>Përparësitë/</u>*Trashëgimia Kulturore, Trashëgimia Natyrore dhe Turizmi<br>• Numri i caktuar i vlerave të trashëgimisë kulturore<br>a) Lista e monumenteve të TK<br>• Numri i caktuar i vlerave të T.N.<br>a) Kroni i mbretit<br>b) Liqenit të Vasilevës<br>c) Prania e shpellave: Peshterit, Kishnarekë, Kokilit, Baicës, Gllanasellës<br>d) Guri i Plakës<br>e) Trungjet<br>f) Burimi i ujit thartë në Poklek të Vjetër dhe në Verbovc (lagja Istog)<br>• Konfiguracioni i përshtatshëm i terrenit, mesi i Kosovës dhe qasja relativisht e mirë në TK dhe TN<br>• Potenciali për turizëm natyror –<br>a) Pishat në kodrën e Kamenicës -Gllobar<br>b) Pishat në Komoran | *<u>Mangësitë</u>*/Trashëgimia Kulturore, Trashëgimia Natyrore dhe Turizmi<br>• Kujdesi i pamjaftueshëm i objekteve që janë në listë të mbrojtjes së përkohshme nga MKRS<br>• Qasja e vështirësuar në liqen të Vasilevës<br>• Qasja e vështirësuar tek shpellat dhe monumentet natyrore<br>• Qasja te Kalaja e Llapushnikut<br>• Infrastruktura përcjellëse për lokalitetet turistike jo e mirë<br>• Mungesa e madhe e shtigjeve për ecje dhe për çiklizëm malor |
| *TE JASHTME* | *<u>Mundësitë</u>*/Trashëgimia Kulturore, Trashëgimia Natyrore dhe Turizmi<br>• Përfshirja në listëtë përkohshme e shpellave nëVerbovc dhe Nekovc<br>• Hulumtimi dhe studimi i mëtejmë i shpellave<br>• Propozimi i 8 objekteve arkeologjike dhe arkitekturale dhe 4 vlerave natyrore; | *<u>Rreziqet/</u>*Trashëgimia Kulturore, Trashëgimia Natyrore dhe Turizmi<br>• Mungesa e financimit të mjaftueshëm nga niveli qendror për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë dhe burimeve natyrore<br>• Dëmtimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore nga ndikimet atmosferike dhe faktori njeri |

**SFIDAT/TRASHËGIMIA KULTURORE**

- Promovimi e vlerave të TK në funksion të turizmit vendor dhe zhvillimit ekonomik si dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e aseteve të Trashëgimisë Kulturore
- Ofrimi i infrastrukturës përcjellëse (ulëse, shtigje, ndriçim etj) për lokalitetet me potencial turistik (mali i Kozmaqit, kodra e pishave të Kamenicës dhe ne Komoran, liqeni i Vasilevës) dhe i qasjes adekuate në monumente të natyrës (qasja deri tek shpellat)

**KËRKESAT PËR TË ARDHMEN –TRASHËGIMIA KULTURORE**

Për arritjen e synimeve që rrjedhin nga ligjet dhe strategjitë është më se e domosdoshme të ndërmerren hapa si në vijim:

- të pengohen dukuritë negative që rrezikojnë trashëgiminë kulturore, implementime ligjet në fuqi dhe të aplikohen standardet evropiane,
- Komuna e Gllogocit bashkë me QRTK duhet të dizajnojnë politika për mbrojtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe integrimin e saj në strategji për zhvillim turizmit,
- të përcaktohet kufiri dhe perimetri tek lokalitetet arkeologjike, të hartohen planet menaxhuese për asete të rëndësishme,
- vetëdijesimi i qytetarëve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore,
- të definohet roli i trashëgimisë në funksion të turizmit dhe zhvillimit ekonomik dhe të pasurohet lista e monumenteve për mbrojtje të përkohshme (përfshirja e objektit shtëpi-shkollë 1930-1939).

DRAFT

**KËRKESAT PËR TË ARDHMEN- TRASHËGIMIA NATYRORE**

Veprimet e pakontrolluara si ndërtimet ilegale dhe ndërhyrjet pa kriter, prerjet e pakontrolluara dhe zjarret që janë në konflikt me qëllimet e mbrojtjes, rrezikojnë që rezervatet t'i humbin përgjithmonë karakteristikat e tyre natyrore për të cilat janë vënë nën mbrojtje. Për parandalimin e degradimit të mëtejshëm para se gjithash duhet:

- të ndërtohet dialogu ndër institucional e posaçërisht në mes të institucioneve lokale dhe atyre qendrore, menaxhim efikas i resurseve,
- përcaktimi i perimetrit mbrojtës rreth shpellave dhe vlera tjera që deri më tani nuk e kanë të përcaktuar,
- krijimi i bazës të dhënave që do të lehtësonte menaxhimin e potencialit ekzistues të florës, faunës dhe resurseve tjera të zonës

## 2.9. VENDBANIMET

### 2.9.1.KARAKTERI URBAN RURAL DHE FUNKSIONALITETI NDËRLIDHËS

Territori i Komunës se Gllogocit shtrihet ne pjesën qendrore te Kosovës dhe ka një sipërfaqe prej 275,6 $km^2$. Sipas Statutit të Komunës, Komuna e Gllogoci ka 44 vendbanime (43 fshatra dhe qyteti i Gllogocit), më tutje te gjitha këto vendbanime janë të shpërndara në 35 zona kadastrale. Nga këto, qyteti i Gllogocit cilësohet si vendbanim urban ndërsa 34 zonat kadastrale tjera cilësohen si rurale (fshatra). Shumica e vendbanimeve gjenden në rrafshinë dhe janë zhvilluar përgjatë korridoreve rrugore/linja të transportit automobilistik.

| Përshkrimi | Vendbanimet |
|---|---|
| Qendër komunale | Gllogoci |
| Vendbanim / Qendër e rendit të mesëm | Komorani, Arllati, Baica, Gllanasella dhe Tërstenik |
| Vendbanim | Llapushnik, Nekoc, Abri, Çikatovë e Re, Poklek, Abri e Epërme, Gllanasellë, Negroc, Gllabar, Kishnarekë, Dobroshec, Sankoc, Çikatovë e Vjetër, Vërboc, Korroticë e Epërme, Krajkovë, Tërdec, Shtrubullovë, Zabel i Ulët, Fushticë e Ulët, Polluzhë, Fushticë e Epërme, Korroticë e Ulët, Shtuticë, Gradicë, Domanek, Vasilevë, Likoshan, Zabel i Epërm, Vuçak dhe Godanc |

Tabela 16. Klasifikimi i vendbanimeve per nga funksioni

### 2.9.2.ZONA URBANE

Për nga funksionaliteti, qyteti i Gllogocit është urë lidhëse për të gjitha vendbanimet. Për me tepër, qyteti i Gllogocit shërben si qendër administrative, arsimore dhe kulturore e komunës duke akomoduar shumicën nga institucionet administrative si: komuna, gjykata komunale, qendra kryesore e mjekësisë familjare, posta, stacioni i autobusëve, stacionin hekurudhor si dhe institucionet arsimore dhe kulturore. Sipërfaqja totale e qytetit të Gllogocit është 3.7 km2, përderisa numri i banorëve në zonën urbane është 6,143 apo 10.5% e gjithë popullsisë së komunës. Qyteti i Gllogocit është e ndarë në 9 bashkësi territoriale me funksionet e tyre përcjellëse.

### 2.9.3.ZONA RURALE

Vendbanimet rurale janë gjithsej 34 dhe mbulojnë 271.1 km2 apo 98.7% e territorit te komunës. Vendbanimet rurale janë te shpërndara përreth vendbanimit kryesor – qytetit te Gllogocit dhe te gjitha karakterizohen me infrastrukture te bollshme bazike, si rruge lidhëse, infrastrukture shoqërore dhe teknike. Përderisa theksohen disa vendbanime ne pjese te skajshme te komunës qe janë pothuaj te braktisura, fshatrat si Godanci dhe Gradica.

DRAFT

Vendbanimet tjera si Komorani, Arllati, Baica, Gllanasella dhe Tërsteniku identifikohen me funksione të qendrës pasi akomodojnë shërbime për vendbanimet përreth, si p.sh. zyra te gjendjes civile, QMF apo edhe shërbejnë si ura lidhëse transportuese. Përderisa, fshatrat Çikatovë e Re, Poklek i Ri, Shtrubullovë janë në proces të zhvillimit si para lagje të qytetit të Gllogocit.




Figura 5 Bashkësitë territoriale në zonën urbane

### 2.9.4.TRENDI I ZHVILLIMEVE

Duke analizuar trendin e zhvillimeve ne komunën e Gllogocit, ne 80 vitet e fundit vërehet zhvillim paralel i zonës urbane dhe rurale. Shpërndarja e zhvillimeve përgjatë periudhës se analizuar, vitet 1941-2018, japin një pasqyre te trendit te zhvillimeve paralele ne mes zonës urbane dhe rurale – edhe pse vërehet pjesërisht intensitet me i madh i zhvillimit ne zonën urbane. Kjo dukuri e zhvillimit ne komunën e Gllogocit, për fat të mirë, nuk është ne harmoni me zhvillimet e përgjithshme në nivel te Kosovës, kështu vendbanimet rurale ne Gllogoc janë zhvilluar paralelisht me zonën urbane te Gllogocit.

Duhet te theksohet qe zhvillimet ne zonën urbane kane kaluar ne filtra te kontrollit nga qeverisja lokale, përderisa zhvillimet ne hapësirat rurale janë plotësisht te pakontrolluara. Zhvillimet e pakontrolluara kane rezultuar ne humbje te tokës bujqësore e sidomos tokës nen komasacion.

Zona Urbane e paraqitur ne hartën e sipërme (Harta 26) merr për bazë kufijtë e zonës kadastrale Gllogoc - Gllogoc, dhe për brenda kufirit urban vërehen hapësira e pashfrytëzuar apo të pa ndërtuara, kurse pjesa tjetër e pa ndërtuar është zone nen komasacion. Nga 372.2 ha sa është e gjithë zona urbane, 58 ha është hapësirë e lirë për ndërtim, kurse 55 ha janë toke pa ndërtime nën komasacion.

Pavarësisht kësaj, në dy dekadat e pas luftës vërehen zhvillime të intensitetit shtuar rreth korridoreve te rrugëve kyçe ne drejtim te Çikatovës se Re dhe Shtrubullovës. Ndërsa te gjitha hapësirat rurale identifikohen me zhvillime plotësisht te parregulluara, spontane dhe të shpërndara ku vërehet intensitet i madh sidomos ne dekadën e parë të pas luftës.




Harta 25. Bashkësitë territoriale



Harta 26 Krahasimi në mes të hapësirave të ndërtuara dhe të pandërtuara brenda zonës urbane

### 2.9.5.MADHËSIA DHE NUMRI I BANORËVE

Shpërndarja demografike karakterizohet me 6,143 banore (apo 10.5%) te cilët jetojnë ne zonën urbane, ndërsa 52,388 banore (apo 89.5%) jetojnë në fshatra[40]. Duke u bazuar ne klasifikimin e vendbanimeve formale nga 'Normat e Planifikimit' rezulton që Komuna e Gllogocit të ketë 5 kategori të vendbanimeve: 1 vendbanim shume i vogël urban (kategoria 5,000-10,000) ; 5 vendbanime të mëdha rurale (kategoria 2,500-5,000); 18 vendbanime të mesme të mëdha rurale (kategoria 1,000-2,500); ; 8 vendbanime të mesme rurale (kategoria 500-1,000); si dhe 2 vendbanime të vogla rurale (kategoria 200-500). Qyteti i Gllogocit është i vetmi vendbanim urban dhe kategorizohet si vendbanim shume i vogël urban. Te gjitha vendbanimet tjera janë vendbanime rurale ku edhe gjysma (54%) dominojnë vendbanimet e mesme te mëdha rurale.

| Klasifikimi i vendbanimeve | Përshkrimi | Klasifikimi sipas KHRP | Numri i vendbanimeve | %[41] |
|---|---|---|---|---|
| 5,000-10,000 banorë | Vendbanim shumë i vogël urban | Qendër e rendit të lartë | Gllogoci | 1.35% |
| 2,500-5,000 banorë | vendbanime te mëdha rurale | Qendër e rendit të mesëm | 5 vendbanime: Komorani, Tërstenik, Llapushnik Arllat, Nekoc | 23.79% |
| 1,000-2,500 banorë | Vendbanim i mesëm i madh rural | Qendër e rendit të ultë | 18 vendbanime – Baicë, Çikatovë e Re, Poklek, Abri e Epërme, Gllanasellë, Negroc, Gllabar, Kishnarekë, Dobroshec, Sankoc, Çikatovë e Vjetër, Vërboc, Korroticë e Epërme, Krajkovë, Tërdec, Shtrubullovë, Zabel i Ulët, Fushticë e Ulët, Polluzhë | 54.65% |
| 500-1,000 banorë | Vendbanim i mesëm i vogël rural | Qendër bazike | 8 vendbanime – Fushticë e Epërme, Korroticë e Ulët, Shtuticë, Gradicë, Domanek, Vasilevë, Likoshan, Zabel i Epërm | 16.69% |
| 200-500 banorë | Vendbanim i vogël rural | Qendër bazike | 2 vendbanime - Vuçak dhe Godanc | 3.01% |

Tabela 22 Klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit

[40] Vendor referencen: ASK Database, PopEF03

[41] Përqindja e sipërfaqës në raport me sipërfaqen e të gjitha vendbanimeve

### 2.9.6.LLOJI DHE LARTËSIA MBIDETARE

Nga aspekti i tipologjisë, Komuna e Gllogocit ka gjithsej 1 vendbanim të tipit të dendur (Gllogoci) te ndarë në lagje urbane, 5 vendbanime te tipit të shpërndarë (Komorani, Arllati, Abri, Gllanasella dhe Tërsteniku); dhe kryesisht mbesin vendbanime të tipit në mëhalla. Mëtutje, vendbanimet si: Çikatovë e Re, Çikatovë e Vjetër, Damanek, Gllobar, Gllogoc, Komoran, Korroticë e Ulët, Krajkovë, Poklek, Polluzhë, Shtrubullovë, Zabel i Epërm dhe Zabel i Ulët, karakterizohen me shtrirje në rrafsh dhe Arllat, Baicë, Dobroshec, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ulët, Gllanasellë, Godanc, Kizharekë, Korroticë e Epërme, Likoshan, Llapushnik, Nekoc, Sankoc, Shtuticë, Tërstenik, Vërboc, kanë shtrije ne rrafsh-kodër si dhe Abri e Epërme, Gradicë, Negroc, Tërdec, Vasilevë, Vuçak, kanë shtrirje në mal.

### 2.9.7.SIPËRFAQET E NDËRTUARA NË KUADËR TË VENDBANIMEVE

Duke u bazuar ne klasifikimit te sipërfaqeve sipas sistemit 'Hilucs' rezulton qe komuna e Gllogocit ne total ka hapësire me sipërfaqe prej 27,562.67 ha. Hapësirat e ndërtuara mbulojnë 3,176.44 ha apo 11.52%. Këto përfshijnë banim i individual dhe kolektiv, industri e lëndës së parë, miniere dhe gurore tjetër, infrastrukture e transportit rrugor dhe hekurudhor, shërbim arsimore, fetare, shëndetësisë, tregtar, varreza, infrastrukture sportive dhe kulturore si dhe hapësirat rekreative. Ndërsa, sipërfaqet e pa ndërtuara mbulojnë 24,386.23 ha apo 88.48% dhe përfshijnë tokë ujore, token e punueshme, kullosat si dhe pyjet. Mëtutje, sipërfaqet e ndërtuara si banimi i individual mbulon rreth 1,590.9 ha (5.77%), ndërsa banimi kolektiv 9.10 ha (0.03%). Industria e lendës së parë mbulon 329.1 ha (1.19%), miniere dhe gurore tjera 163.1 ha (0.59%), infrastrukture e transportit rrugor 784.1 ha (2.84%) dhe infrastrukture e transportit hekurudhor 64.11 ha (0.23%). Per detaje te klasifikimit te sipërfaqeve te ndërtuara sistemit 'Hilucs', i referoheni tabelës mëposhtëm:

| Klasa Hilucs 1 | Klasa Hilucs 2 | Klasa Hilucs 3 | Sip. Ha | % |
|---|---|---|---|---|
| Banim | Banim i përhershem | Banim i individual | 1,590.90 | 5.77 |
| Banim | Banim i përhershem | Banim kolektiv | 9.10 | 0.03 |
| Prodhim parësor | Bujqësi | Toke e punueshme dhe Kullose | 14,389.40 | 52.21 |
| Prodhim parësor | Pylltari | Pylltari | 9,885.40 | 35.87 |
| Prodhim dytësor | Industri e lendës së parë | Industri e lendës së parë | 329.10 | 1.19 |
| Prodhim parësor | Miniere dhe gurore | Miniere dhe Gurore tjeter | 163.10 | 0.59 |
| Rrjetet e transportit logjistikës dhe infrastrukturës publike | Rrjete të transportit | Infrastrukture e transportit rrugor | 784.10 | 2.84 |
| Rrjetet e transportit logjistikës dhe infrastrukturës publike | Rrjete të transportit | Infrastrukture e transportit hekurudhor | 64.11 | 0.23 |
| Prodhim tretësor | Shërbim komunitetit | Shërbim arsimore | 47.96 | 0.17 |
| Prodhim tretësor | Shërbim komunitetit | Shërbim fetare | 9.27 | 0.03 |
| Prodhim tretësor | Shërbim komunitetit | Shërbim shëndetesi | 5.40 | 0.02 |
| Prodhim tretësor | Shërbim komunitetit | Sherbim tjeter_Varreza | 58.55 | 0.21 |
| Prodhim tretësor | Shërbimi tregtar | Shërbimi tregtar | 109.10 | 0.40 |
| Prodhim tretësor | Shërbim kulturor argetues rekreativ | Infrastrukture sportive | 1.94 | 0.01 |
| Prodhim tretësor | Shërbim kulturor argetues rekreativ | Hapësirë e hapur rekreative | 3.58 | 0.01 |
| Prodhim tretësor | Shërbim kulturor argetues rekreativ | Sherbim kulturor | 0.23 | 0.00 |
| Shfrytëzim tjeter | Tokë ujore | Tokë ujore | 111.43 | 0.40 |
| | Total: | | **27,562.67** | **100.00** |

Tabela 23 Kategoritë e shfrytëzimit të tokës

Dendësia neto e banimit për tërë komunën e Gllogocit është 8.9 njësi banimi për hektarë. Ndërsa për zonën urbane, qytetin e Gllogocit, dendësia neto është 17.5 njësi banimi për hektarë, dhe për zonën rurale është 8.6 njësi banimi për hektarë.

Në zonën urbane prijnë dukshëm lagjja Qendër 1 dhe Qendër 2 me nga 53 dhe 33.1 njësi banimi për hektarë, duke u ul ndjeshëm dendësia ne lagjet tjera te qytetit. Ndërsa, tek hapësirat rurale, zona Sankocit prinë me 11 njësi banimi për hektarë, zona Komoran me 10.1 njësi banimi për hektarë dhe Çikatove e re me 9.8 njësi banimi për hektarë. Dendësia me e ulët ndër hapësirat rurale është zona e Terstenikut me mesatare 6.8 njësi banimi për hektarë.

Kur te krahasohen dendësia aktuale me normat e planifikimit për dendësinë e banimit, rezulton qe qyteti i Gllogocit me 17.5 njësi banimi për hektarë, ende nuk ka arrit te densifikohet mjaftueshëm qe te vendoset ne njërën nga 3 kategoritë për struktura te ndërtuara ne zona urbane (Sipërfaqe urbane e përgjithshme, qendrore apo kryesore). Sipas kategorizimit ne norma, Gllogoci rezulton te kategorizohet si 'Sipërfaqe sub-urbane' ku dendësia del te jete 6-21 njësi banimi për hektarë.

Përderisa, te gjitha hapësirat rurale, sipas dendësisë aktuale kategorizohen si 'Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë' me dendësi 5-10 njësi banimi për hektarë.

| Emri i Vendbanimit | Emri i Vendbanimit / Zonës kadastrale | Sip_km | Sip_ha total si Zone kadastrale | Popullsia 2011 | Sipërfaqja e ndertuar ekzistuese ne ha | Sipërfaqja e ndertuar ne ha planifikuar | Zona e lire ( ne kuader te zones se ndertimit ) ne ha | Njësitë e banimit 2011 | Njesitë e banimit 2012 -2018 | Totali i njesive të banimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Arllat | Llapushnik | 15.22 | 1522.3 | 3,433 | 111.1 | 166 | 54.9 | 699 | 165 | 864 |
| | Arllat | 13.11 | 1310.8 | 3,134 | 78.2 | 134.3 | 56.1 | 598 | 129 | 727 |
| | Negroc | 10.06 | 1006.3 | 1,540 | 35.1 | 74.7 | 39.6 | 244 | 42 | 286 |
| | Vuçak | 4.58 | 458.4 | 369 | 9.3 | 12.2 | 2.9 | 63 | 19 | 82 |
| Baice | Baicë | 11.50 | 1149.7 | 2,307 | 70.8 | 85.5 | 14.7 | 420 | 93 | 513 |
| | Abri e Epërme | 12.08 | 1208.5 | 1,776 | 40.6 | 69.6 | 29 | 295 | 31 | 326 |
| | Tërdec | 8.39 | 839.1 | 1,121 | 30.9 | 48.3 | 17.4 | 195 | 26 | 221 |
| | Domanek | 3.14 | 313.7 | 706 | 23.5 | 39.9 | 16.4 | 128 | 38 | 166 |
| Çikatove e Re | Çikatovë e Re | 5.58 | 558.1 | 2,026 | 142 | 183.4 | 41.4 | 528 | 63 | 591 |
| | Gllabar | 5.08 | 508.2 | 1,526 | 66.7 | 134.1 | 67.4 | 343 | 88 | 431 |
| | Krajkovë | 7.48 | 747.7 | 1,181 | 37.4 | 67.9 | 30.5 | 191 | 53 | 244 |
| | Shtrubullovë | 2.79 | 279.0 | 1,102 | 32.2 | 69.2 | 37 | 242 | 73 | 315 |
| Gllanaselle | Gllanasellë | 10.58 | 1057.8 | 1,591 | 44.9 | 89.6 | 44.7 | 301 | 51 | 352 |
| | Dobroshec | 13.02 | 1301.6 | 1,457 | 41.7 | 68.4 | 26.7 | 278 | 56 | 334 |
| | Çikatovë e Vjetër | 6.66 | 666.1 | 1,261 | 36.7 | 56.5 | 19.8 | 267 | 45 | 312 |
| | Gradicë | 12.25 | 1224.6 | 842 | 10.2 | 19.9 | 9.7 | 183 | 18 | 201 |
| | Likoshan | 4.56 | 455.9 | 600 | 17.6 | 32.4 | 14.8 | 143 | 17 | 160 |
| | Godanc | 3.71 | 371.4 | 358 | 23.8 | 48.2 | 24.4 | 80 | 7 | 87 |
| Komoran | Komoran | 11.28 | 1127.7 | 4,393 | 113.2 | 239.6 | 126.4 | 1110 | 209 | 1319 |
| | Nekoc | 10.35 | 1034.9 | 3,118 | 72.56 | 124.1 | 51.54 | 611 | 109 | 720 |
| | Kishnarekë | 6.60 | 659.6 | 1,504 | 37.1 | 66.6 | 29.5 | 275 | 48 | 323 |
| Sankoc | Sankoc | 13.96 | 1396.2 | 1,437 | 39.2 | 619.7 | 580.5 | 348 | 70 | 418 |
| | Fushticë e Ulët | 6.13 | 612.7 | 1,066 | 27.07 | 76.1 | 49.03 | 165 | 44 | 209 |
| | Fushticë e Epërme | 4.55 | 455.4 | 984 | 22.8 | 39.4 | 16.6 | 178 | 37 | 215 |
| | Zabel i Epërm | 3.12 | 311.7 | 565 | 18 | 38.1 | 20.1 | 134 | 32 | 166 |
| Terstenik | Tërstenik | 15.60 | 1560.5 | 3,903 | 124.3 | 160 | 35.7 | 731 | 131 | 862 |
| | Vërboc | 7.99 | 798.9 | 1,247 | 34.2 | 42.5 | 8.3 | 224 | 23 | 247 |
| | Polluzhë | 4.18 | 417.8 | 1,017 | 36.3 | 53.6 | 17.3 | 179 | 35 | 214 |
| | Shtuticë | 4.63 | 462.9 | 934 | 22.6 | 32.9 | 10.3 | 150 | 16 | 166 |
| Zabel I Ulët | Poklek | 6.97 | 696.9 | 1,967 | 69.2 | 124.3 | 55.1 | 489 | 89 | 578 |
| | Korroticë e Epërme | 8.48 | 848.4 | 1,240 | 41 | 207.5 | 166.5 | 257 | 83 | 340 |
| | Zabel i Ulët | 4.51 | 451.2 | 1,077 | 37.1 | 89.3 | 52.2 | 203 | 57 | 260 |
| | Korroticë e Ulët | 4.12 | 412.1 | 972 | 34.2 | 41.7 | 7.5 | 188 | 61 | 249 |
| | Vasilevë | 9.65 | 965.0 | 634 | 18.9 | 38.6 | 19.7 | 125 | 23 | 148 |
| Gllogoci sipas lagjeve | Drenas 1 | 0.43 | 42.7 | 946 | 22.21 | 255 | 135.1 | 221 | 39 | 260 |
| | Drenas 2 | 0.78 | 77.5 | 1,040 | 28.32 | | | 226 | 29 | 255 |
| | Drenas 3 | 0.31 | 30.7 | 1,012 | 16 | | | 205 | 23 | 228 |
| | Qender 1 | 0.16 | 16.1 | 1,095 | 7.06 | | | 374 | 0 | 374 |
| | Qender 2 | 0.10 | 9.8 | 295 | 1.51 | | | 49 | 1 | 50 |
| | Qender 3 | 0.43 | 42.9 | 1,125 | 18.85 | | | 253 | 24 | 277 |
| | Komasacion | 0.96 | 95.6 | 330 | 14.77 | | | 57 | 73 | 130 |
| | Laxha e Xhamise | 0.27 | 26.9 | 260 | 6.23 | | | 52 | 19 | 71 |
| | Zona e Feronikelit | 0.30 | 29.5 | 40 | 5 | | | 7 | 0 | 7 |
| | **TOTAL** | **275.63** | **27,563** | **58,531** | **1720** | **3649** | **2049** | **12009** | **2289** | **14298** |

Tabela 24 Dendësia neto e paraqitur për vendbanim

DRAFT

### 2.9.8.VENDBANIMET JO FORMALE DHE NDËRTIMET PA LEJE

| Lokacioni | Siperfaqe | Banor | Objeket |
|---|---|---|---|
| Lagjja Feronikelit | 5.96 ha | 309 | 61 |
| Lagjja 'Roga' | 4.23 ha | 230 | 46 |
| Lagjja e Re ne Komoran | 4.03 ha | 135 | 27 |

Tabela 25 Vendbanimet Joformale

Komuna e Gllogocit i ka 3 Vendbanime Joformale te cilësuar si të tille nga PZHK/U 2008-2020+ si dhe nga 'Raporti i gjendjes së vendbanimeve joformale në Kosovë'[42].

Siç paraqitet ne tabele, këto vendbanimet jo formale janë: Lagja e Re ne Komoran, Lagja Roga dhe Lagja Feronikeli. Karakterizohen me mungesë të infrastrukturës fizike dhe sociale dhe kryesisht ne to jetojnë banorë të komunitetit shqiptarë.



Foto 3. Lagja Feronikeli

**Lagjja Feronikelit** ka një sipërfaqe prej 5.96ha dhe gjendet në zonë me rrezik te shumëfishte për shkak te afërsisë me Fero-nikelin pasi i nënshtrohet ndotjes te shumëfishtë si ajo e ujit, ajrit, zhurmës, mbetjeve, ndotje industriale, etj.

Aty janë te identifikuar 61 shtëpi private me 309 banorë. Lartësia e ndërtimit është prej 1 deri ne 3 etazhe. Infrastruktura teknike ekziston ne tërësi dhe shumica e shtëpive janë te reja dhe në gjendje te mirë fizike.



Foto 4. Lagjja Roga

Përderisa, mungon tërësisht infrastruktura sociale, pra nuk ka shkolle, çerdhe, qendra shëndetësore dhe institucione tjera. Gjithashtu, prezent ende ne këtë zone është problemi i zotërimit të pronësisë joformale apo pronësia jo e sigurte, pasi pronar te tokës janë komuna dhe Fero-nikeli. Shfrytëzimi i tokës ne këtë lagje dominohet nga banimi individual dhe hapësira te dedikuara për rrugë kryesisht për vetura.

Hapësirat te dedikuara për transport jo-motorrik apo për lëvizje te këmbësoreve (trotuaret) nuk ekzistojnë. **Lagjja 'Roga'** gjendet ne pjesën juglindore te qytetit dhe zanafilla e saj është nga periudha e pasluftës se fundit. Ne total ka një sipërfaqe prej 4.23 ha dhe karakterizohet me rregullim te rrjetit te rrugëve dhe radhitje logjike te ndërtimeve, edhe pse ne mungese te planit zyrtar te planifikimit. Ne total janë 46 shtëpi private me nga 1 deri ne 3 etazhe maksimum. Infrastruktura teknike dhe sociale plotësisht mungon në brendësi të lagjes, por banorët shfrytëzojnë shkollën e mesme dhe fillore që gjenden në rrugën kryesore përball lagjes. Edhe ne këtë rast zotërimi formal i pronësisë nuk është prezent nga banorët pasi toka është ne pronësi komunale.

[42] MMPH, 2010



Foto 5. Lagjja e Re, Komoran

**Lagjja e Re ne Komoran** shtrihet ne pjesën lindore te fshatit Komoran, përgjatë rrugës magjistrale Prishtine – Pejë. Zanafilla e këtij vendbanimi është nga vitet e 70-ta dhe shtrihet ne sipërfaqe prej 4.03 ha. Ndërtimet e objekteve private dhe rrjeti i rrugëve kane ndjek një rregull vizuel te organizimit, edhe pse ne mungese te planit zyrtar te planifikimit. Ne total janë te identifikuara 46 shtëpi private me etazhitet 1 deri 3 kate.

Rrjeti i kanalizimit ekziston dhe derdhet ne rrjetin kryesor të kanalizimit fekal të kësaj zone, ndërsa banorët furnizohen me ujë nga rrjeti i ujësjellësit rajonal. Lagja karakterizohet me zotërim joformal pronësie pasi titullar edhe ne këtë rast është komuna e Gllogocit. Në pjesë e rrugës magjistrale përgjatë saj, tashmë janë ndërtuar shume objekte afariste. Shfrytëzimi i tokës dominohet nga shtëpi banimi private dhe rrjeti i rrugëve i cili ka hapësirë te kufizuar qe te ofrojë lëvizje e duhur. Infrastruktura sociale nuk ekziston përbrenda lagjes. Pasi që kjo lagje ndodhet afër rrugës magjistrale Prishtinë-Pejë, dhe ka numër të madh të mjeteve motorike mjedisi në këtë zonë është i ndotur.

**Ndërtimet pa leje -** Sipas të dhënave nga Regjistri Shtetëror i Ndërtimeve Pa Leje (RShNPL), të bazuara më tutje në raportimet nga niveli lokal, në Komunën e Gllogocit janë regjistruar gjithsej 13,904 ndërtime pa leje të kategorisë objekte banimi dhe objekte përcjellëse (Ia, Ib ,II dhe III), që paraqet vetëm rreth 80 % të numrit të përgjithshëm të objekteve ne komune apo 3.93% te objekteve pa leje ne nivel te Kosovës, përderisa dominojnë objektet me pronësi private. Më tutje, një ndër elementet bazë për të përcaktuar kërkesën për tokë të nevojshme për të akomoduar zhvillimin e ardhshëm është dendësia e banimit. Dendësia neto e banimit është përcaktuar duke ndarë/pjesëtuar numrin e njësive të banimit me sipërfaqen për banim.

DRAFT




Harta 27 Trendi i zhvillimeve para viti 1970 deri ne 2018




Harta 28. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas vendbanimeve




Harta 29 Hipsometria e terrenit




Harta 30 Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve dhe vendbanimet joformale




Harta 31. Shtrirja e ndërtimeve pa leje




Harta 32 Shfrytëzimi aktual i tokës

**VLERËSIMI I GJENDJES:**

| | *POZITIVE* | *NEGATIVE* |
|---|---|---|
| *TË BRENDSHME* | *Përparësitë*<br>Vendbanimet, Vendbanimet Joformale<br>▪ Shpërndarja proporcionale e nën-qendrave duke ofruar shërbime për tere territorin komunal<br>▪ Dendësia e ulet e ndërtimeve ne hapësirat urbane dhe rurale<br>▪ Sipërfaqja e madhe e tokës bujqësore, ende me potencial<br>▪ Pozita gjeografike e komunës ne Kosovë<br>▪ Lidhja e mirë e vendbanimeve me qendrën komunale<br>▪ Zhvillim relativisht kompakt ne pjesën jugore te komunës<br>▪ Pozicionimi relativisht i mirë i shërbimeve administrative, publike dhe sociale | *Mangësitë*<br>Vendbanimet, Vendbanimet Joformale<br>▪ Zhvillim i shpërqendruar i vendbanimeve ne pjesën veriore te komunës<br>▪ Zhvillimi i pakontrolluar i ndërtimeve përgjatë rrugëve magjistrale, regjionale, fshatra dhe ne toke bujqësore<br>▪ Çështjet pronësore te pazgjidhura paraqesin barrierë për zhvillim<br>▪ Mos aplikimi i taksës se densitetit<br>▪ VJF nuk janë trajtuar<br>▪ Shtrirja e kufizuar e infrastrukturës teknike në vendbanimet rurale (ujësjellës dhe kanalizim)<br>▪ Përqendrimi i shërbimeve administrative ne qendrën komunale<br>▪ Ndërtimet pa leje<br>▪ Komasacioni jo funksional |
| *TË JASHTME* | *Mundësitë*<br>Vendbanimet, Vendbanimet Joformale<br>▪ Ngrirja e gjendjes ekzistuese te ndërtimeve ne zonën qe nuk janë te lejueshme<br>▪ Kontrollimi i zhvillimeve bazuar ne zonat nen komasacion dhe zonat tjera<br>▪ Rigjenerimi urban i hapësirave brenda vendbanimeve<br>▪ Densifikimi i vendbanimeve brenda kufijve ekzistues te ndërtimit<br>▪ Kompletimi i infrastrukturës fizike<br>▪ Përforcimi me infrastrukture dhe administratë te nën-qendrave | *Rreziqet*<br>Vendbanimet, Vendbanimet Joformale<br>▪ Pozita e vendbanimit afër fabrikës Feronikel<br>▪ Mos bashkëpunimi  ne mes te nivelit qendror dhe lokal rreth investimeve qe bene qeveria (pëlqimet për kyçje)<br>▪ Ndërhyrja e nivelit qendror ne kompetenca te komunës për kontroll te zhvillimeve (lejet)<br>▪ Vazhdimi i zhvillimeve kaotike dhe pa plan<br>▪ Humbja e pa kthim e tokës bujqësore |

**SFIDAT:**

<u>Vendbanimet dhe Vendbanimet Joformale</u>

- Kontrolli i mangët i ndërtimeve ne fshatra
- Kufizimi i zgjerimit te vendbanimeve dhe dendësimi adekuat
- Rregullimi i VJF
- Menaxhimi i migrimit rural-urban

**NEVOJAT DHE KËRKESAT PËR TË ARDHMEN:**

<u>Vendbanimet dhe Vendbanimet Joformale</u>

- Trajtimi i zonave ne komasacion.
- Te definohet hapësirat e zhvillimit ne zona urbane dhe fshatra.
- Legalizimi ne baze te ligjit te ri.
- Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime
- Trajtimi i depopullimit

DRAFT

## 2.10. BANIMI

Banimi në Komunën e Gllogocit në pjesën dërmuese ka tipologji rurale dhe dendësi të ulët. Shumica e fondit te banesave janë te reja, kryesisht të ndërtuara pas luftës. Ndërtimet nuk janë përcjellë gjithmonë shërbime adekuate publike, duke ndikuar edhe në kushtet sanitare dhe mjedisore. Numri i njësive të banimit për ndërtesat individuale është 11348 sosh . Ndërtesa kolektive janë 31. Në kuadër të vendbanimeve, banimi si funksion përfshinë sipërfaqen më të madhe. Sipërfaqja e gjithëmbarshme e banimit është 1600 ha, që përbën 5.8% të territorit komunal. Pothuajse e tërë sipërfaqja e banimit përbëhet nga banimi individual - 1,590.9 ha (5.77%), derisa ai në bashkëpronësi përfshinë 9.10 ha (0.03%)[43]. Vendbanimet që dallohen për nga sipërfaqet më të mëdha të banimit janë Tërsteniku - 124 ha, Gllogoci - 120 ha, Komoran -113 ha, Llapushniku - 111 ha.

### 2.10.1. BANIMI NË TERITORIN URBAN DHE RURAL

Sa i përket numrit të njësive të banimit, profili komunal i referohet regjistrimit të popullsisë së v. 2011.

Bazuar në të dhënat e ASK-së[44], del se komuna e Gllogocit ne vitin 2011 ka 58.531 banorë të cilët jetojnë në 8.786 ekonomi familjare, 1,444 prej të cilave janë në zonën urbane ndërsa 10,565në zonën rurale.

Numri i përgjithshëm i njësive të banimit në Kosovë është 412.884, prej të cilave 175.942 (43%) janë në zonën urbane, ndërsa 236.942 (57%) në zonë rurale. Në komunën e Gllogocit, numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 12,009 [45]. Pak më ndryshe nga Kosova, pjesa më e madhe e njësive të banimit gjenden në zonën rurale të komunës - 1,444 (12% ), ndërsa në atë rurale - 10,565 (88%).

| Numri i banorëve | | Ekonomitë familjare | Njësitë e banimit | Ndërtesat e banimit |
|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Nr. | Nr. | Nr. |
| Komuna e Gllogoci | 58.531 | 8.786 | 12,009 (100%) | 8096 |
| Zona urbane | 6,143 | 1,047 | 1,444 (12%) | 807 (10%) |
| Zona rurale | 52,388 | 7,733 | 10,565 (88%) | 7289 (90%) |

Tabela 26. Fondi i banimit në raport me njësitë e banimit dhe tipologjinë e ndërtesave të banimit

Banimi në ndërtesa banimi me shumë njësi, natyrisht se është më i koncentruar në zonën urbane, ku edhe gjenden afro 90% e ndërtesave të tilla në komunën e Gllogocit.

| | NR I NJESIVE TE BANIMIT | | | NR I NJESIVE TE BANIMIT | |
|---|---|---|---|---|---|
| Emri i Vendbanimit / Zonës kadastrale | Shtëpi | Banesa kolektive | Emri i Vendbanimit / Zonës kadastrale | Shtëpi | Banesa kolektive |
| Gllogoc | 1229 | 25 | Korroticë e Epërme | 284 | |
| Komoran | 788 | | Krajkovë | 263 | |
| Tërstenik | 793 | | Tërdec | 235 | |
| Llapushnik | 629 | | Shtrubullovë | 264 | |
| Arllat | 475 | | Zabel i Ulët | 104 | |
| Nekoc | 508 | | Fushticë e Ulët | 158 | |
| Baicë | 464 | | Polluzhë | 217 | |
| Çikatovë e Re | 401 | 2 | Fushticë e Epërme | 151 | |
| Poklek | 524 | 4 | Korroticë e Ulët | 228 | |

[43] Sipas kategorizimit të HILUCS
[44] ASK, vjetari statistikor i Republikës së Kosovës 2018
[45] ASK, Banesat dhe Ndërtesat, sipas komunave, 2013.

DRAFT

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Abri e Epërme | 265 | | Shtuticë | 187 | |
| Gllanasellë | 357 | | Gradicë | 212 | |
| Negroc | 203 | | Domanek | 152 | |
| Gllobar | 313 | | Vasilevë | 117 | |
| Kishnarekë | 220 | | Likoshan | 153 | |
| Dobroshec | 314 | | Zabel i Epërm | 261 | |
| Sankoc | 257 | | Vuçak | 51 | |
| Çikatovë e Vjetër | 223 | | Godanc | 89 | |
| Vërboc | 259 | | TOTAL | **11348** | **31** |

Tabela 27. Numri i njësive të banimit- shtëpive dhe banesave kolektive sipas vendbanimeve[46]

DRAFT

Bazuar në parashikimet për rritje të popullsisë (kaptina për demografi), deri në vitin 2028 parashikohet rritje përafërsisht prej 14,692 banorë në zonën rurale, dhe 3,415 banorë në zonën urbane (duket llogaritur edhe Çikatovën e Re në zonën urbane). Numri i ekonomive familjare në qytet parashikohet të rritet përafërsisht për 476 ekonomi familjare, ndërsa në fshatra për 2939 ekonomi familjare.

### 2.10.2. TRENDET E NDËRTIMIT, ÇMIMET MESATARE TË NDËRTESAVE PËR BANIM, PRONËSIA DHE SHFRYTËZIMI

Sipas kërkesave për leje, trendi është mesatar. Në vitin 2018 ka rënie, 22-23 ndërtesa kanë aplikuar, prej tyre 18 janë aprovuar. Taksa e densitetit nuk është aplikuar ende në komunën e Gllogocit.

Çmimi i tokës në qytet është mjaft i lartë, në periferi sillet rreth 10.000€/ari, në qendër prej 56.000-100.000/ari. Çmimi i tokës për banim në fshatra është shume i ulët dhe sillet 30-100€/ari, për shkak se trendi i kërkesës për banim në fshat është negativ. Çmimi mesatar i ndërtesave për banim sillet rreth 500/m², për lokale 1000-1200m². Në fshat taksa për leje të ndërtimit të objekteve është vlerë paushall prej 100€, pa marrë parasysh sipërfaqen.

| Numri i ndërtesave te banimit kolektiv sipas kategorive pronësore | | |
|---|---|---|
| Private | Publike | Private- Publike |
| 17 | 8 | 6 |




Grafiku 8. Viti i ndërtimit të ndërtesave në bashkëpronësi

[46] Burimi: Drejtoria e Urbanizmit, Gllogoc dhe ASK

**Pronësia e fondit të banimit -** Me shume se 90% e banesave janë private, ndërsa ndërtesa me banim social janë 2 objekte. Sa i përket ndërtesave të banimit në bashkëpronësi, një pjesë e tyre janë të ndërtuara në vitet e mëhershme dhe disa pas luftës që janë me koncesion në mes të kompanive ndërtimore dhe Komunës. Në Poklek gjenden ndërtesat shumë-banesore të ndërtuara në tokë komunale, me investim 50% komuna-50% investitorët privat, por kualiteti i ndërtimi është shumë i ulët, prandaj konsiderohet ndërtim i dështuar. Lagjja ka qene e planifikuar edhe me objekte te infrastrukturës shkollore, të cilat nuk janë ndërtuar.

**Shfrytëzimi i kapaciteteve të banimit**: Raporti në mes të banesave të pabanuara dhe atyre të banuara është 22,9%, apo 3386 nga 14734 sosh (sipas databazës së krijuar nga NIRAS për GIZ). Sipas ASK[47], numri i njësive të banuara në territorin komunal është 9030, ndërsa i atyre të pabanuara 2.975. Sa i përket shtrirjes hapësinore, dominojnë njësitë e pabanuara në territorin rural (2.607), në krahasim me atë urban (368). Mesatarja e sipërfaqes së shfrytëzuar (për kokë banori) në vitin 2011 në Gllogoc ka qenë 12,9m², në nivel të Kosovës kjo mesatare është 13,39m². Kërkesa për banim janë kryesisht te çifteve te reja, familjet nga diaspora për fëmijët e vet apo prej fshatit ne qytet. Ka nevoje për banim ne zonën urbane, kryesisht për objekte me dendësi te madhe (ndërtesa ne bashkëpronësi).

**Banimi Social -** Janë gjithsej 169 kërkesa të familjeve për zgjidhjen e çështjes së banimit. Numri i përgjithshëm i aplikantëve për kanë kërkuar strehim, ndërtim të shtëpive, kulme, material ndërtimor, etj. gjatë 5 viteve te fundit ka qenë 309. Të dhënat për nevojat për strehim për grupe të veçanta (të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, personat e riatdhesuar) mungojnë. Në komunë gjenden 2 ndërtesa të banimit social. Në afërsi të madhe me kompleksin e Ferronikelit, gjenden barakat në pronësi të Ferronikelit ku janë vendosur rreth 22 familje, të cilat janë në skemën me asistencë sociale. Jo të gjitha familjet janë nga Komuna e Gllogocit.

**Ndërtesat ilegale të banimit -** Ka mjaft shtëpi te cilat janë ndërtuar pa leje ne toke te parcelizuar të klasit të 1-4 pa infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe në tokën nën ujitje.

**VLERËSIMI I GJENDJES**

| | *POZITIVE* | *NEGATIVE* |
|---|---|---|
| *TË BRENDSHME* | *Përparësitë*/Banimi<br>▪ 10.5% të banorëve jetojnë në qytet në raport me 89.5% në zonë rurale<br>▪ Fondi i banimit i ri, kryesisht të ndërtuar në 20-30 vitet e fundit<br>▪ Fond i mjaftueshëm i banesave për akomodim te kërkesave për banim<br>▪ Fondi banesor kualitativ dhe kryesisht në gjendje të mirë<br>▪ Administrimi i ri i banimi social (Programi i banimit social në hartim e sipër) | *Mangësitë*/Banimi<br>▪ Mungesa e politikave të banimit<br>▪ Mungesa e izolimit te banesave te banimit<br>▪ Lagje gati të tëra të braktisura në vendbanimet rurale<br>▪ Mungesa e ngrohjes qendrore<br>▪ Fondi i pamjaftueshëm i njësive të banimit për shtresat e cenueshme të shoqërisë<br>▪ Njësitë e pashfrytëzuara të banimit |

[47] Banesat dhe Ndërtesat, sipas komunave, 2013

DRAFT

| | *Mundësitë*/Banimi | *Rreziqet*/Banimi |
|---|---|---|
| *TË JASHTME* | ▪ Shfrytëzimi i banimit të braktisur (dhe atyre në shfrytëzim) për akomodim te turizmit malor në Qyqavicë, Vasilevë,..<br>▪ Vendosja e ngrohjes qendrore përmes kogjenerimit me Feronikelin<br>▪ Kërkesa për banesa që vijnë nga remitencat e diasporës<br>▪ Hartimi i politikave të banimit<br>▪ Instalimi i masave të energjisë efiçiente në fondin ekzistues banesor si dhe në projektimet e ardhshme<br>▪ Implementimi i programit 3 vjeçar të banimit | ▪ Migrimi i banorëve në qytetet tjera (Prishtinë, Fushë Kosovë)<br>▪ Migrimi i brendshëm nga fshatrat në zonën urbane |

**SFIDAT KYÇE**

Banimi

- Kontrolli i mangët i ndërtimeve të shtëpive në fshatra
- Kufizimi i zgjerimit te vendbanimeve dhe dendësimi adekuat

**NEVOJAT DHE KËRKESAT PËR TË ARDHMEN**

- Hartimi i strategjisë së banimit (jo vetëm atij social)
- Rritja e dendësisë së banimit në zonën urbane për të akomoduar kërkesat për banim
- Rregullimi dhe trajtimi sipas ligjit të legalizimit i shtëpive të banimit që janë ndërtuar pa leje në tokë te parcelizuar te klasit të I-IV pa infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit, për shkak te kushteve sanitare.
- Shfrytëzimi i një pjese të fondit të banimit të braktisur për akomodim të rasteve sociale me një qira të përballueshme deri në zgjidhje më afatgjate
- Shfrytëzimi i banimit të braktisur (dhe atyre në shfrytëzim) për akomodim të turizmit malor në Qyqavicë, Vasilevë,..
- Ofrimi i ngrohjes qendrore për banim përmes ko-gjenerimit me Feronikelin apo KEK-un
- Rritja e efiçiencës së energjisë në ndërtesat ekzistuese të banimit si dhe stimulimi i aplikimit të masave efiçientë në ndërtesat e reja përmes ofrimit të lehtësirave gjatë pajisjes me leje ndërtimore apo pagesës së tatimit

## 2.11. VLERËSIMI I KAPACITETEVE KOMUNALE

### 2.11.1. KAPACITET ADMINISTRATIVE -

**Punësimi -** Në kuadër të administratës komunale në Komunën e Gllogocit raportohet që gjatë vitit 2018 janë gjithsej 126 të punësuar. Në periudhën e fundit, gjatë viteve 2012-2017, numri i të punësuarve në këtë komunë ka mbetur pothuajse i pandryshuar. Ky numër ka qenë rreth 130 të punësuar.

Drejtoritë me më së shumti të punësuar janë: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (33 të punësuar), pasuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa (12 të punësuar) dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe ajo e Bujqësisë, secila me nga 11 të punësuar.

**Kualifikimet -** Mbi 60% të të punësuarve, apo 78 nga ta janë me nivel terciar ekuivalent me bachelor (SNKA 5/6 Niveli A) . Poashtu mbi 50% e të punësuarve në administratën komunale janë me përvojë pune mbi 20 vjeçare.

DRAFT

### 2.11.2. KAPACITETET FINANCIARE

**Buxheti komunal -** Në bazë të analizës së buxhetit të komunës për vitet 2011- 2018, vërehet një rritje e vazhdueshme e buxhetit, i cili në vitin 2018, arrin vlerën prej 14,477, 299 €. Krahasuar me vitin 2013, buxheti për vitin 2018 ka shënuar ngritje prej rreth 50%. Sa i përket strukturës së të hyrave, pjesa më e madhe e buxhetit komunal realizohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Gjatë periudhës 2011-2018, rreth 90% e buxhetit komunal është realizuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) dhe pjesa tjetër nga të Hyrat Vetanake të Komunës dhe burimet tjera të financimit.

Transferet Qeveritare përbëhen nga: a) Granti i Përgjithshëm Qeveritar, b) Granti për Arsim dhe c) Granti për Shëndetësi. Kjo përqindje ka shënuar oscilime të vogla gjatë këtij 5 vjeçari. Pjesëmarrjen më të madhe në transferet qeveritare e kanë grantet specifike për arsim. Edhe pse ato kanë shënuar oscilime të vogla, megjithatë kane mbetur si burim kryesor i të hyrave buxhetore. Kategoritë e tjera te transfereve qeveritare kanë shënuar pjesëmarrje pak a shumë të njejtë gjatë tërë periudhës 5 vjeçare.

| **Kategoria ekonomike:** | **Buxheti i planifikuar- viti:** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **2011** | **2012** | **2013** | **2018** |
| Rroga dhe paga: | 5,830,761.00 | 5,978,136.00 | 6,054,025.00 | 8,230,027.00 |
| Mallera dhe sherbime: | 772,943 | 796,979 | 800,792 | 1,482,000.00 |
| Shpenzime komunale: | 150,433 | 144,104 | 155,291 | 157,860 |
| Subvencione dhe transfere: | 139,891 | 127,774 | 182,000 | 212,063 |
| Shpenzime kapitale: | 2,946,811.00 | 2,373,508.00 | 2,424,499.00 | 4,395,349.00 |
| Gjithsej: | **9,840,839.00** | **9,420,501.00** | **9,616,607.00** | **14,477,299.00** |

Tabela 28. Pasqyra dhe trendet e planifikimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2011- 2018[48]

**Të hyrat Vetanake (THV) -** Është e rëndësishme që të hyrat e grumbulluara nga komunat të rikthehen tek qytetarët në formën më të mirë të mundshme të ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe më cilësore, pra të ju dëshmohet qytetarëve se menaxhimi i mjeteve të tyre financiare është transparent dhe që përdoret për shërbime afër tyre. Komunat i mbledhin të hyrat vetanake në dy forma: si të hyra të mbledhura drejtpërdrejt nga komuna si aktivitet i komunës dhe si të hyrat e arkëtuara nga niveli qendror (në tekstin e mëtejmë, të hyrat indirekte) të cilat transferohen në komuna si pjesë përbërëse e të hyrave vetanake. Të hyrat vetanake direkte të buxhetit të komunës krijohen nga tatimi në pronë, taksat komunale, ngarkesat komunale dhe të hyrat e tjera.




Grafiku 9. Të hyrat vetanake komunale, 2011-2017, Burimi: Komuna e Gllogocit

Ndërsa, të hyrat indirekte janë të hyrat që arkëtojnë institucionet e nivelit qendror për shërbimet e kryera në territorin e komunave. Të hyrat të cilat arkëtohen nga niveli qendror si të hyra nga gjobat e policisë, të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe të hyrat nga prerja e pyjeve barten në komuna varësisht në territorin e së cilës komunë janë arkëtuar, dhe përmes procesit të transferimit shpërndahen në komuna për shfrytëzim të

[48] Burimi: Komuna e Gllogocit, 2018

mëtejmë. Në këtë drejtim, të hyrat vetanake të komunës se Gllogocit  kanë shënuar rritje të vazhdueshme nga viti 2011. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje prej afro 50% nga viti 2011, që tregon për një punë të mirë të organeve komunale në arkëtimin e taksave dhe ngarkesave komunale, në veçanti të Tatimit në Pronë, i cili  edhe e ka shënuar rritjen më të madhe krahasuar me elementet e tjera të të hyrave vetanake. Tatimi në pronë konsiderohet si një e hyrë shumë e rëndësishme dhe një ndër kategoritë më të qëndrueshme të të hyrave komunale. Grafiku më poshtë prezanton trendin e të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore.




Grafiku 10. Trendet e të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore, 2011-2017, Burimi: Komuna e Gllogocit, 2018

**Shpenzimet -** Mbi 70% e  buxhetit të komunës është i orientuar drejt shpenzimeve rrjedhëse (operative), ndërsa shpenzimet kapitale përbëjnë rreth 27 % të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore. Kjo strukturë e shpenzimit të buxhetit nuk ka ndryshuar shumë ndër vite.




Grafiku 11. Struktura e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik 2018[49]

Të dhënat mbi shpenzimet dëshmojnë se mbi 60% e buxhetit shpenzohet në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe Mëditje". Pjesa dërmuese e kësaj kategorie të shpenzimeve dedikohet për të punësuarit në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Investimet kapitale përbëjnë kategorinë e dytë kryesore të shpenzimeve gjatë kësaj periudhe (duke i përfshirë edhe investimet nga donatorët dhe pranimet tjera) me 27%. Shpenzimet tjera gjatë kësaj periudhe janë Mallra dhe Shërbime me 7,7%, shpenzime komunale me 0,6%, transfere dhe subvencione me 1,4%.

| **Kategoria ekonomike:** | **Buxheti i shpenzuar- viti:** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2011 | 2012 | 2013 | 2017 |
| Rroga dhe paga: | 6,820,190.00 | 6,015,000.00 | 6,040,190.00 | 7,762,216 |
| Mallëra dhe shërbime: | 767,640 | 795,000 | 848,580 | 966,196 |

[49] Burimi: Komuna e Gllogocit, 2018)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzime komunale: | 149,640 | 172,000 | 145,180 | 205,586 |
| Subvencione dhe transfere: | 118,950 | 170,000 | 181,340 | 171,767 |
| Shpenzime kapitale: | 2,722,660.00 | 2,773,000.00 | 2,454,330.00 | 3,377,939 |
| **Gjithsej:** | **10,579,080.00** | **9,925,000.00** | **9,669,620.00** | **12,483,704** |

Tabela 29. Pasqyra dhe trendet e shpenzimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2011- 2017

**Investimet kapitale**

Krahas rritjes së përgjithshme të buxhetit, edhe investimet kapitale gjatë periudhës 2011-2017 janë karakterizuar me rritje. Mirëpo në përgjithësi përgjatë këtyre viteve pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme komunale ka mbetur pothuajse e njëjtë me rreth 25-27%. Kjo kategori e shpenzimeve paraqet investimet kapitale të qeverisjes komunale në projekte të ndryshme në infrastrukturë (rrugët, ndriçimi), ndërtesa, mjedis, arsim (ndërtimi i shkollave, pajisjet e reja për shkollat dhe laboratorët), shëndet (spitalet, pajisjet shëndetësore) etj. Sa i përket strukturës së investimeve gjatë periudhës 2012-2015, pjesa më e madhe, përkatësisht 72% e investimeve është ndarë për infrastrukturë të transportit, 21% për infrastrukturë teknike, dhe 7% për infrastrukturë sociale dhe publike.

| Sektori: | Shpenzime kapitale- viti: | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **2011** | **2012** | **2013** | **2017** |
| Infrastrukture sociale dhe publike: | 253,954 | 142,009 | 278,782 | 229,000 |
| Infrastrukture transportuese: | 1,823,128 | 2,083,937 | 1,960,083 | 2,438,000 |
| Infrastrukture teknike: | 645,577 | 546,833 | 215,474 | 711,000 |
| Gjithsej: | **2,722,659** | **2,772,779** | **2,454,339** | **3,378,000** |

Tabela 30. Pasqyra dhe trendet e shpenzimeve kapitale sipas sektorëve, 2011- 2017[50]

**Korniza afatmesme buxhetore komunale -** Në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2019/01 të lëshuar nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Komuna e Gllogocit ka hartuar Kornizën afatmesme buxhetore komunale. Korniza afatmesme buxhetore komunale përcakton sektorët prioritarë të zhvillimit të komunës në tri vitet e ardhshme, si dhe ofron projeksionet lidhur me mënyrën në të cilën buxheti i komunës do të bëjë përmbushjen apo përkrahjen e prioriteteve, si dhe parashikimet rreth performacës ekonomike të komunës. Në bazë të planifikimeve, të hyrat buxhetore për Komunën do të shënojnë rritje graduale. Rritja do të jetë mesatarisht prej 4,8% në krahasim me vitin 2018.

Edhe ne parashikimet për tre vitet e ardhshme vërehet se buxheti nuk do të pësoj; ndryshime të theksuara në strukturën e tij . Vlen të ceket , që krahas rritjes se tërësishme te buxhetit të komunës, shpenzimet kapitale gjatë kësaj periudhe tre vjeçare do të shënojnë ngritje të pjesëmarrjes në strukturën e tërësishme të buxhetit nga 29% sa planifikohen në vitin 2019 në 33% në vitin 2021.

| **Kategoria ekonomike:** | **Projeksioni** | | |
|---|---|---|---|
| | 2019 | 2020 | 2021 |
| Rroga dhe paga: | 8,709,511 | 8,753,059 | 8,797,827 |
| Mallëra dhe shërbime: | 1,452,020 | 1,458,950 | 1,445,155 |
| Shpenzime komunale: | 189,113 | 173,000 | 175,900 |
| Subvencione dhe transfere: | 381,347 | 391,347 | 411,347 |

50 Burimi: Komuna e Gllogocit, 2018

DRAFT

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shpenzime kapitale: | 4,439,612 | 4,880,799 | 5,368,582 |
| Gjithsej: | 15,171,603 | 15,657,155 | 16,198,811 |

Tabela 31. Projeksioni i Buxhetit Total të Komunës në vite sipas kategorisë së shpenzimeve, shprehur në €[51]

Ndërsa analizuar nga aspekti sektorial, ngjashëm me vitet e kaluara Sektori i Arsimit do të ketë pjesëmarrjen më të theksuar në buxhetin e komunës.

| Të hyrat sipas sektorëve | Aktuali | Projeksioni | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
| Sektori i Administratës | 5,750,213 | 6,640,566 | 7,160,797 | 7,576,357 |
| Sektori i Arsimit | 6,916,016 | 6,602,633 | 6,618,631 | 6,650,541 |
| Sektori i Shëndetësisë | 1,811,070 | 1,928,404 | 1,877,727 | 1,971,913 |
| **Gjithsej të hyrat:** | **14,477,299** | **15,171,603** | **15,657,155** | **16,198,811** |

Tabela 32. Buxheti Total i Komunës në vite sipas sektorëve, shprehur në €[52]

Nga ana tjetër është vlerësuar për mundësi të rritjes së vazhdueshme në arkëtimin e të hyrave vetanake në veçanti të tatimit në pronë. Vlerësimi i arkëtimit të hyrave nga burimet vetanake, është bazuar në fushat kryesore të të hyrave si:

- Tatimi në pronë dhe taksa e legalizimit. Trajtimi i ndërtimeve pa leje sipas ligjit përkatës në fuqi, do të mundësojë të hyra nga taksat e legalizimit dhe zgjerimin e bazës së tatimit në prone. Gjithashtu me fillim të aplikimit të Ligjit të Ri për Tatimin në Pronë, parashihet edhe mbledhja e tatimit në tokë, që paraqet burim shtesë I të hyrave nga tatimi në pronë. Azhurnimi i bazës së të dhënave pronësore dhe kadastrale, duke përfshirë edhe shfrytëzimin aktual, do ta mbështeste përmirësimin e të hyrave nga tatimi në pronë.
- Të hyrat nga pasuria. Të avancojë tutje procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e pasurisë.
- Gjobat dhe ndëshkimet e ndryshme.
- Participimet e qytetareve së bashku me të hyrat e mundshme nga donatorët. Rritje e bashkëpunimit me qytetarë në ngjarje të ndryshme / lëshimi I pronës publike për shfrytëzim me qira nga qytetarët, rritje e bashkëpunimit me donatorët.

Bazuar në këto parashikime, shkalla mesatare e mbledhjes së të hyrave vetanake, gjatë tre viteve te ardhshme planifikohet të rritet për 6,5 %, ndërsa për vitin 2019 për 12,5 % krahasuar me vitin 2018. Grafiku më poshtë paraqet trendin e parashikimit të hyrave vetanake komunale.




Grafiku 12 Trendi i parashikimit të hyrave vetanake komunale[53]

[51] Burimi: KAB 2019-2021
[52] Burimi: KAB 2019-2021
[53] Burimi: KAB Gllogoc 2019-2021

## 2.12. VLERËSIMI I KAPACITETET INVESTUESE

Siç u përshkrua lartë, sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2019-2021, parashihet që buxheti vjetor i Komunës të jetë rreth 15,000,000 €/vit. Struktura e parashikuar e shpenzimeve nuk parasheh ndryshim të pjesëmarrjes së pagave dhe mëditjeve (54%), ndërkaq parashihet një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së investimeve kapitale (33%), deri në vitin 2021.

Një strukturë e tillë e buxhetit, dëshmon që edhe më tej Komuna e Gllogocit do të mbetet kryesisht në nivel të plotësimit të nevojave elementare, atë të mbulimit të pagave për punonjësit e sektorit publik në nivel komunal (administratë, shëndetësi, arsim) dhe të mbulimit deri në një masë të nevojave sociale dhe infrastrukturës teknike. Bazuar në këtë nivel, është vështirë e pritshme, që përmes buxhetit komunal të ndikohet në mënyrë të theksuar në rritje të punësimit dhe zhvillim komunal të qëndrueshëm.

Nga ana tjetër varshmëria e theksuar nga grantet qendrore qeveritare, dëshmon për një pozitë të vështirë të qëndrueshmërisë financiare të Komunës. Ashtu siç u përshkrua më lartë mbi 90% të burimeve të hyrave komunale vijnë nga niveli qendror. Komuna duhet të punoj; edhe më tutje në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve për rritje të arkëtimit të hyrave vetanake të komunës, me theks të veçantë të Tatimit në Pronë.

Aktualisht, kapaciteti investiv i Komunës së Gllogocit, mbetet i kufizuar në nivel të shpenzimeve kapitale të aprovuara me KAB 2019-2021, vlera e të cilave për tre vitet e ardhshme planifikohet të jete rreth **14,700,000 EUR**. Nga kjo vlerë e investimeve kapitale, mbi 80% e tyre do të shpenzohen drejt tri sektorëve kryesor: infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi. Krahas kësaj vlere, Komuna e Gllogocit është duke e zhvilluar edhe një projekt kapital në bashkëfinancim me MKRS, atë të ndërtimit të stadiumit, në vlerë të financimit prej 1,500,000 nga MKRS.

Projektet kapitale në kuadër të secilit sektor janë identifikuar bazuar në nevojat prioritare të banorëve të komunës. Këto projekte kryesisht janë të orientuara në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, (asfaltim i rrugëve rurale, rregullim i shtratit të lumenjve, përmirësimi I kanalizimi të ujërave të zeza dhe atmosferike); përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore (renovim dhe ndërtim të QKMF-ve, blerje të inventarit dhe autoambulanca familjare); përmirësim të infrastrukturës shkollore (renovim i shkollave, përmirësim i rrjetit të ujësjellësit në shkolla, pajisje e sallave sportive me inventar).

| Departamentet | Vitet 2019-2021 |
|---|---|
| Totali i shpenzimeve kapitale D. Infrastrukture | 9,200,000 |
| Totali i shpenzimeve kapitale D. Arsim | 1,653,505 |
| Totali i shpenzimeve kapitale D. Shëndetësi | 1,160,082 |

Tabela 33. Ndarja e shpenzimeve kapitale, 2019-2021[54]

Për shkak të kufizimit të mundësive të financimit, mbetet kyç identifikimi dhe vlerësimi i potencialeve komunale në funksion të nxitjes së partneriteteve publiko-private, duke përfshirë edhe asetet komunale (prona, infrastrukturë, shërbime), si dhe mbështetjes me kornizë rregullative lokale dhe procedura administrative.

Shtimi i vlerës së tokave në pronësi komunale dhe futja e tyre në shfrytëzim përmes identifikimit dhe vlerësimit të potencialeve, planifikimit të shfrytëzimit adekuat, furnizimit me infrastrukturën, është një tjetër mundësi për shtim të resurseve financiare të komunës.

[54] Burimi: KAB Gllogoc, 2019-2021

# 3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

## 3.1. VIZIONI

*"Të gjitha rrugët kalojnë nëpër Gllogoc".*
*Në zemër të Kosovës, Gllogoci me ekonomi të bazuar në zhvillim të qëndrueshëm rural, përkrahje të bizneseve, industrisë dhe infrastrukturës funksionale.*
*Banim e shërbime cilësore, ku qytetari është në qendër të vëmendjes e rinia e aftësuar profesionalisht;*
*Mjedis të qëndrueshëm e shfrytëzim racional të resurseve natyrore, promovim të trashëgimisë kulturore, turizmit e sportit.*

## 3.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

### 3.2.1.ZHVILLIMI EKONOMIK

**Qëllimi 1: Nxitja e zhvillimit të bujqësisë**

Objektiva 1.1. Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore

Objektiva 1.2. Krijimi i kuadrit profesional në fushën e bujqësisë

Objektiva 1.3. Rritja e fondit blegtoral për 30% për 8 vite

Objektiva 1.4. Rritja e sipërfaqeve të Pemishteve, Perimeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, 50% për 8 vite

**Qëllimi 2: Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM)**

Objektiva 2.1. Rritja e bizneseve prodhuesve për 6% në çdo vit

**Qëllimi 3: Ngritja e kualitetit te veprimtarive shërbyese**

Objektiva 3.1. Aftësimi i fuqisë punëtore në sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese

**Qëllimi 4: Nxitja e zhvillimit të turizmit rural**

Objektiva 4.1. Zhvillimi i kapaciteteve pritëse/akomoduese në fshatra, së paku 10 pika akomodimi në 5 vitet e para të zbatimit të planit

Objektiva 4.2. Përgatitja e pakove turistike (së paku 3 pako për 5 vite)

### 3.2.2.INFRASTRUKTURA TEKNIKE

**Energjetika**

**Qëllimi 1: Rritja e kapaciteteve për furnizim të qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtritshme.**

Objektiva 1.1. Ndërrimi i rrjetit shpërndarës (0.4 KË) nga përçuesit ajror në atë kabllore, në të gjitha vendbanimet e komunës në 5 vitet e ardhshme

Objektiva 1.2. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme deri në 5%, ne 8 vitet e ardhshme

Objektiva 1.3. Sigurimi i sistemit të ngrohjes qendrore

**Ujësjellësi, Kanalizimi dhe Ujitja**

**Qëllimi 2: Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) si dhe ujitjes**

Objektiva 2.1. Rritja e kapaciteteve të ujit në 50 l/s (33% e ekonomive familjare) në 10 vitet e ardhshme

Objektiva 2.2. Hulumtimi i burimeve alternative nëntokësore dhe funksionalizimi i burimeve ekzistuese (Krajkovë, Koreticë e Epërme dhe Vërbovc)

Objektiva 2.3. Trajtimi i ujërave të zeza për 50% të territorit në 5 vitet e ardhshme

Objektiva 2.4. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në të gjitha lagjet në të cilat konfiguracioni i terrenit e lejon

DRAFT

Objektiva 2.5. Futja nën menaxhim të tërë sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit funksional

**Mbeturinat**

**Qëllimi 3: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës**

Objektiva 3.1. Ngritja e kapaciteteve teknike të kompanisë operuese publike në 3 vitet e ardhshme

**Transport**

**Qëllimi 4: Sigurimi i transportit të integruar për komunën e Gllogocit**

Objektiva 4.1. Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në transport publik urban dhe periferik brenda vitit

Objektiva 4.2. Rritja e sigurisë në trafikun rrugor dhe hekurudhor, 10% ulje të aksidenteve në komunikacion brenda vitit

Objektiva 4.3. Minimizimi i ndikimeve negative nga transporti i ngarkesave të Feronikëlit brenda 3 viteve

### 3.2.3.INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

**Arsimi**

**Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë**

Objektiva 1.1. i infrastrukturës edukative/trajnuese dhe plotësimi shkollave me pajisje të TI, hapësira sportive (deri në vitin 2025)

**Shëndetësia**

**Qëllimi 2: Ofrimi I shërbimeve cilësore të shëndetësisë me zhvillim të vazhdueshëm profesional**

Objektiva 2.1. Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi përmes ofrimit të infrastrukturës së objekteve shëndetësore deri në 2022

Objektiva 2.2. Rregullimi i infrastrukturës për mirëqenia sociale

**Infrastruktura sociale - Kultura, Sporti, Hapësirat Publike dhe Hapësirat e Gjelbra**

**Qëllimi 3: Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit, dhe rritja e hapësirave publike dhe të gjelbra**

Objektiva 3.1. Ofrimi i qendrave kulturore multifunksionale ne 5 nën qendrat e komunës (deri ne 2025)

Objektiva 3.2. Shtimi i hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra, duke përfshirë shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë

Objektiva 3.3. Fuqizimi i sportit dhe rekreacionit përmes ofrimit të hapësirave sportive (të mbyllura dhe të hapura) deri ne vitin 2030

### 3.2.4.MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIK

**Qëllimi 1: Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë**

Objektiva 1.1. Krijimi i mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm të kualitetit të ajrit për gjithë territorin e komunës (mekanizmat matës të jenë aktivë më së largu nga fillimi i vitit 2021)

Objektiva 1.2. Monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të resurseve natyrore deri në vitin 2025

Objektiva 1.3 Pyllëzimi si masë anti-ndotëse deri në vitin 2027

**Qëllimi 2. Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv**

Objektiva 2.1. Përmirësimi i kualitetit të ujërave të rrjedhshëm, për 40% deri në vitin 2022

Objektiva 2.2. Pastrimi dhe rigjenerimi i të gjitha deponive ilegale deri në vitin 2021

Objektiva 2.3 Pyllëzimi dhe ripyllëzimi si masë antierozive deri në vitin 2027

DRAFT

Objektiva 2.4 Pastrimi dhe rikultivimi i zonave të degraduara nga veprimtaritë eksploatuese të drurit dhe gurëve apo nxjerrja e zhavorrit

**Qëllimi 3. Sigurimi i një mjedisi më të sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë**

Objektiva 3.1. Zvogëlimi i ndikimeve nga vërshimet e lumit Drenica, deri në vitin 2025

**Qëllimi 4: Krijimi i qasjes së integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore**

Objektiva 4.1. Konzervimi dhe mbrojtja e vlerave të TK dhe TN (asetet që kanë status të mbrojtur dhe ato të propozuara) në funksion të zhvillimit të turizmit, deri në vitin 2024

Objektiva 4.2. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve përmes programeve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, deri në vitin 2023

### 3.2.5.VENDBANIMET

**Qëllimi 1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës**

Objektiva 1.1. Përmirësimi i performansës së Drejtorisë së Inspeksionit

Objektiva 1.2. Parandalimi i ndërtimeve pa leje

**Qëllimi 2: Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime**

Objektiva 2.1. Ofrimi I shërbimeve dite në javë (administratë, kulturë etj.) në të gjitha nën-qendrat, aktive nga viti 2022

Objektiva 2.2. Rregullimi infrastrukturës në 3 VBJ , brenda 5 viteve

Objektiva 2.3. Rregullimi i çështjeve pronësore

### 3.2.6.BANIMI

**Qëllimi 1: Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues të banimit**

Objektiva 1.1. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale për menaxhim në fushën e banimit, së paku 5 profesionist komunal të trajnuar

Objektiva 1.2. Evidentimi dhe futja ne shfrytëzim e 80% të kapaciteteve të pashfrytëzuara të banimit deri në 2025

Objektiva 1.3. Rritja e efiçiencës energjetike 50% në objektet e banimit në të gjithë komunën, kompletimi deri në vitin 2030

**Qëllimi 2: Plotësimi i nevojave për banim**

Objektiva 2.1. Sigurimi i banimit adekuat për 10% të familjeve në nevojë deri në vitin 2022

Objektiva 2.2. Rritja e fondit të banimit të përballueshëm për 50% deri ne vitin 2022

DRAFT

### 3.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Bazuar në qëllimet dhe objektivat e përcaktuara nga EKP, EKK dhe palët e ndryshme të përfshira në hartimin e PZHK-së, si dhe duke marrë parasysh sfidat dhe kërkesat për të ardhmen, është bërë hartimi i koncepti i zhvillimit hapësinor të komunës së Gllogocit.

#### 3.3.1.SKENARËT E PROPOZUAR

## SKENARI I TRENDIT / SKENARI ZERO: Qytet i metalurgjisë dhe bujqësisë kuantitative

'Skenari i Trendit' apo siç emërtohet ndryshe si 'Skenari Zero', paraqet të ardhmen që parashihet në rast që vendoset të ndiqet ritmi i njëjtë i planifikimit të zhvillimeve. Pra, nëse vendoset që në tërësi të vazhdohet me qeverisjen e deritanishme të hapësirës së ndërtuar atëherë do te plotësonim pritjet nga 'Skenari i Trendit'.

Ky skenar, edhe pse mundëson densifikim modest të zhvillimeve si dhe disa projekte te rëndësishme të infrastrukturës, ndërtimet do të vazhdojnë të zhvillohen të shpërndara në tërë territorin komunal. Kështu që zhvillimet do t'i prijnë planifikimit, përderisa duhet të jetë e kundërta, pra planifikimi i duhur duhet të udhëheq zhvillimet!

Ndërtimet jashtë zonës se ndërtimit të shpërndara në të gjithë hapësirën komunale duke krijuar presion të madh në infrastrukturën teknike dhe financat publike. Aktivitet komerciale vazhdojnë te shpërndahen përgjatë korridoreve të rrugëve kryesore. Ndërsa në vendbanime duke ndjek formësimin e rrugëve. Edhe pse zhvillimet gradualisht largohen nga hapësirat e mbrojtura natyrore dhe kulturore (si p.sh. Kleçkë), ende ka shume pak veprime që ndodhin në dobi të zhvillimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Kompleksi "Ferronikeli" vazhdon të jetë aktiviteti kryesor ekonomik për qytetin dhe ndikimet e lidhura me mjedisin vazhdojnë të monitorohen dhe mbahen nën kontroll, por nuk merren masa specifike lokale për të ulur më tej ndikimin e tij në mjedis.

Bujqësia vazhdon të subvencionohet, por nuk specializohet në cilësi, bio-produkte dhe nuk synon tregjet lokale. Qasja përmes kooperativave nuk merret parasysh siç duhet dhe toka pjellore nuk menaxhohet në mënyrë të koordinuar. Pothuajse të gjitha zhvillimet e reja do të ndodhin në formë te shpërndarë (e jo te fokusuar, si p.sh. me përqendrim në qyet apo nënqendra) dhe pjesa më e madhe e vendeve të reja të punës dhe tregtisë së re shpërndahen, duke kontribuar kështu në dobësimin e qendrës së qytetit dhe jetës së qytetit. Zona nen komasacion do te mbet sfide konstante për zgjerimi i qytetit te Gllogocit, ndërsa ndërlidhja hapësinore ndërmjet Gllogocit dhe Komoranit zhvillohet natyrshëm duke u fuqizuar nga prezenca e aktiviteteve ekonomike dhe objekte banimi. Zhvillimet e shpërndara do te krijojnë shpenzime të mëdha operative për infrastrukturën teknike kur një pjesë më e madhe e ndërtimit të akomodimit privat (shtëpi dhe banesa) zhvillohet në parcela te reja të ndërtimit, rrjedhimisht rriten kërkesat për investime rrugore, rriten nevojat e transportit dhe përdorimi i makinave dhe krijohet një strukturë qyteti që është e kushtueshme për të shërbyer. Lëvizshmëria e banoreve vazhdon te varet kryesisht nga transporti privat me përmirësime te pjesshme ne transport publik. Mjetet e transportit publik nuk modernizohen dhe vazhdojnë te ofrojnë shërbime jocilësore duke motivuar banoret për të përdorur makinën private.

Cilësia e hapësirave publike dhe rrjeti rrugor nuk përmirësohet dhe vazhdon të ketë të njëjtin nivel të standardeve që ka në këtë kohë. Ne përgjithësi këta faktorë nga 'skenari i trendit' nuk kontribuojnë ne zhvillimin e Gllogocit ne harmoni me kërkesat nga deklarata e vizionit si dhe qëllimet dhe objektivat te përcaktuar ne Plan. Ky skenar krijon pak mundësi për ekonomi të qëndrueshme rurale, banim e shërbime cilësore si dhe dështon ta vendos qytetarin në qendër të vëmendjes. Dhe këto mangësi nuk kompensohen nga mundësitë e mira për ndërtim dhe zgjerim qe ofron qasja e pakontrolluar e 'Skenarit te trendit'. Duke pasur parasysh të gjitha këto, vlerësohet qe skenari nuk e ndihmon zhvillimin e Gllogocit. Në anën tjetër, vlen te theksohet qe ky skenar është më i lehtë për t'u zbatuar, kërkon më pak planifikim dhe menaxhim, dhe është më pak kompleks.




**PËRPARËSITË**

Proces relativisht i thjeshte i menaxhimit te zhvillimeve

Ndërtimi i fokusit ne metalurgji dhe bujqësi kuantitative

Kosto e ulet ne afat shkurt

Mundësi për bizneset dhe shërbimet të zhvillohen spontanisht dhe te shtrihen ne te gjitha zonat

Shpërndarja e infrastrukturës baze: teknike dhe sociale përgjatë territorit te komunës

Lidhej te mira rrugore ne mes te fshatrave dhe qytetit Gllogoc

**MANGËSITË**

Rritja e migrimit fshat – qytet Gllogoc, si dhe ne kryeqendër Prishtine

Zgjerimi i mëtejmë i zhvillimeve kryesisht në tokën bujqësore

Shtimi i intensitetit te lëvizjeve motorike kryesisht nga mjetet private dhe rritja e grykave te ngushta ne komunikacion

Stagnimi i mëtejmë i zhvillimit të fshatrave dhe fokusi i zhvillimeve ne Gllogoc dhe Komoran

Kosto e lart ne afat mesëm dhe afat gjate, sidomos nga mirëmbajtja e rrjetit te infrastrukturës teknike

Rënie e cilësisë se shërbimeve

Stagnim i te hyrave komunale

Degradim i mjedisit

**SKENARI 1 – GLLOGOCI KOPSHT I PRISHTINËS**

Ky skenar përfshin rastin kur Feronikeli vazhdon të jetë aset kryesor ekonomik në Gllogoc dhe me ndikim në mjedis. Në këtë rast ndikimi në mjedis vazhdon të monitorohet dhe të mbahet nën kontroll duke aplikuar masa të nevojshme mbrojtëse. Masat e aplikuara zvogëlojnë ndikimin që kanë ndotësit e tokës, ajrit dhe ujit nëntokësor dhe mbitokësor duke mos injoruar trajtimin e ujërave të zeza në Godanc që është zgjidhje e qëndrueshme për zvogëlim e ndotjes së ujërave.

Për më tepër agrikultura vazhdon të jetë e subvencionuar por me përqendrim dhe specializim në cilësi, bio-produkte dhe target tregjet lokale. Me qëllim të shmangies të transportit të mallrave në distanca do të krijohen pikat grumbulluese për prodhime lokale dhe themelohen kooperativat ku mund të shiten e produktet e agrikulturës. Parashihen katër pika grumbulluese ku njëkohësisht mund të shfrytëzohen edhe për tharjen e pemëve: njëra është vendos në segmentin ndërlidhës në mes të Gllogocit dhe Komoranit, e dyta në Arllat, e treta në Gllanasellë dhe e fundit në Tërstenik.  Gllogoci posedon agro industrinë në Vërboc por ajo shërben vetëm për eksport. Ky skenar parasheh në Gllanasellë një agroindustri shtësë që do të jetë i hapur edhe për tregun e brendshëm. Zona nën komasacion do te mbet e mbrojtur nga zhvillimet e mëtutjeshme.

Sa i përket vendbanimeve ato parashihen të jenë kompakte me 2 qendra kryesore Komoranin dhe Gllogocin, nën-qendrat Baicë, Gllanasellë, Tërstenik, Arllat dhe të shmanget shtrirja e pakontrolluar e të gjitha vendbanimeve  brenda territorit të komunës. Investimet duhet të orientohen në përmirësimin e hapësirave publike e sidomos në Gllogoc dhe Komoran. Gjithashtu rrjeti i rrugëve kompletohet dhe mirëmbahet duke u bazuar në norma dhe standarde në fuqi. Duhet të theksohet se skenari parasheh çerdhe në Gllogoc dhe nën-qendra, trajnimet në të gjitha shkollat me vizion të ri për zhvillim si dhe infrastrukturë sociale e cila kompletohet me ndërtimin e qendrës multi-funksionale në Gllogoc.

Mobiliteti apo lëvizshmëria e këmbësorëve, biçikletave dhe mjeteve te motorizuara do të jetë e qëndrueshme me ndikime të ulëta në mjedis. Për të zvogëluar shpenzimet e mobilitetit është propozuar që të përmirësohet lidhja e trenit mes Prishtinës dhe Gllogocit si dhe të bëhet lidhje e re me hekurudhë në mes Gllogocit, Komoranit, stadiumit nacional të ri, zonës ekonomike, pastaj aeroport ndërkombëtar dhe qytet të Prishtinës.

Duke pasur parasysh faktin se Gllogoci ka sfida të furnizojë qytetarët me ujë të pijshëm, ky skenar përveç tre stacioneve ekzistuese të pompimit (te Pishat, Gllobar dhe Zabel i Epërm) parasheh edhe stacionet shtesë në Arllat dhe Abri, ku mbulohet i gjithë territori Gllogocit me ujë të pijshëm.

Për me tepër për adhurues të ecjes në mal ky skenar parasheh turizmin malor në Qyqavicë[55] dhe shtegun panoramik rreth Likoshanit. Ky skenar përfshin valorizimin e aseteve të kulturës dhe të natyrës duke pasur në konsideratë Zonën e Veçantë të Kleqkës dhe Divjakës dhe trajtimit të saj në harmoni me planin e hartuar. Hapësira rreth stadiumit nacional kompletohet me gjithë infrastrukturën e nevojshme që do të përballojë fluksin e shikuesve.

Sa i përket zhvillimit të bizneseve parashikohet rreth rrugës kryesore prej parkut të biznesit deri në Gllogoc, në pjesët ku nuk komasacion.

Mangësia e vetme e këtij skenari është që Feronikeli vazhdon të funksionojë por përparësi është që skenari propozon masa të vazhdueshme për mbrojtjen e mjedisit.

Duke pasur parasysh faktin që ky skenar ka më tepër përparësi si agrikultura e subvencionuar, themelimin e korporatave, vendbanime më kompakte, përmirësimi i hapësirave publike, fuqizimi i sportit dhe kulturës, lëvizshmëri më të qëndrueshme etj. në krahasim me skenarin zero atëherë është skenar favorit i zhvillimit te

[55] Për më tepër referojuni Memorandumit të Mirëkuptimit me nr. 01-332-41395, me Komunën e Mitrovicës, Skepderajt, Vushtrisë dhe Obiliqit në lidhje me shpalljen e Bjeshkës të Qyqavicës zonë me interes të përgjithshëm.

ardhshëm të Gllogocit. Për më tepër ky skenar promovon qasje te integruar në mes të sektorëve të zhvillimit, infrastrukturë funksionale si dhe mjedis të qëndrueshëm dhe ndërlidhet ngushtë me deklaratën e Vizionit si dhe objektivat e qëllimet e Planit.




| PËRPARËSITË | MANGËSITË |
|---|---|
| Masa adekuate për mbrojtjen e mjedisit (mrojtja nga fatkeqësitë natyrore) | Feronikeli vazhdon të funksionojë dhe të jetë aset i zhvillimit ekonomik |
| Agrikultura e subvencionuar | Proces jo i thjeshtë i menaxhimit të zhvillimeve |
| Themelimin e koorporatave | |
| Vendbanime më kompakte | |
| Përmirësimi i hapësirave publike | |
| Fuqizimi i sportit dhe kulturës | |
| Lëvizshmëri më të qëndrueshme | |
| Konzervimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore | |
| Zhvillimi i turizmit | |

3.3.2.KONCEPTI I ZHVILLIMIT






Harta 33. Zhvillimi hapësinor i planifikuar

### 3.3.3.TËRESITË HAPËSINORE

Karakteristikë identifikuese e komunës se Gllogocit janë tri tërësi hapësinore te cilat dallojnë nga natyra e tyre e zhvillimit mjedisor, morfologjike si dhe shfrytëzimi i tokës. Veçoritë e këtyre tri tërësive njëherit paraqesin edhe potencialin për zhvillim të ardhshëm. Me qëllim të arritjes së Vizionit te komunës, qëllimeve dhe objektivave, potencimi i veçorive dhe pikave te përbashkëta, si dhe funksioni i tërësive hapësinorë është i domosdoshëm. Rrjedhimisht, me poshtë janë shtjelluar tri tërësitë hapësinore, pra tërësia Qendrore-dinamike, tërësia e Maleve dhe Pejsazheve dhe tërësia e Bujqësisë-Fushës.

Vendbanimet do te kenë kufinjtë te ndërtimit dhe nuk do te lejohet banim i përhershëm jashtë kufijve te ndërtimit.

- **Tërësia Qendrore-dinamike** përbëhet nga vendbanimet qendrore, pra polet Gllogoc dhe Komoran te cilat ofrojnë kushte për zhvillim te shërbimeve kyçe dhe biznesit. Polet kyçe Gllogoc dhe Komoran duhet te ofrojnë hapësirë për zhvillimin e shërbimeve në shërbim të tërë banorëve të komunës. Përderisa, decentralizimi i shërbimeve përmes nën qendrave Arllati, Baica, Gllanasella dhe Tërstenik nuk duhet ta zvogëlojë rëndësinë që kanë polet kyçe, por vetëm te shërbejë për ofrim të shërbimeve te përzgjedhura në afërsi te banoreve në vendbanime të ndryshme.

Funksionet kyçe për zhvillim në këtë tërësi hapësinore janë banimi dhe veprimtaritë ekonomike te cilat nuk rrezikojnë mjedisin (si p.sh. bujqësia, pylltaria dhe industria e lehte).

Veprimtaritë ekonomike - pasi qe kjo tërësi hapësinorë konsiderohet të ketë potencialin më të madh për një zhvillim më të hovshëm ekonomik. Në këtë pjesë janë të koncentruar pjesa më e madhe e shërbimeve, infrastrukturës, etj. Zhvillimet e ardhshme duhet të kenë kushte për avancimit të disa prej veprimtarive te shumta ekonomike duke përfshi industrinë, bizneset, shërbimet etj. Për me tutje, duke konsideruara qe kjo tërësi hapësinore përmban një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore, këtu duhet te krijohen edhe kushte për kultivimin e drithërave dhe pemëve e perimeve.

- **Tërësia e Maleve dhe Pejzazheve** që formojnë një unazë mbrojtjeje përgjatë kufirit te komunës dhe paraqet një kompleks kryesisht malor. Shquhet me resurset natyrore të pyjeve, me kullosa dhe motive peizazhi dhe asete turistike të cilën duhet te zhvillohen veprimtaritë ekonomike: pylltari, turizëm, bujqësi dhe blegtori. Veprimtaritë ekonomike të cilat mund të zhvillohen këtu, duhet të jenë në pajtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, që mundëson atë lloj të veprimtarive që është e përkushtuar të ketë ndikim minimal negative në mjedis dhe kulturën lokale, përderisa rritet ndikimi pozitive ne elemente te caktuara dhe njëherit mundëson krijimin e të hyrave dhe vende të punës për komunitetin lokal.

Pylltaria si veprimtari mundëson shfrytëzimin e resurseve për prodhimin e lëndës drunore me kusht qe shfrytëzimi i resurseve pyjore duhet të jetë i qëndrueshëm – duke praktikuar prerje të kontrolluar dhe politika pro-aktive të pyllëzimit. Duhet te stimulohen krijimi i kushteve për prodhimtari të vogla të zdrukthëtarisë dhe prodhimit të biomasës për ngrohje – për shërbim rezidencial, pra prodhim energjie në shkallë të ulet.

Turizmi si veprimtari mundëson shfrytëzimin e tërësisë se pyjeve për aktivitete rekreative dhe stimulojnë turizmin alternativ. Aktivitetet të cilat mund të zhvillohen këtu janë ecja, shëtitja, çiklizmi, alpinizmi, kampimi dhe gjuetia, gjithsesi ne forma te kontrolluara duke pas kujdes te shtuar për ndikimet potenciale negative, sidomos për aktivitetin e gjuetisë.

Bujqësia mjekuese si veprimtari ekonomike mundëson kultivimin e bimëve të ndryshme mjekësore të cilat mund të përdoren në industrinë farmaceutike.

Blegtoria si veprimtari ekonomike mundësohet duke u bazuar ne resursin e livadheve dhe kullosave. Kjo veprimtari duhet te zhvillohet edhe ne afërsi te vendbanimeve rurale. Përkrahja e blegtorisë duhet të fokusohet në rritjen e numrit të bagëtisë dhe më pas edhe rritjen e prodhimtarisë blegtorale duke synuar eko-produkte që do të ishin shumë konkurruese në treg.

**Tërësia e Fushës-Bujqësisë** me situacion të ulët dhe kryesisht e pasur me toke bujqësore kualitative dhe potenciale ujore qe paraqet aset kyç për zhvillim te bujqësisë. Sfidat kyçe ne këtë tërësi hapësinore është mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore pasi qe tërësia e Fushës-Bujqësisë është pjesa më e populluar, me veprimtari ekonomike të bazuara kryesisht në agrikulturë. Kjo pjesë identifikohet me lidhje te mira infrastrukturore me kryeqytetin, me rrugë rajonale, me polet kryesore Gllogoc dhe Komoran si dhe nën-qendrat dhe vendbanimet tjera. Funksionet kyçe për zhvillim në këtë tërësi hapësinore janë bujqësia, industria dhe veprimtari të lehta ekonomike.

### 3.3.4.ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE

**VENDBANIMET**

Faktorët të cilët janë marrë parasysh ne trajtimin e vendbanimeve janë parashikimet demografike, dendësia e popullsisë, hapësirat ekzistuese te ndërtuara dhe ato te pa ndërtuara si dhe prioritet qeverisëse ne zhvillim te tokës bujqësore. Duke i konsideruar këta faktorë, si dhe me qellim te shfrytëzimit sa me racional te tokës, te gjitha vendbanimet ne komune, duhet te kufizohen dhe te dendësohen. Kështu, zhvillimi poli-centrik i vendbanimeve do të behët përmes dendësimit brenda kufijve te vendbanimeve, konsolidimin e infrastrukturës ekzistuese, ri-zhvillimit te hapësirave ekzistuese te ndërtuara si dhe plotësim te hapësirës se pa ndërtuar. Nuk do te lejohet zgjerimi i mëtejmë të vendbanimeve jashtë kufijve te ndërtimit. Koncepti i këtillë i akomodimit te zhvillimit ne vendbanime, pra përmes shfrytëzimit racional te tokës, ndikon thellësisht në zvogëlimin e kostos së infrastrukturës si dhe zvogëlimin e rrezes së shërbimeve themelore brenda vendbanimeve.

Qyteti i Gllogocit do te vazhdojë te jetë qendër kyçe komunale për banim, biznes, aktivitete komerciale dhe industriale. Infrastruktura me e rëndësishme edukative, kulturore, sportive dhe shëndetësore do te përqendrohet ne qytetin e Gllogocit. Fshatrat përreth, fshatrat Çikatovë e Re, Poklek i Ri, Shtrubullovë, duhet te krijojnë lidhje te qëndrueshme me qytetin e Gllogocit dhe furnizim reciprok te infrastrukturës sociale. Kjo ndërlidhje ndërmjet qytetit te Gllogocit dhe fshatrave te afërt duhet te trajtohet me kujdes qe te mos krijohen gryka te ngushta komunikimi, sidomos trajtimi i hapësirës ndërlidhëse me Komoran. Në këtë kuptim, Komorani do të formohet si qendër e re komunale me status të përafërt me qytetin e Gllogocit, duke u plotësuar me infrastrukturë të nevojshme edukative, kulturore, sportive dhe shëndetësore.

Paralelisht, do te vazhdojë zhvillimi dhe përforcimi i 4 nënqendrave ne vendbanimet Arllati, Baicë, Gllanasellë dhe Tërstenik. Këto nën-qendra do te jene te pavarura ne ofrim te shërbimeve, si dhe te kenë mundësinë e akomodimit te aktiviteteve komerciale dhe industri. Gjithashtu, nënqendrat duhet te zhvillojnë më tutje mundësitë e ofrimit të shërbimeve bazë siç janë çerdhet e fëmijëve, shkollim fillor dhe te mesëm, shkolla profesionale, shërbim kulturor, social dhe administrative.

- Fshatrat tjera duhet te ndërlidhen përmes infrastrukturës rrugore dhe teknike ne mënyrë qe te lehtësohet komunikimi me nënqendrat dhe polet kyçe Gllogoc dhe Komoran.




Harta 34. Tërësitë hapësinore

| GJENDJA AKTUALE | | | PROJEKSIONET | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zona kadastrale | Totali i njesive të banimit | Dendesia ekzistuese (njësi banimi/ha) | Numri i banorëve në 2028 | Rritja banorë | Rritja njësi banimi | *Dendesia projektuar (njësi banimi/ha)* | Sipërfaqe e planifikuar për zhvillim (ha) | Dendësia banorë/ha |
| Abri e Epërme | 326 | 8 | 2,294 | 518 | 104 | *15* | 7 | 75 |
| **Arllat** | 727 | 9 | **4,048** | **914** | **183** | ***25*** | **7** | 125 |
| **Baicë** | **513** | **7** | **2,980** | **673** | **135** | ***25*** | **5** | 125 |
| Çikatovë e Re | 591 | 13 | 2,617 | 591 | 118 | 15 | 8 | 75 |
| Çikatovë e Vjetër | 312 | 9 | 1,629 | 368 | 74 | 15 | 5 | 75 |
| Dobroshec | 334 | 8 | 1,882 | 425 | 85 | 15 | 6 | 75 |
| Domanek | 166 | 7 | 912 | 206 | 41 | 15 | 3 | 75 |
| Fushticë e Epërme | 215 | 9 | 1,271 | 287 | 57 | 15 | 4 | 75 |
| Fushticë e Ulët | 209 | 8 | 1,377 | 311 | 62 | 15 | 4 | 75 |
| Gllabar | 431 | 10 | 1,971 | 445 | **89** | *15* | 6 | 75 |
| **Gllanasellë** | 352 | 8 | **2,055** | **464** | **93** | ***25*** | **4** | 125 |
| **Gllogoc** | 1,652 | 14 | **7,935** | **1,792** | **358** | ***40*** | **9** | 200 |
| Godanc | 87 | 4 | 462 | 104 | 21 | *15* | 1 | 75 |
| Gradicë | 201 | 20 | 1,088 | 246 | 49 | *15* | 3 | 75 |
| Kishnarekë | 323 | 9 | 1,943 | 439 | 88 | *15* | 6 | 75 |
| **Komoran** | 1,319 | 12 | **5,675** | **1,282** | **256** | ***40*** | **6** | 200 |
| Korroticë e Epërme | 340 | 8 | 1,602 | 362 | 72 | *15* | 5 | 75 |
| Korroticë e Ulët | 249 | 7 | 1,256 | 284 | 57 | *15* | 4 | 75 |
| Krajkovë | 244 | 7 | 1,526 | 345 | 69 | *15* | 5 | 75 |
| Likoshan | 160 | 9 | 775 | 175 | 35 | *15* | 2 | 75 |
| Llapushnik | 864 | 8 | 4,434 | 1,001 | 200 | *15* | 13 | 75 |
| Negroc | 286 | 8 | 1,989 | 449 | 90 | *15* | 6 | 75 |
| Nekoc | 720 | 10 | 4,028 | 910 | 182 | *15* | 12 | 75 |
| Poklek | 578 | 8 | 2,541 | 574 | 115 | *15* | 8 | 75 |
| Polluzhë | 214 | 6 | 1,314 | 297 | 59 | *15* | 4 | 75 |
| Sankoc | 418 | 11 | 1,856 | 419 | 84 | *15* | 6 | 75 |
| Shtrubullovë | 315 | 10 | 1,423 | 321 | 64 | *15* | 4 | 75 |
| Shtuticë | 166 | 7 | 1,206 | 272 | 54 | *15* | 4 | 75 |
| Tërdec | 221 | 7 | 1,448 | 327 | 65 | *15* | 4 | 75 |
| **Tërstenik** | 862 | 7 | **5,042** | **1,139** | **228** | ***25*** | **9** | 125 |
| Vasilevë | 148 | 8 | 819 | 185 | 37 | *15* | 2 | 75 |
| Vërboc | 247 | 7 | 1,611 | 364 | 73 | *15* | 5 | 75 |
| Vuçak | 82 | 9 | 477 | 108 | 22 | *15* | 1 | 75 |
| Zabel i Epërm | 166 | 9 | 730 | 165 | 33 | *15* | 2 | 75 |
| Zabel i Ulët | 260 | 7 | 1,391 | 314 | 63 | *15* | 4 | 75 |
| **TOTAL** | **14,298** | | **75,606** | **17,075** | **3,415** | | **186** | |

Tabela 34 Llogaritja e dendësisë dhe sipërfaqës së planifikuar për zhvillim

Në krahasim me PZHK-ne 2008-2020+ eshte vlerësuar nevoje per 50ha toke ndërtimi per banim ne qytet, 50ha toke ndërtimi ne nenqendra dhe vendbanime tjera si dhe 30ha toke ndërtimi per banim nga zonat e përziera, përmblidhen ne toal 130ha toke ndërtimi e përcaktuar per plotësim te nevojave te banimit. Sipas

projeksionit ekzistues, toke ndërtimi per banim eshte ndare ne vendbanime specifike dhe me përmbledhjen e saj dalin 186ha hapesire ndërtimi per banim.

Më tutje, klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit në të ardhmen është projektuar si më poshtë:

| | *Funksioni* | | |
|---|---|---|---|
| *Klasifikimi* | *Vendbanim* | | |
| Vendbanim shumë i vogël urban (5,000-10,000 banorë) | Gllogoci | Komorani, Tërstenik | N/A |
| Vendbanime te mëdha rurale (2,500-5,000 banorë) | N/A | Arllati | Llapushnik, Nekoc, Baicë, Çikatovë e Re, Poklek, |
| Vendbanim i mesëm i madh rural (1,000-2,500 banorë) | N/A | Gllanasella | Abri e Epërme, Gllanasellë, Negroc, Gllabar, Kishnarekë, Dobroshec, Sankoc, Çikatovë e Vjetër, Vërboc, Korroticë e Epërme, Krajkovë, Tërdec, Shtrubullovë, Zabel i Ulët, Fushticë e Ulët, Polluzhë, Fushticë e Epërme, Korroticë e Ulët, Shtuticë, Gradicë dhe Godanc |
| Vendbanim i mesëm i vogël rural (500-1,000 banorë) | N/A | N/A | Domanek, Likoshan, Vuçak, Vasilevë Zabel i Epërm |
| Vendbanim i vogël rural (200-500 banorë) | N/A | N/A | Godanc |

Tabela 35. Vendbanimet (funksioni dhe klasifikimi) sipas rritjes së projektuar në 2028

### 3.3.5.SHFRYTËZIMI I PLANIFIKUAR I TOKËS

Me qëllim qe te sigurohet zhvillimi i ardhshëm i komunës, plani duhet te siguroje toke te mjaftueshme ndërtimore për banim, biznese dhe industri. Deri ne vitin 2028, parashihet nevoja për furnizim me 186 ha tokë ndërtimore. Me tutje përcaktohet qe qyteti i Gllogocit te dendësohet, te plotësohen hapësirat e pa zhvilluara brenda kufirit ndërtimor, për derisa zgjerimi ekzistues i ndërtimeve ne toka nen komasacion nuk do te lejohet. Projeksioni i sipërfaqes se nevojshme te tokës për zhvillim te banimit është bazuar ne projeksionin e rritjes demografike duke u ndërlidhur me parametrat e dendësisë ekzistuese ne pole, nën-qendra dhe fshatrat tjera. Duhet te theksohet qe plani rekomandon rritjen e dendësisë përgjatë gjithë hapësirave te banuara, duke i respektuar kufijtë ndërtimor te vendbanimeve përmes plotësimit dhe dendësimit brenda kufijve.

Siç është cekur edhe më parë, synimi i planit është që zhvillimi to kontrollohet në mënyrë të balancuar dhe kompakte, rrjedhimisht është planifikuar edhe rritja e dendësisë ne te gjitha vendbanimet. Sipas parashikimeve për rritje të popullsisë dhe analizës së dendësisë aktuale të banimit (njësi banimi/ha) në zonë urbane dhe rurale, kërkesat për tokë për të akomoduar zhvillimin në 10 vitet e ardhshme për polet urbane Gllogoc dhe Komoran janë 15 ha (duke synuar rritje te dendësisë ne 40 njësi banimi për ha), tek nën-qendrat Arllati, Baicë, Gllanasellë dhe Tërstenik ne total 24 ha (me rritje te dendësisë në 25 njësi banimi për ha), ndërsa ne vendbanimet tjera do te nevojiten ne total 147 ha toke ndërtimore për banim (rritje te dendësisë ne 15 njësi banimi për ha).

Zona urbane e qytetit të Gllogocit që perfshinë zonën e qendres do të ketë densitet të lartë (mbi 40 njësi banimi për hektarë, respektivisht mbi 200 banorë/ha), ndërsa pjesët tjera periferike do të jenë me densitet të mesëm dhe të ulët (nën 40 njësi banimi respektivisht nën 200 banorë për hekatrë. Poashtu edhe zona urbane në Komoran do të ketë zonën qendrore me densitet të mesëm dhe kufizohet me densitet të ulet.

Përcaktimi i saktë i sasisë së tokës se nevojshme bazuar në 40, 25 apo 15 njësi banimi për hektarë do të përcaktohet në Hartën Zonale të Komunës (HZK). HZK do të përcaktojë saktësisht dendësinë për çdo lagje të zonës urbane dhe rurale.




Harta 35. Plani i vendbanimeve dhe banimit (Gjendja e planifikuar)

### 3.3.6.BANIMI

Në mënyrë që të zhvillohet banimi i qëndrueshëm në mënyrë të mirëfilltë, plani propozon Hartimin i strategjisë së banimit me qasje të integruar (jo vetëm atij social). Për të arritur këtë, nevojitet urgjent të ndërtohen kapacitetet profesionale për menaxhim në fushën e banimit.

**Menaxhimi dhe cilësia së fondit të banimit:** Në përgjithësi, nevojitet të balancohet nevoja e madhe për banim të rëndomtë edhe të atij të përballueshëm me njësitë e zbrazëta të banimit, sidomos në viset e largëta rurale. 80% te kapaciteteve te pashfrytëzuara te banimit duhet të futen në shfrytëzim.

Lagjet e banimit që janë ndërtuar pa leje në tokë të parcelizuar te klasit të I-IV pa infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit duhet të rregullohen dhe trajtohen sipas ligjit të legalizimit, edhe për shkak të kushteve sanitare.

Propozohet të bëhet ofrimi i ngrohjes qendrore për banim përmes ko-gjenerimit me KEK-un, duke qenë se infrastruktura bazë është prezente.

Do të bëhet rritja e efiçiencës së energjisë në 50% të ndërtesave ekzistuese të banimit në një periudhë afatgjate si dhe stimulimi i aplikimit të masave efiçiente në ndërtesat e reja përmes ofrimit të lehtësirave gjatë pajisjes me leje ndërtimore apo pagesës së tatimit në një periudhë afatshkurtër.

Në zonën urbane do të rritet dendësia e banimit por edhe rregullohet infrastruktura përcjellëse publike.

**Plotësimi i nevojave për banim:**

Komuna do të ofrojë kushte për zhvillimin e politikave të banimit të përballueshëm. Komuna është në hartim e sipër të Programit të saj të parë të banimit social.

Komuna planifikon që të krijojë fondin për banim në mënyrë që të jetë në gjendje të ofrojë zgjidhje për strehim për të gjitha grupet e shoqërisë që kanë nevojë si dhe të lehtësojë menaxhimin/administrimin e ndërtesave ekzistuese në bashkëpronësi.

Planifikohet sigurimi i banimit adekuat për 50% të familjeve në nevojë deri në vitin 2022 si dhe rritja e fondit të banimit të përballueshëm për 50% deri ne vitin 2022. Gjithashtu Komuna planifikon shfrytëzimin e banimit të braktisur (dhe atyre në shfrytëzim) për akomodim të turizmit malor dhe eko-turizmit rural në Qyqavicë, Vasilevë, Kleçkë, Abri e gjetiu.

DRAFT




Harta 36. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës




Harta 37. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës në zonën urbane




Harta 38. Toka e propozuar ndërtimore

### 3.3.7.INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT

Edhe pse me një rrjet të zhvilluar rrugor dhe hekurudhor, Komuna e Gllogocit do të avancojë edhe më tej lëvizshmërinë në kuptim të lehtësimit të lëvizjes motorike, mundësimit të lëvizjes jo-motorike dhe rritjes së sigurisë për të siguruar zhvillim më të qëndrueshëm dhe rritje ekonomike që sjell përfitime të rëndësishme sociale.

**Infrastruktura rrugore:** Duhet të bëhet zgjerimi i rrugëve dhe trotuareve, ku prioritet ka zgjerimi i rreth-rrotullimit në hyrje të Gllogocit si dhe zgjerimi i trotuarit dhe ndërtimi i atij në anën tjetër të rrugës Gllogoc-Poklek, në mënyrë që të evitohet tollovia e përditshme e makinave që hyjnë në Gllogoc dhe atyre që vazhdojnë për Skenderaj, si dhe tollovia dhe rreshti i gjatë i nxënësve që bëhet për të shkuar në shkollë të mesme dhe anasjelltas. Të gjitha rrugët në hapësirat urbane duhet të pajisen me trotuare në të dy anët, dhe në hapësirat rurale ato duhet të plotësohen me trotuare së paku në një anë të rrugës.

Përveç trotuareve, rrugët kryesore duhet të pajisen me shteg të biçikletave dhe brez të gjelbërimit të ulët dhe të lartë. Gjelbërimi i lartë përgjatë rrugës është i domosdoshëm për ofrimin e hijes gjatë ecjes, pastrimit të ajrit si dhe zvogëlimit të zhurmës.

Gjithashtu, nevojitet përmirësimi i cilësisë së punimeve në infrastrukturë të transportit dhe përcjellja e punimeve me infrastrukturë ndihmëse teknike.

Duhet të përcillen parimet e mëposhtme të organizimit tek prioritetet ne infrastrukturën rrugore:

- Brenda vendbanimeve të i ipet përparësi lëvizjes (transportit) të shëndetshëm i cili realizohet përmes ecjes dhe biçikletave dhe plotësimit me transport publik. Lëvizja (transporti) private përmes veturave (dhe mjeteve të ngjashme motorike) duhet të kushtëzohen dhe nuk duhet të favorizohen në asnjë rrethanë.
- Jashtë vendbanimeve duhet të ipet përparësi zhvillimit te transportit publik
- Duhet te mundësohet shkurtimi i distancave në mes vendbanimeve (fshatrat-qendra sekondare-Gllogoc)

Infrastruktura rrugore përbëhet nga rrjeti rrugor që menaxhohet nga niveli qendror ku renditen autoudhat, rrugët nacionale dhe rrugët rajonale. Përdersa në menxhim të nivelit komunal janë rrjeti rrugëve ne qytetin e Gllogocit: rrugë urbane të kategorisë I, II dhe III, si dhe rrjeti rrugëve ne vendbanimet tjera dhe ne tere territorin e komunës (përveç qytetit te Gllogocit): rruge rurale të kategorisë I dhe II. Përveç rrugëve te kategorizuara ne Komunën e Gllogocit paraqiten edhe rrugë të pakategorizuara të cilat rrugë shfrytëzohen për komunikacion si rruga për shfrytëzimin e pyjeve, rruga e liqeneve akumuluese, rruga për destinim bujqësor e të ngjashme.

**Qasja në Çikatovë të Vjetër-Ferronikeli:** Duhet të bëhet rregullimi i qasjes së lagjes Morina në Çikatovë të Vjetër si dhe përmirësimi i qasjes së fëmijëve të Çikatovës deri në shkollë. Nevojitet të shikohen mundësitë për ndërrimin e trasesë së rrugës industriale e cila shfrytëzohet për shkarkimin e mbetjeve industriale në gropën e nxjerrjes së xehes, por e cila kalon nëpërmes vendbanimit dhe paraqet qasjen e vetme për disa ekonomi familjare. Kjo, sidomos është e nevojshme pasi që në ditë kalojnë 170 kamionë[56], një pjesë e konsiderueshme e të cilëve janë të makinerisë së rëndë dhe bëjnë vibrime e zhurma që e pengojnë vendbanimin.

**Infrastruktura hekurudhore:** Në një kornizë kohore afatgjate planifikohet të projektohet dhe ndërtohet tramvaji i cili do të vazhdojë nga segmenti i planifikuar Prishtinë - Aeroporti i Prishtinës në drejtim të Stadiumit Kombëtar-Parkut të Biznesit, dhe i cili do të vazhdojë me ndalesë në Komoran dhe deri tek terminali në qytet të Gllogocit. Nëse gjatë projektimit del se nuk është i realizueshëm versioni i 1-re (për shkak të konfiguracionit të terenit), te merret parasysh versioni 2 që ka trasenë nga Aeroporti në Park të Biznesit-

[56] Leja e integruar mjedisore

Stadium dhe të vazhdojë paralel me rrugën e re Korroticë e epërme-Gllogoc, e pastaj përmes qasjes tek binaret e hekurudhës ekzistuese afër Ferronikelit" të arrijë në qytet të Gllogocit.

Ndërtimi afër infrastrukturës hekurudhore - Ndërtesat dhe strukturat e tjera, uzinat dhe stabilimentet mund të vendosen në brezin mbrojtës të hekurudhës bazuar në miratimin sipas kushteve të dhëna në vazhdim:

- në vendbanime, male, terrene me baltë dhe vende të tjera ku kërkojnë kushtet fushore, mund të miratohet dhe lejohet hapja e minierave, guroreve, ndërtimi i tullave dhe gëlqeres, ndërtimi i ndërtesave industriale apo strukturave të ngjashme në brezin mbrojtës afër hekurudhës nëse toka ku do të vendosen ato është terren i përcaktuar nga autoritetet komunale për ndërtimin e strukturave dhe uzinave por kjo nuk mund të jetë më afër se pesëdhjetë (50) metra nga aksi i binarit të fundit anësor;
- ndërtimi i shtëpive, bizneseve, ndërtesave ndihmese dhe të ngjashme, gërmimi i puseve, rezervarëve, gropave septike, ndërtimi i linjave të gjata elektrike, etj. mund të miratohet në vendbanime dhe tokën ashtu si thuhet në paragrafin e sipërm por jo më afër se njëzetepesë (25) metra nga aksi i binarit të fundit anësor;
- shenjat dhe billbordet mund të vendosen në brezin mbrojtës të paktën shtatë metra nga pika e fundme e hapësirës hekurudhore;
- nëse për shkak të ndërtimit të një strukture apo për shkak të mirëmbajtjes së saj (rrugë publike, aeroport, rezervar, strukturë e rrymës, minierë, etj.), një pjesë e aseteve hekurudhore është dëmtuar, atëherë kjo pjesë e aseteve të hekurudhës që është dëmtuar duhet të riparohet në bazë të normave dhe standardeve ekzistuese për llojin e aseteve hekurudhore pa marr parasysh gjendjen aktuale para dëmtimit. Në këtë rast shpenzimet për riparim të aseteve të dëmtuara hekurudhore duhet t`i bartë investitori i strukturës së re apo të mirëmbajtjes së saj.

**Zvogëlimi i ndotjes akustike:** Në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i zhurmës së trenit, duhet që në bashkëpunim me Hekurudhat e Kosovës të vendosen barriera zanore në segmentet e trasesë që kalojnë afër vendbanimeve. Kjo vlen edhe për segmentet e rrugës nacionale dhe segmetin e autoudhës që kalojnë nëpër vendbanime.

**Siguria:** Përveç lauretave, që duhet të parashihen në të gjitha kryqëzimet e hekurudhës me rrugë, duhet të vendosen edhe semaforë dhe të shtohet sinjalizimi horizontal dhe vertikal si dhe ndriçimi publik. Duhet të bëhet zvogëlimi i ndikimeve negative që shkaktohen nga transportimi i ngarkesave të Ferronikelit (bartja e oksigjenit të lëngshëm, dëmtimi i rrugëve, tollovia, zhurma). Kjo arrihet me vendosjen e sinjalizimit adekuat dhe rritjen e frekuencës së inspektimit komunal dhe ministror nëpër rrugë dhe shqiptimin e gjobave për të siguruar bartjen adekuate (me mbulesë dhe pa rrjedhje) dhe mos dëmtimin e rrugëve.

**Transporti publik:** Të gjitha vendbanimet duhet të përfshihen me transport publik dhe të ofrohet transporti peri-urban pas orës 19:00 dhe gjatë pushimit veror të nxënësve. Edhe pse Gllogoci është qytet i vogël, duke marrë parasysh formën e tij të shpërndarë, dhe për të lehtësuar lëvizjen e të gjitha moshave prej njërës lagje në tjetrën nevojitet ofrimi i transportit urban. Vendet e ndalesave të autobusëve duhet të ndërtohen ashtu që të ofrojnë strehim nga kushtet atmosferike, vend për ulje dhe për vendosjen e orarit të operimit. Nga pikëpamja mjedisore, shfrytëzimi i transportit publik është e mirë pasi e redukton emetimin e dëmshëm në ajër të GHG-së, porse planifikimi i tij kërkon përpjekje shtesë më vete krahas PZHK-së që e ofron bazën e këtyre përpjekjeve. Zhvillimi i transportit duhet të bazohet në pikëpamjen e mundësive të kombinimit të transportit publik përmes rrugëve, hekurudhës, taksive, biçikletave, dhe mbase të shfrytëzimit të mundshëm të automjeteve elektrike në një afat më të gjatë kohorë. Nga pikëpamja e inter-modalitetit të transportit, kërkohet modeli i transportit të kombinuar për distancat më të shkurtra nga vendbanimi deri në vendin e punës, si dhe kombinim të transportit për kohë të lirë dhe për shërbime publike, etj. Sa më efikas që të jetë transporti publik aq më pak do të ketë emetim të $CO2$, ndërsa qytetarët do ta zgjedhin transportin publik para se t'i shfrytëzojnë veturat e tyre private.

DRAFT

**Terminali multi-modal:** Duke marrë parasysh pozicionimin e stacionit të autobusëve në afërsi të hekurudhës, dhe me qëllim të lehtësimit të lëvizjes, propozohet që të ndërtohet një terminal i përbashkët i autobusëve dhe hekurudhor në vendin e tanishëm të stacionit të autobusëve. Ky terminal do të shërbejë si ndalesë edhe për linjën e tramvajit e cila do të sjellë udhëtarët deri-nga stadiumi dhe aeroporti. Terminali, natyrisht duhet të projektohet me të gjitha përmbajtjet përcjellëse të parkingjeve të autobusëve, veturave, taksive, ndalesës së transportit peri-urban dhe urban, hapësirave për pritje, freskim, etj.

DRAFT




Harta 39. Zhvillimi i transportit dhe infrastrukturës së transportit




Harta 40. Transporti urban dhe rural

### 3.3.8.INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Ujësjellësi: Rrjeti i ujësjellësi duhet te shpërndahet ne vendbanimet tek te gjitha vendbanimet e mbetura jashtë rrjetit, pra shtrirja ne Abri e Epërme, Arllat, Baicë, Domanek, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ulët, Godanc, Gradicë, Kishnarekë, Korroticë e Epërme, Likoshan, Negroc, Nekoc, Polluzhë, Sankoc, Shtuticë, Tërdec, Vasilevë, Vërboc dhe Vuçak. Ndërsa, ne Gllanasellë, Dobroshec dhe Llapushnik duhet te plotësohet dhe kompletohet rrjeti ekzistues I ujësjellësit. Rrjeti i planifikuar i ujësjellësit i paraqitur në hartë, mund të ketë ndryshime në rast se kushtet teknike, zbatimi në terren, çështjet pronësore apo studimi i fizibilitetit kërkon ndryshim të rrjetit të planifikuar.

Burimet e ujit duhet te ruhen edhe përmes minimizimit te humbjeve te ujit në sistemin distributiv të cilat për momentin llogariten të jenë në shkallë mjaftë të lartë, prej 57% deri 60%. Me intensitet te lartë duhet të punohet drejt rregullimit/zëvendësimit të rrjetit te vjetruar të ujësjellësit dhe eliminimit te kyçjeve ilegale. Gjithashtu, gradualisht duhet te eliminohen furnizimi me ujë nga bunarët e cektë dhe të pambrojtur.

Kanalizimi: Rrjeti i kanalizimit duhet te shpërndahet ne vendbanimet te cilat nuk kane rrjet te kanalizimit, pra në Gllanasellë, Gllobar, Terstenik, Verboc, Gradicë, Likoshan dhe Shtuticë. Të gjitha vendbanimet duhet të pajisen me rrjet kanalizimi qe bën trajtimin mekanik dhe fizik, duke eliminuar gradualisht prezencën e gropave septike.

Ne parim, të gjithë gypat e kanalizimit duhet do të jenë në drejtim të rrugës kryesore pasi që

kolektori kryesor do të jetë në këtë drejtim. Secila rrugë duhet të ketë gypin e vetë të kanalizimit fekal dhe atmosferik dhe kahja e tyre do të caktohet varësisht nga konfiguracioni i terrenit.

Impianti për trajtimin e ujerave te zeza do te ndërtohet ne lokacionin Dobroshec.

Rrjeti i kanalizimit atmosferik: Menaxhimi i ujërave atmosferikë do të bëhet përmes sanimit të sistemeve ekzistuese si dhe ndërtimit të sistemeve të hapura përgjatë rrugëve ku ato mungojnë. Duhet te ndahet plotësisht nga rrjeti i kanalizimit, si dhe trajtimi u tij duhet te përfshijë filtrim dhe ruajtje ne mënyrë qe te zvogëlohet ngarkimi i zonave te banimit, biznesi dhe industriale gjate sezonës se reshjeve. Të gjitha rrugët e qytetit do të kenë rrjetin e kanalizimit atmosferik ose forma tjera alternative, përmes të cilave do të grumbullohen dhe shkarkohen në lumin Drenica.

Ujitja: Në zonat ku nuk përfshihen nga sistemi i ujitjes "Ibër Lepenci", rrjeti i ujitjes për toka bujqësore dhe hapësira te gjelbra duhet te bëhet përmes akumulacioneve ekzistuese ujore ne lokacione të përshtatshme dhe ndërtimi i akumulacionit në fshatin Vërboc. Shpërndarja e ujit deri në toka bujqësore dhe hapësira te gjelbra do të bëhet përmes sistemeve të ujitjes me rënie të lirë (aty ku lejon konfiguracioni i terrenit) dhe me sistem pompimi në raste tjera.

Energjetika: Duhet te vazhdohet me rikonstruimin e rrjetit nga ai 10kV ne 20kV, e me këtë edhe transformimin e trafo-stacioneve 10kV ne ato TS 20kV me qellim te përmirësimit te furnizimit kualitativ dhe kuantitativ me energji elektrike.

Duke e konsideruar se shumica e kabllove te furnizimit me energji elektrike te objekteve të banimit janë mbi tokësore dhe në gjendje të dobët teknike, rinovimi i këtij sistemi të vjetruar do të ketë një prioritet të lartë. Në kuadër të ndërtesave dhe hapësirave publike, rritja e efiçiencës duhet të bëhet përmes aplikimit të masave efiçiente. Ndërkaq, nga masat e buta duhet të aplikohen masa për vetëdijesim rreth rëndësisë dhe përfitimeve ekonomike nga efiçienca energjetike. Duhet të shpërndahet rrjeti i ndriçimit publik për të gjitha rrugët e lagjeve duke shfrytëzuar llamba ekonomike LED. Përmirësimi i ndriçimit publik shihet si një parakusht i rëndësishëm për përmirësimin e sigurisë. Rekomandohen llambat prej natriumi në vend të llambave prej merkuri që përdoren gjerësisht për shkak të kostos së ulët investuese; llambat prej natriumi janë më të shtrenjta, por kanë potencial më të madh të kursimit të rrymës.

Duhet të zvogëlohen emetimete $CO_2$ duke aplikuar energji të ripërtërishme dhe duke bërë përmirësimin e efiçencës energjetike përmes aplikimit të teknologjive moderne që shfrytëzohen për prodhimin e energjisë

përmes biomasës; energjisë solare, energjisë së kombinuar dhe përmes stimulimeve për sektorin privat që të investojnë në objekte e pajisje të tilla.

Telekomunikacioni: zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit te telekomunikacionit duhet te vendos ne shfrytëzim kabllo me fije optike dhe me mundësi të bartjes edhe të Internetit dhe televizionit kabllovik. Gradualisht, duhet te kërkohet bartja e këtij e sistemit ajror në atë nëntokësor, duke filluar ne zonën urbane dhe nën qendra. Njëherit duhet të planifikohet që operatoret e ndryshëm që operojnë në komunë të koordinohen mes veti përmes planeve të përbashkëta.

Ngrohja: Komuna e Gllogocit nuk ka sistem të ngrohjes qendrore. Kryesisht përdoret druri ose energjia elektrike për ngrohje. Për qellim te sistemimit te ngrohjes qendrore, duhet te bëhen përpjekje për të gjetur zgjidhje përmes mbështetjes nga niveli qendror qeverisës apo donatorë potencial.

Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave: ndër prioritet që paraqiten ne këtë fushë është zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për tërë territorin e komunës si dhe eliminimi i vazhdueshëm i deponive ilegale. Duhet t'i jepet prioritet aktiviteteve të reduktimit, minimizimit dhe procesimit të mbeturinave karshi deponimit të tyre. Nder masat e buta, kërkohet te vijojnë fushata vetëdijesimi dhe masa për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që hedhen duke zbatuar projekte të klasifikimit të mbeturinave dhe përkrahja e bizneseve të riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve organike.

### 3.3.9.EKONOMIA

Politikat zhvillimore lokale në komunën e Gllogocit luajnë rol thelbësor në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. Bashkëpunimi i pushtetit lokal me bizneset e vogla dhe të mesme vlerësohet si çelës i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. Zhvillimi ekonomik është planifikuar të zhvillohet duke u bazuar në resurset, kapacitetet dhe pozitën qendrore që ka komuna e Gllogocit në Kosovë. Potencialet kryesore mbi të cilat mbështetet zhvillimi ekonomik dhe gjenerimi i punësimit janë industria, toka bujqësore dhe bizneset (NVM-të).

Duhet të ndërmerren masa me qëllim të mbrojtjes dhe rritjes së nivelit të shfrytëzimit te tokës, si dhe rritjes së vlerës dhe prodhimtarisë. Toka bujqësore është aset zhvillimor dhe duhet të mbrohet nga ndërtimet e shpërndara, duke aplikuar kontroll rigoroz te zhvillimeve dhe duke respektuar kufijtë e ndërtimit te vendbanimeve. Tokat bujqësore nën sistem të ujitjes si dhe ato përgjatë lumit Drenica, duhet të kenë kujdes të veçantë. Parashihet të mbrohet toka bujqësore e cilësisë së lartë nga ndikimet e dëmshme që dalin prej aplikimit të plehrave artificiale dhe pesticidet përmes kujdesit në aplikimin e përdorimit të pesticideve në mjedis.

Propozohet aplikimi i bujqësisë së qëndrueshme përmes subvencioneve dhe granteve të drejtpërdrejta për blerjen e pajisjeve moderne për punimin e tokës, edukimi, trajnimin dhe certifikimin (posaçërisht sa i përket bujqësisë organike).

Duhet te stimulohen rritja e madhësisë së njësive bujqësore si arat, kopshtet dhe fermat, si dhe prodhimet bujqësore lokale do te kenë në shfrytëzim pikat grumbulluese ne lokacionet Abri e Epërme, Tërstenik, Gllanasellë dhe Zabel i Ulët, potencialisht te organizuara ne forma te strukturave kooperative.

Prej masave te 'buta', duhet te promovohen trajnime specifike për zhvillim profesional te bujqësisë duke synuar ngritjen e produktivitetit si dhe për trajtimin e duhur me substanca agro-kimike me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore.




Harta 41. Sistemi i ujitjes dhe drenazhimit (gjendja e planifikuar)




Harta 42. Energjia elektrike dhe termike (gjendja e planifikuar)




Harta 43. Telekomunikacioni dhe instalimet e ngjashme (gjendja e planifikuar)




Harta 44. Shtritja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit




Harta 45. Menaxhimi i mbeturinave dhe riciklimi




Harta 46. Masat për zhvillimin ekonomik (Gjendja e planifikuar)

### 3.3.10. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

Cilësia e shërbimeve shëndetësore (diagnostikimi, trajtimi dhe parandalimi i sëmundjeve, lëndimet dhe dëmtimet të tjera fizike dhe mendore, etj.) që u ofrohen pacientëve është e rëndësishme. Prandaj në mënyrë që të gjithë banorët në komunë të Gllogocit të kenë qasje dhe trajtim shëndetësor korniza e zhvillimit hapësinor planifikon ndërtimin e dy Ambulancave në Baicë dhe Abri dhe renovimin e objekteve ekzistuese në Tërstenik dhe Gllanasellë. Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) kontribuon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe rritjen e kënaqshmërisë së pacientëve. Përmirësimi i qasjes në të gjitha objektet shëndetësore është një tjetër sfidë që trajton plani dhe planifikon qasje për persona me aftësi të kufizuar dhe definimin e parkingjeve para këtyre objekteve.

Për më tepër territori i komunës së Gllogocit është i mbuluar me shkolla por shumica e shollave nuk kanë salla te sportit (përveç Shfmu "Rasim Kiqina" në Gllogoc , Shfmu "Xheladin Gashi–Plaku" në Komoran ,Shfmu "7 Marsi " në Kishnarekë, Shfmu "Hasan Prishtina " në Llapushnik, Shmp "Xhevë Lladrovci" në Poklek të Ri Gllogoc). Koncepti zhvillimor planifikon që në të gjitha shkollat ku mungojnë salla të fizkulturës të bashkëngjitet objektit shkollor me sipërfaqe adekuate për madhësinë e shkollës sipas normave teknike duke përfshirë sigurimin e inventarit dhe pajisjeve të teknologjisë informative (kabinete dhe laboratorë përkatëse). Duhet të theksohet se korniza parasheh çerdhe në Gllogoc dhe nën-qendra, trajnimet në të gjitha shkollat me vizion të ri për zhvillim.

Përmirësimi i mirëqenies sociale në tërë territorin e komunës së Gllogocit është i rëndësisë së veçante prandaj është vlerësuar se QMF mund të ofrojë qëndrime ditore për pleq. Për më tepër në Gllogoc propozohet ndërtimi i shtëpisë së pleqve në Qyqavicë dhe strehimores duke përfshirë edhe banimin social të integruar/përgjithshëm.

Në mënyrë që të shfrytëzohet maksimalisht prona publike do të ofrohen lokacione për vendosjen e varrezave të reja duke përfshirë edhe hapësirat për shërbime të varrimit.

Si elemente të rëndësishme të qytetit, objektet e kulturës duhet të ngrisin vetëdijen e njerëzve, besimin e tyre, ndërtojnë dhe forcojnë komunikimin mes njerëzve. Në mënyrë që të promovohet sa më shumë arti dhe kultura koncepti i zhvillimit planifikon ndërtimin e qendrës multi funksionale në Gllogoc (kinema, sallën koncertale, teatrin, muzeun, ofrimin e shërbimit të trajnimeve) dhe ndërtimi i shtëpive të kulturës në 4 nën-qendrat tjera. Duhet të kushtohet vëmendje të shtuar në ofrimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuar.

Për një komunitet më të fortë dhe më të shëndetshëm korniza zhvillimore planifikon fuqizimin e sportit dhe rekreacionit përmes ndërtimit të objektit multi-funksional duke përfshirë edhe shtigjet e vrapimit në Zabel të Ulët. Në mënyrë që banorët të kenë sa më shumë dobi nga aktiviteti fizik do të shtohen shtigjet e ecjes në Qyqavicë dhe shtegun panoramik rreth Likoshanit.

Duke pasur parasysh që hapësirat e gjelbra janë tejet të rëndësishme për banorët ngase janë vende ku mund të zhvillohen aktivitete të ndryshme nga ana e të rriturve dhe fëmijëve duhet që të gjitha hapësirat e lira sidomos ato para ndërtesave shumëkatëshe të shndërrohen në hapësira për gjelbërim ndërsa lokacioni tek pishat në Gllobar të shndërrohet në park.

DRAFT




Harta 47. Hapësirat publike dhe sociale (Gjendja e planifikuar)




Harta 48. Hapësirat sportive (Gjendja e planifikuar)




Harta 49. Hapësirat publike dhe të gjelbra (Gjendja e planifikuar)




Harta 50. Menaxhimi i varrezave

### 3.3.11. MJEDISI DHE FATKEQËSITË NATYRORE

Duke pasur parasysh që mjedisi është faktor që luan rol të rëndësishëm në jetën e njeriut sepse plotëson nevojat e domosdoshme për ekzistencë dhe duke mos injoruar faktin që është prezentë dukuria e ndotjes në territorin e komunës (industria e Feronikelit, ndërtimet ilegale, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore etj.) korniza zhvillimore propozon masa adekuate për mbrojtjen e mjedisit.

Pasi që Feronikeli është një ndër ndotësit kryesor të ajrit, ujit dhe tokës ndikimi në mjedis do të monitorohet përmes matjeve të vazhdueshme të përqendrimit $SO_2$, $CO$, $NO_2$, $O_3$ dhe përqendrimit të pluhurit në qendër të qytetit dhe vendbanimet afër Feronikelit. Matjet do të bëhen në mënyrë periodike (min 1 herë në muaj) me stacione mobile rreth e rrotull Ferronikelit dhe deponive në Çikatovë të Vjetër dhe të bëhet vendsja e filtrave. Ndikimi i fakrikës së Feronikelit në mjedis do të monitorohet dhe të mbikqyret duke respektuar kushtet e lejes së integruar mjedisore dhe ligjet tjera në fuqi, dhe po ashtu komuna në rastin e Feroniketlit do të kërkojë zbatimin e parimeve "ndotësi paguan" dhe "shfrytëzuesi paguan", përmes implementimit të projekteve të gjelbrimit dhe projekteve tjera për përmirësimin e mjedisit. Fabrika e Feronikleli përmes organeve qëndrore duhet të përmirësojë teknologjinë e prodhimit, ndërrimin e lëndëve djegësë, rehabilimitimin e deponive industriale përmes rikultivimit dhe melorimit. Po ashtu Fabrika e Feronikelit duhet të zbatoj masat për zvogëlimin e zhurmës, përmes ngritjes se barierave kunder zhurmes dhe krijimit të rripit të gjelbër nga pemët dhe drunjët.

Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Dobroshec është zgjidhje e qëndrueshme dhe afatgjate që parasheh ky plan për adresimin e ndotjes së ujit respektivisht të lumenjve Drenica dhe Vërboc ku monitorimi i rregullt të lumenjve është i domosdoshëm. Për hapësirat tjera që nuk janë përfshirë në sitemin e trajtimit të ujërave të zeza do të ndërtohen moçalishte artificiale.

Deponitë ilegale, eksploatimi i drurit dhe zhavorrit janë sfida shtesë më të cilat ballafaqohet komuna e Gllogocit prandaj mbyllja-eliminimi i deponive ilegale dhe shëndrrimi i tyre në hapësira të gjelbra që mund të shfrytëzohen nga ana e qytetarëve është zgjidhja që ofron ky plan. Ndërsa eksploatimi i drurit dhe zhavorrit mund të adresohet me monitorim të rregullt nga ana e komunës dhe aprovimi i rregulloreve që parasheh gjobitjen. Nga ana e komunës do të bëhet edhe kontrollimi i përdorimit të pesticideve që rrezikojnë tokën e bujqësore. Për më tepër plani parasheh që të minimizohet numri i gurëthyesve, ndërsa në ato legale të shtohen hapësira të gjelbra.

Rehabilitimi i zonave të dëmtuara të tokës dhe peisazhit nga gurëthyesit duhet të bëhet sipas kushteve dhe kritereve të paraparë në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe në pëlqimin mjedisor ose lejen mjedisore përkatëse nga operatorët ekonomik. Ky aktivitet duhet të realizohet në bashkëpunim me organet kompetente të MIA. Duhet patur kujdes në zgjedhjen e drunjëve dhe pemëve që do të përdoren për rikultivim dhe duhet të përjashtohen llojet invazive dhe tu jepet prioritet llojeve të zonës dhe llojeve që adaptohen dhe praktikohen në rastet e rikultivimit të këtyre zonave. Edhe në rastet e lejeve të reja për gurëthyes të gjitha ndikimet e mundshme mjedisore duhet të identifikohen duke zbatuar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe duke zbatuar Planin e Rehabilitimit të paraparë sipas dispozitave të lejes përkatëse.

Sidoqoftë, duke konsideruar faktin që territori i Gllogocit e posaçërisht hapësira rreth lumit Drenica rrezikohet nga vërshimet atëherë parashihet mbrojtje me përdorim të materialeve "miqësore" në formë të barrierave në pjesët ku mund të vërshojë uji (jo tërësisht) ndërsa përdorimi i materialeve masive ndalohet ngase pengon drenazhimin natyral të ujit. Si masë preventive duhet të konsiderohet që lumit të mos i ndërrohet shtrati natyral.

Mbrojtja kundër vërshimeve pasi që është një disiplinë komplekse duhet t'i përfshijë hidrologët, hidro-teknikët dhe biologët. Ekspertët e mjedisit duhet t'i përcaktojnë masat e përshtatshme (biologjike) për ta përmirësuar habitatin e tanishëm të dobët përgjatë brigjeve të lumenjve.

Pasi që skorja nga Feronikeli e mbulon një hapësirë prej 24 ha dhe zona e ndikimit është 45 ha atëherë parashihet që rreth skorjes të ketë tampon zonë nga gjelbërimi që do të pengonte shpërndarjen e pluhurit në pjesë tjera të territorit dhe njëkohësisht do të pasuronte ajrin me sasi të oksigjenit. Kjo nevojitet të bëhet edhe në skorien e cila është duke u krijuar në gropën e krijuar më parë nga veprimtaria e eksploatimit në Çikatovë të Vjetër. Në këtë gropë e cila ka filluar të mbushet me mbetje industriale, duhet të punohet sa më shpejtë në tërësi gjeo-membrana në bazament, e jo pjesë-pjesë, në mënyrë që të mos vie te depërtimi i metaleve në tokë dhe në ujërat nentokësore, të cilat pastaj përmes lumit Drenica ndotin një pjesë të madhe të territorit të komunës. Është e nevojshme që komuna të bëjë inspektimin e vazhdueshëm deri sa të sigurohet përfundimi i punimit të membranës.

Hapësirat qo konsiderohen të rrezikuara nga zjarri janë Malet Qyqavicës, Malet Vasileves, Malet e Polanës (Komoran), Malet e Pallanikut dhe Malet Kosmaqit. Parandalimi i zjarreve në hapësirat që konsiderohen të rrezikuara nga zjarri e që janë Malet Qyqavicës, Malet Vasileves, Malet e Polanës (Komoran), Malet e Pallanikut dhe Malet Kosmaqit do të bëhet përmes aplikimit të masave nga ana e komunës ku parashihet ndalimi i piknikut dhe ndezjes së zjarrit, monitorimi i rregullt i gjendjes dhe gjobitja. Aplikimi i disa masave teknike si largimi i drunjëve dhe shkurreve të thara, parandalimi i rritjes së tepërt të shkurreve, kontrollimi i distancës në mes të drunjëve mund të parandalojnë zjarret në pyje.

Për më tepër në Çikatovë të vjetër, Korreticë të epërme dhe Baicë ku është prezentë erozioni nga mihjet si masë preventive është mbjellja e shkurreve, shtimi i gurëve duke përfshirë edhe monitorimin e rregullt. Përveç rehabilitimit nga shkatërrimi, të shkaktuar nga gurthyesit, për sipërfaqet tokësore nën ndikim të erozionit parashihen edhe pyllëzimet dhe ripyllëzimet.

Paralel me aktivitetet e lartpërmendura parashihet ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë dhe mbrojtjen e mjedisit përmes shpërndarjes së broshurave dhe seminareve sensibilizuese si dhe ligjëratave në shkolla.

DRAFT




Harta 51. Mbrojtja e mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet tjera (Gjendja e planifikuar)

### 3.3.12. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE DHE TURIZMI

Trashëgimia kulturore si një ndër elementet më të rëndësishme dhe pjesë përbërëse e mjedisit jetësor konsiderohet faktor i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit prandaj është më se e domosdoshme të mbrohet dhe promovohet. Duke konsideruar këtë fakt kaq të rëndësishëm korniza e zhvillimit parasheh konservimin dhe promovimin e vazhdueshëm të aseteve nga trashëgimia arkeologjike që tani më janë në listë të mbrojtjes: Qyteza e vogël dhe e madhe në Vuçak, Kalaja e Llapushnikut, Tuma e vetmuar në Llapushnik, Fortifikata parahistorike “Gradina” në Çikatovë të Vjetër, Kalaja - Çuka e Godancit, Kalaja Antikë dhe Mesjetare në Vërboc.

Sa i përket trashëgimisë arkitekturale parashikohet konservimi i aseteve tani më të mbrojtura: Polluzhë/Kulla Shaban Poluzha, Dobroshec/Kulla e Habib Xhemajlit. Është vlerësuar që brenda territorit të Gllogocit janë të pranishme edhe vlera si në vijim: Qikatovë e Vjetër/Kullë Ibish Morina, Kompleks Banimi/Familja Dervisholli, Gradicë Shtëpi banimi i Smajl Haxhiu/Poklek i Vjetër, Mulliri Gani Syla, Kishnarekë Shtëpi Banimi Rexhep Zariqi, Shtëpi Banimi Muharrem Veseli Korroticë e Ulët, Stacioni i Trenit – Baicë, Stacioni i Trenit Gllogoc, Stacioni i Trenit - Dritan (Dobroshec), Shtëpi banimi Rexhep Zatriqi dhe Kulla banimi Rashit Istogu . Vlerat e përmendura së pari duhet të përfshihen në listë të mbrojtjes dhe pastaj t’i nënshtrohen procesit të konservimit në mënyrë që në të ardhmen mund të shfrytëzohen për qëllime në funksion të zhvillimit ekonomik.

Duhet theksuar se një pjesë e Zonës së Veçantë të “SHTABI I PËRGJITHSHËM I UÇK-ËS KLEÇKË DHE DIVJAKË” i takon territorit të komunës së Gllogocit dhe si zonë do të vazhdojë të jetë e mbrojtur dhe të gjitha intervenimet do të jenë në harmoni me planin e lartpërmendur.

Vlerat e lartpërmendura parashikohet të përfshihen në agjendat regjionale ku vizitorët do të kenë mundësi të vizitojnë trashëgiminë arkeologjike dhe në të njëjtë kohë të shijojnë ushqimin tradicional brenda objekteve tradicionale ku paralelisht ofrohet mundësia e promovimit të traditës së ndërtimit dhe mënyrës së banimit.

Liqeni i Vasilevës si rezervat i natyrës radhitet në listën e vlerave të propozuara për mbrojtje. Me atraktivitetin që posedon, liqeni konsiderohet aset i rëndësishëm për zhvillim të turizmit ngase mund të organizohet peshkimi. Plani parashikon mbrojtjen e mëtutjeshme dhe krijimin e një hapësirë të përshtatshme për vizitorë përmes infrastrukturës përcjellëse si: ulëse, shtigje për këmbësorë dhe çiklistë, ndriçim adekuat, hapësira për lojëra të fëmijëve etj.

Për më tepër për lokalitetet me potencial për eko-turizëm si: mali i Kozmaqit, kodra e pishave të Kamenicës dhe të Komoranit, shpella e Kishnarekës, shpellave të Peshterrit në Nekovc, shpella e Kokilit në Vërboc, Shpella e Baicës, Shpella e Gllanasellës do të ofrohet qasja adekuate dhe promovimi i vazhdueshëm i tyre ngase vizitorët mund të shijojnë bukuritë e natyrës dhe ndërkohë të freskohen në liqenin e Vasilevës. Duhet të theksohet se përdorimi i materialeve “miqësore” është i domosdoshëm.

Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes organizimit të festivaleve, seminareve dhe trajnimeve të ndryshme ku shpërndahen broshura për vlera dhe rëndësinë e tyre në funksion të zhvillimit ekonomik.

DRAFT




Harta 52. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Gjendja e planifikuar)

# 4. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PLANI I VEPRIMIT

## 4.1. PRIORITETET STRATEGJIKE

Prioritetet strategjike janë ranguar qëllimet e identifikuara paraprakisht me palët e interesit duke përfshirë EKP-në dhe EKK-në si dhe në prani të MIA-së gjatë punëtorisë së planit të veprimit dhe prioriteteve të mbajtur ne maj të 2019.

| Qëllimi | Poentimi |
|---|---|
| **Vendbanimet -** Qëllimi 1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës | **61** |
| **Zhvillimi ekonomik**<br>Qëllimi 2: Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM) | **59** |
| **Ujësjellësi, kanalizimi dhe ujitja**<br>Qëllimi 2: Zhvillimi I infrastrukturës se ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) si dhe ujitjes | **54** |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi)**<br>Qëllimi 1: Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë | **39** |
| **Infrastruktura publike dhe sociale (Arsimi)**<br>Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë | **24** |
| **Zhvillimi ekonomik -** Qëllimi 1: Nxitja e zhvillimit te bujqësisë | **23** |
| **Mirëqenia sociale -** Qëllimi 3: Përmirësimi i mirëqenies sociale | **11** |
| **Mbeturinat -** Qëllimi 3: Përmirësimi I sistemit te menaxhimit te mbeturinave te tere territorin e komunës | **11** |
| **Infrastruktura teknike (Energjetika)**<br>Qëllimi 1: Rritja e kapaciteteve për furnizim te qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtritshme. | **10** |
| **Trashëgimia kulturore dhe natyrore -** Qëllimi 4: Krijimi i qasjes se integruar në mbrojtje te trashëgimisë kulturore dhe natyrore | **10** |
| **Infrastruktura publike dhe sociale (Shëinndetësia) -** Qëllimi 2: Ofrimi i shërbimeve cilësore te shëndetësisë me zhvillim te vazhdueshëm profesional | **9** |
| **Infrastruktura sociale – Kultura, sporti, hapesirat publike dhe hapesirat e gjelbra**<br>Qellimi 4: Ngritja e infrastruktures per objektet e kultures, sportit dhe rritja e hapesirave publike dhe te gjelbra | **6** |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi) -** Qëllimi 3: Sigurimi i një mjedisi me te sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë natyrore dhe tjera | **6** |
| **Transporti -** Qellimi 4: Sigurimi I transportit të integruar për komunën e Gllogocit | **5** |
| **Zhvillimi ekonomik -** Qëllimi 3: Zhvillimi i resurseve njerëzore ne përputhje me kërkesat e tregut | **5** |
| **Banimi -** Qëllimi 2: Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues te banimit | **4** |
| **Banimi -** Qëllimi 3: Plotësimi i nevojave për banim | **4** |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi) -** Qëllimi 2: Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv | **3** |
| **Vendbanimet -** Qëllimi 1: Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime | **1** |

Tabela 36. Rangimi i prioriteteve strategjike

DRAFT

Tabela 37. Plani i veprimit - Zhvillimi ekonomik

| FUSHA TEMATIKE | KODI I PROJEKTI | VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | SUBJEKTE TJERA TË PËRFSHIRA | PRIORITETET [Lartë; Mesëm; Ulët] | KOHËZGJATJA [Afatshkurtë; Afatmesëm; Afatgjatë; Vazhdimësi] | IMPLIKIMET FINANCIARE [në EURO] | INDIKATORËT |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ZHVILLIMI EKONOMIK | **QËLLIMI 1: NXITJA E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË**<br>Objektiva 1.1. Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore | | | | | | | |
| | A1 | Vlerësimi i gjendjes ekzistuese së tokës bujqësore për shfrytëzim | DGJKP, DU, DB | Komuna | Lartë | Afatshkurtër | 8,000 | Raporti i hartuar<br>Raportet e Drejtorisë për Financa |
